

DITURIA ISLAME


REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 386-387 • JANAR-SHKURT 2023

GËZUAR
Kosovë

DETYRAT E BESIMTARIT
NDAJ ATDHEUT

E DREJTA E GRUAS MUSLIMANE PËRBALLË
IDEOLOGJISË SË TË DREJTAVE TË NJERIUT,
FEMINIZMIT E ISLAMOFOBISË

MUHAMEDI A.S. NJERI I
PERKUSHTUAR NDAJ PAQES



**Begatoje, o Zot, Ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij Ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!
Gas përjetë paçin zotërit e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë plot me lumturi!**

Naim Frashëri

EDITORIAL

- 4 Paradoksi i braktisjes së tokës së çliruar

FE & SHKENCË

- 5 Komentimi i kaptinës El-Fet'h
Sabri Bajgora
- 9 Mesazhe pa fund të Israsë dhe Miraxhit
Dr. Jusuf el Kardavi
- 11 Detyrat e besimtarit ndaj atdheut
Sead Paqarizi
- 14 Shpirti sipas pikëpamjes së filozofëve islamë dhe mutekeliminëve
Dr. Bahri Hoxha
- 17 Ateizmi, kauzë apo mohim
Phd. Adnan Shala
- 20 Një pejgamber i përkushtuar ndaj paqes (1)
Flamur Vehapi
- 24 Përemri lidhor në gjuhën e Kuranit
Shkelzen Hoxha
- 26 Etika e mikpritjes në legjislacionin islam
Dr. Ilmije Kuqi

INTERVISTA

- 29 Fadil Rashiti, imami që ua dha lamtumirën e fundit xhematit për t'u flijuar për atdhe (Fet babai i dëshmorit)



EDUKIM & FAMILJË

- 32 E drejta e gruas myslimane përballë ideologjisë së të drejtave të njeriut, feminizmit e islamofobisë (1)
Edlira Durmishaj
- 36 Dashuria
Amër Halid
- 39 Dashuria dhe kujdesi ndaj prindërve
Isa Tërshani
- 42 Gruaja – prehja e zemrës, qetësia e shpirtit
Mimoza Sinani
- 44 Vështirësitë socio-ekonomike të dimrit
Dr. Mirsad Asllani



KULTURË

- 46 A është Islami fe e paqes apo e luftës?
Akademik Enes Kariq



HISTORI & CIVILIZIM

- 49 Përse qytetërimi islam?
Haki Sahitaj

AKTIVITETE

- 52 "FSI, institucioni më i vjetër i arsimit të lartë islam në trojet shqiptare"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 386-387 • viti 36 • janar-shkurt 2023
• Xhumadel Uhra - Rexheb 1444
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: dituriaislame@hotmail.com
dituriaislame@yahoo.com
www.bislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë



“E ti kurrsesi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë mizorët”.

(Ibrahim, 42)

Paradoksi i braktisjes së tokës së çliruar

Në një vorbull enigmatik të ngjarjeve më të rënda që tundeshin stoikisht në “baltën” e tokës sonë, e që pakkush arrinte të rrëfente se si do të përmbyllej fati i këtij trualli të trashëguar, mu atëherë, Kosova mrekullisht, e fitoi mëvetësinë e saj.

Në të 17-ën ditë të shkurtit “më të gjatë” të 2008-ës, veshët e këtij populli të përvuajtur u lumturuan nga lajmi që doli nga shtëpia e popullit dhe kuvendarët e saj, ku kumbueshëm u deklarua: “Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik.” Kjo ishte deklarata e pritur më gjatë në dy shekujt e fundit në nënqiellin tonë. Ajo stampoi mahnitshëm aspiratën shekullore dhe na tha se ne shqiptarët e Kosovës u ribëmë, më në fund të zotët dhe titullarët e tokës sonë.

Pavarësia e shtetit tonë përbënte përfundimin e një episodi të gjatë të aspiratave të dëlira, por edhe të përvuajtjeve e të sakrificave të shtrenjta që ofruan breza të shumtë për lirinë e ëndërruar. Ajo nuk erdhi si fryt i ndonjë tentative aventureske apo bixhozi politik të një grumbulli njerëzish që vendin e çliruan aksidentalisht. Jo, kurrsesi. Ishin pena, gjaku, e djersa e këtij populli ato që trokitën me përulësi në “portën hyjnore” të Zotit tonë, e prej Tij pastaj u bekuam, andaj triumfuam. Ajo që ngjau, nuk ishte asgjë më shumë se sa jetësim i një premtimi nga Krijuesi ynë i Urtë, që përsëritshëm në Librin e tij fisnik e tha: “E ti kurrsesi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë mizorët.” (Ibrahim, 42).

Vitet na ecin, dhe tashmë jemi në prag të motmotit të 15-të, të mëvetësimit tonë, që në versionin më optimist, s’ndiejmë më nevojën që të sakrifikojmë ende gjakun e bijve tanë për dheun e kësaj toke. Meqenëse, ne ishim të gatshëm që të sakrifikohehim për tokën tonë dhe të mos e boshatisnim, edhe kur këndeji pari shkelte thundra e agresorit pushtues, atëherë të vetëdijesohemi e të qëndrojmë sot në këtë tokë, mbase vetëm ne e dimë se si e kemi çliruar. Pra, ta duam e ta ruajmë çdo pëllëmbë të saj të çliruar gjer në amshim.

Na duhet pak ta kursejmë ngazëllimin pas triumfit historik, dhe gjersa këto ditë po shënojmë të ekzaltuar e me pietet 15-vjetorin e shtetësisë sonë, duhet të përpiqemi që të rigjejmë motive fisnike për të sendërtuar pa hile çdo cep të këtij shteti, që po hapëron i ndruajtur në krah me kombet që mbase “kanë harruar” kohën kur ato janë pavarësuar.

Brezi i ri që po rritet, e i cili nuk ka shijuar asgjë nga tmerret e fundshekullit të kaluar, duket se qëndrimin në këtë tokë po e sheh si paaftësi, ngecje e qyqari. Ta pafuqishëm për të hedhur fajin mbi mungesën e lirisë, një pjesë e këtij populli, kërkon me llupë ndonjë pretekst fantom veç sa për alibi, që dheut të çliruar tash e 25 vjet, t’ia kthejë shpinën pa u matur dy herë. Është ky një varfërim edukativ e mungesë ndërgjegjësimi për atdheadashurinë e çiltër, në saje të së cilës mbijetoi e pastaj edhe u formua shteti ynë. E për më tepër, një frymë e tillë moskokëçarëse e braktisëse, s’mund të gjejë kurrë asnjë provë justifikuese në burimet tona islame.

Duke gjurmuar në shkëndijat profetike, vërejmë se i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s. të vetmen arsye që e gjeti për ta lëshuar atdheun e tij të shenjtë-Mekën, ishte fakti se ai nga aty po përzihej e po syrgjynosej nga fisi e populli i tij. Atje, në Medinë ku ai u arratis, nuk shkoi për një jetë më të mirë e as për rehati familjare. Shkoi, ngase u detyrua. I pikëlluar nga largimi, iu drejtua Mekës prej një kodrine të saj duke thënë: “Sa vend i bukur e i dashur për mua që je, eh sikur populli im të mos më përzinin prej teje, unë nuk do të banoja askund tjetër (në tokë).” Këso arsyesh për braktisjen e vendit, brezi ynë, tash e dy decenie duket se nuk i zotëron. Por, ndoshta Zoti e paska vënë në sprovë brezin e shekullit të kaluar që ta fitojë lirinë, e brezin aktual, po e vë në sprovë nëse po arrin që ta ruajë e ta manifestojë atë liri në tokën e çliruar. Brezi i kaluar tragjedinë arriti ta shndërronte në triumf, liri e në fund edhe paqe, ndërsa brezi aktual “lirinë” po e kupton si mundësi braktisjeje të tokës së çliruar dhe arratisje larg pellgut gjeografik të shqiptarëve. Kjo mendësi, sprovën e tillë e shndërron në fatkeqësi e arratisjen prej atdheut e vulosë si ligësi.

Mr. Driton Arifi

Komentimi i kaptinës El-Fet'h

Sabri Bajgora

Kaptina El-Fet'h, sipas mendimit unanim të dijetarëve është kaptinë medinase. Transmetojnë Ibn Durejsi, Nehasi, Ibn Merduvejhi dhe Bejhekiu nga Ibn Abasi të ketë thënë: Ka zbritur surja El-Fet'h në Medinë. Të njëjtin mendim, Ibn Merduvejhi e përcjell edhe nga Ibn Zubejri.¹ Transmeton Bejhekiu nga Ibn Mahrime dhe Mervani të kenë thënë: Ka zbritur surja El-Fet'h në mes Mekës dhe Medinës, në lidhje me çështjen e Hudejbijes, prej fillimit e deri në fund.² Natyrisht, ky mendim nuk vjen në kundërshtim me faktin se surja është medinase, sepse çka ka zbritur pas hixhretit, llogaritet zbritje medinase, pavarësisht se në ç'vend ka zbritur.

Kjo sure ka gjithsej 29 ajete, 560 fjalë dhe 2438 shkronja.³ Ka zbritur pas sures Es-Saff dhe para sures Et-Tevbe. Në radhitjen e Mus'hafit mban numrin 48, kurse në radhitjen e zbritjes, sipas transmetimit që përcillet nga Xhabir bin Zejdi⁴, është e 113-ta.⁵

EMËRTIMI I KËSAJ SUREJE

Kjo sure njihet me emërtimin El-Fet'h që nga koha e sahabëve. Transmetohet nga Abdullah ibn Mugaffel të ketë thënë: "I Dërguari i Allahut, në ditën e çlirimit të Mekës, e lexoi "Suretu-l Fet'h", dhe e përsëriti atë disa herë."⁶

Fjala "El-Fet'h" në këtë sure është përmendur tri herë. Së pari surja nis me përgëzimin e besimtarëve me "çlirim - Fet'h", qysh në ajetin e parë: "Ne të dhamë ty një fitore të madhe"; pastaj vazhdon me ajetin 18: "... prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt (çlirimin e Hajberit)"; dhe me ajetin 27: "... Ai dinte atë që ju nuk e dinit. Veç kësaj, Ai ju dha një fitore të afërt (Hajberin)."

Kjo sure, nga ana e dijetarëve, nuk njihet edhe me ndonjë emërtim tjetër, pos këtij El-Fet'h.⁷



VLERA E KËSAJ SUREJE

- Surja El-Fet'h bën pjesë në grupin e sureve "El-Methani". Në lidhje me këtë, transmetohet nga Vathilete ibnul Eskaë el-Lejthi, të ketë thënë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: "Më është dhënë në vend të Teveratit, shtatëshja, (suret nga El-Bekare e deri tek El-Enfal ose Et-Tevbe); më janë dhënë në vend të Zeburit, "El-Mi'ine" - njëqindëshet, (suret që kanë mbi 100 ajete); më janë dhënë në vend të Inxhilit "El-Methani" - (suret që kanë më pak se 100 ajete), ndërsa jam mbinderuar (ndaj të dërguarve të tjerë) me suret "El-Mufassal" (nga sureja Kaf, e është thënë nga El-Huxhurat, deri tek En-Nas)."⁸

- Transmetohet nga Abdullah bin Mugaffel të ketë thënë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut në ditën e çlirimit të Mekës, duke e lexuar suren El-Fet'h dhe duke e zgjatur zërin gjatë këndimit të saj."⁹

- Në një transmetim tjetër të Muslimi thuhet: "Ka lexuar i Dërguari i Allahut s.a.v.s., në vitin e Çlirimit, në një udhëtim të tij, suren El-Fet'h, duke qenë mbi kafshën (devenë) që e bartte, dhe e zgjaste zërin gjatë këndimit të saj."¹⁰

- Transmetohet nga Ebi Berezete el Eslemij të ketë thënë: I Dërguari i Allahut e lexonte në namazin e sabahut: "Inna fetahna leke fet'han mubina."¹¹

- Transmetohet nga Zejd bin Eslemi e ky nga babai i tij të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ishte në një udhëtim prej udhëtimeve të tij, e me të, po udhëtonte natën edhe Omer ibnul Hatabi. Omeri r.a. e pyeti të Dërguarin a.s. për diçka, por ai nuk iu përgjigj. E pyeti për së dyti, por ai prapë nuk iu përgjigj, e pastaj e pyeti për së treti dhe ai sërish nuk iu përgjigj. Atëherë Omeri r.a. tha: Të vajtostë nëna jote o Omer (mjerë për ty o Omer). Insistove në pyetje tek i Dërguari i Allahut tri herë dhe ai nuk t'u përgjigj! Pas kësaj, thotë Omeri, lëviza me devenë ime dhe dola para myslimanëve, dhe kisha frikë në mos po zbriste diçka për mua nga Kurani. Dhe përnjëherë dëgjova dikë që po thërriste me zë të lartë emrin tim. Atëherë m'u shtua frika edhe më shumë se vërtet diçka paska zbritur për mua. Erdha pranë të Dërguarit të Allahut dhe me ndrojtje i dhashë selam, ndërsa ai më tha: "Sonte më ka zbritur një sure, e cila për mua është më e dashur se çdo gjë tjetër që e ndriçon dielli" dhe e lexoi: "Inna fetahna leke fet'han mubina..."¹², e në një version tjetër: "Mbrëmë më ka

"Kur pati zbritur "Inna fetahna leke fet'han mubina" e deri tek ajeti "fevzen adhima", në të kthyer nga Hudejbija, shumë prej sahabëve i kishte kapluar pikëllimi dhe trishtimi. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut i pati prerë kurbanet në Hudejbije dhe pati thënë: "Sonte më ka zbritur një ajet, që është më i dashur për mua se e tërë bota dhe ç'ka në të."

zbritur një sure e cila për mua është më e dashur se e tërë bota dhe ç'ka në të", dhe e lexoi: "Inna fetahna leke fet'han mubina..."¹³

- Transmetohet nga Enes ibn Maliku r.a. të ketë thënë: "Kur pati zbritur "Inna fetahna leke fet'han mubina" e deri tek ajeti "fevzen adhima", në të kthyer nga Hudejbija, shumë prej sahabëve i kishte kapluar pikëllimi dhe trishtimi. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut i pati prerë kurbanet në Hudejbije dhe pati thënë: "Sonte më ka zbritur një ajet, që është më i dashur për mua se e tërë bota dhe ç'ka në të."¹⁴

SHKAKU I ZBRITJES SË KËSAJ SUREJE

Ashtu siç dihet, kjo sure ka zbritur pas marrëveshjes së Hudejbijes, në një prej netëve të vitit të 6 hixhrij, në të kthyer nga Hudejbija, në vendin e quajtur "Kura'a-l Gamim" afër Mekës.¹⁵ Sidoqoftë, ndonëse kjo sure ka zbritur si tërësi, për një natë dhe ndërlidhet krejtësisht me marrëveshjen e

Hudejbijes dhe frytet e saj, megjithatë, disa ajete të kësaj sureje, edhe mund të ndërlidhen me ndonjë shkak specifik të zbritjes, që po ashtu kanë të bëjnë me dhe rreth Hudejbijes, për ç'gjë do të flasim më gjerësisht gjatë komentimit të tyre.

LIDHJA E KËSAJ SUREJE ME ATË PARAPRAKE – "MUHAMED"

- Përderisa në suren paraprake Muhamed apo siç e quajnë disa El-Kital, janë përmendur disa gjëra rreth luftës ndaj jobesimtarëve, pastaj rreth paqes dhe marrëveshjeve me jobesimtarët, të cilat në disa raste janë të lejuara, tash në suren El-Fet'h, flitet konkretisht për paqen-marrëveshjen e Hudejbijes, frytet e së cilës ishin shumë të mëdha e produktive për myslimanët, madje për dhjetëra herë më të frytshme sesa vetë lufta.

- Në suren Muhamed, në disa ajete është përmendur lufta, xhihadi dhe dhënia në rrugën e Allahut, kurse tash në këtë sure El-Fet'h vjen përgëzimi për çlirim, ngadhënjim dhe fitore të myslimanëve,¹⁶ e që në këtë sure në radhë të parë synohet marrëveshja e Hudejbijes, e cila do të ishte pararendëse e çlirimit të Hajberit dhe pas dy vitesh edhe e çlirimit të Mekës.

- Në suren Muhamed, ajeti 10, Allahu xh.sh. i fton njerëzit që logjikojnë, që të shohin se ç'përfundim patën ata që nuk besuan, duke u treguar se: "...Allahu i shkatërroi-shfarosi ata



plotësisht, e kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë”, e tash në suren El-Fet’h, flet për fitoren e madhe që iu dha Muhamedit a.s., me paqen e Hudejbijes, e më pas me çlirimin e Hajberit, të Mekës, dhe çlirimeve të tjera që kurrë nuk u ndalën: “Ne të dhamë ty një fitore të madhe, që Allahu të t’i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë, dhe që Allahu të të përkrahë me një ndihmë të fortë.” - (El-Fet’h, 1-3).

- Në suren Muhamed, në ajetin e 7-të: “O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”, është përmendur fakti se kush e ndihmon Allahun, që në mënyrë figurative nënkupton “kush kërkon ndihmën e Allahut”, Ai do t’ia japë atë ndihmë dhe ngadhënjim, dhe kjo ndihmë është portretizuar në suren El-Fet’h, kur shohim realizimin e premtimit të Allahut qysh në ajetin e parë: “Ne të dhamë ty një fitore të madhe”, për të vazhduar pastaj edhe me ajetin e 28-të, të po kësaj sureje: “Është Ai që e dërgoi të Dërguarin e Vet me udhëzim dhe fe të vërtetë, për ta lartësuar atë mbi çdo fe. Mjafton Allahu si dëshmitar!”

- Si në suren paraprake, ashtu edhe në këtë, El-Fet’h, janë përmendur cilësitë e besimtarëve, të idhujtarëve dhe të hipokritëve. Në fund të sures Muhamed,

ajeti 34, në shenjë të jobesimtarëve, idhujtarëve dhe hipokritëve thuhet: “Pa dyshim, ata që nuk besojnë, dhe pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut pastaj vdesin si jobesimtarë, Allahu nuk do t’i falë kurrë.”, kurse në suren El-Fet’h, ajeti 6, thuhet: “Ai (Allahu) do t’i ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtarët, që kanë mendim të keq për Allahun. Atyre iu ktheftë çdo e keqe. Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe ua ka përgatitur Xhehenemin. Eh, sa vend i shëmtuar është ai.”

- Në suren Muhamed, ajeti 19, i Dërguarit i Allahut është urdhëruar që të kërkonte falje për vete dhe për besimtarët e besimtare: “...Kërko falje për gjynahet tua, për besimtarët e për besimtare!”, ndërkohë surja El-Fet’h, është hapur me përmendjen se falja-magfireti i Allahut, tashmë është realizuar: “Ne të dhamë ty një fitore të madhe, që Allahu të t’i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë.” - (El-Fet’h, 1-2)

- Në suren Muhamed, në ajetin 31: “Ne do t’ju vëmë në provë derisa t’i njohim ndër ju, luftëtarët (muxhahidët) dhe të qëndrueshmit, dhe derisa t’i vërtetojmë të bëmat tuaja.” dhe në ajetin 35: “Mos u ligështoni e të kërkon armëpushim, kur ju

Kjo kaptinë e bekuar, e cila simbolizon një prej fletëve më të ndritshme të historisë islame, fillon me përgëzimin e të Dërguarit të Allahut me një ngadhënjim-çlirim të madh, i cili nënkupton marrëveshjen e Hudejbijes,

jeni më të fortët dhe Allahu është me ju! Ai nuk do t'jua pakësojë kurrë (shpërblimin për) veprat tuaja.”, flitet për besimtarët e sinqertë, të cilët Allahu i fuqizoi me iman të fortë e të paluhatsëm për t'u përballur me çdo sfidë gjatë rrugëtimit të tyre në lartësimin e fjalës së Allahut, tash në suren El-Fet'h, ajeti 10, i Madhërishmi i lavdëron këta besimtarët të cilët nën hijen e pemës në Hudejbije, ia dhanë besën të Dërguarit a.s. se do t'i qëndrojnë besnikë kauzës islame: “Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut...”

PËRMBAJTJE E SHKURTËR E KËSAJ KAPTINE

Kjo sure është zbritje medinase. Ka zbritur natën, menjëherë pas marrëveshjes së Hudejbijes, gjatë kthimit në Medinë. Edhe në këtë sure, si pothuajse në të gjitha suret medinase flitet rreth mynafikëve, që shtreshin si myslimanë, e në fakt, nuk ishin të tillë.

- Kjo kaptinë e bekuar, e cila simbolizon një prej fletëve më të ndritshme të historisë islame, fillon me përgëzimin e të Dërguarit të Allahut me një ngadhënjim-çlirim të madh, i cili nënkupton marrëveshjen e Hudejbijes, dy vite pas së cilës pasoi edhe çlirimi i Mekës dhe përhapja e rrufeshme e Islamit në Gadishullin Arabik. Zaten, marrëveshja e Hudejbijes është pika e kthesës në relacionet e reja në ato hapësira, sepse që nga ky çast, drita e Islamit, në mënyrë të pandalshme pushtoi zemrat e njerëzve, saqë pas 2 vjetëve, u mundësua edhe çlirimi i Mekës, pa luftë dhe pa kurrfarë kushtesh, gjë e cila deri në këtë marrëveshje, për shumë kë, dukej si një ëndërr e largët. (Shih ajetet: (1-3).

- Më pas, në ajetet (4-9), Allahu i Madhërishëm njofton se premtimi i Tij ndaj besimtarëve, si dhe kërcënimi ndaj jobesimtarëve dhe mynafikëve, gjithsesi do të realizohet.

- Allahu ishte i kënaqur me besimtarët, të cilët duke ia dhënë besën të Dërguarit të Allahut, nën pemën e një kopshti të Hudejbijes, ata në fakt po ia jepnin besën Allahut, se do të vazhdonin ta përhapnin dritën e këtij besimi të pastër. (Shih ajetet: (8-10).

- Në ajetet vijuese (11-17), shohim një tërheqje të vërejtjes apo qortim të ashpër publik, për mynafikët-hipokritët, të cilët ishin ndarë nga Resulullahu s.a.v.s., duke e lënë atë të nisëj i vetëm në Hudejbije, me besimtarët e sinqertë. Në vazhdim të këtyre ajeteve, jepet justifikimi për mospjesëmarrje në luftë, për disa kategori të caktuara (të verbrit, të çalët dhe të sëmurët), të cilët për shkak të kufizimeve që kishin, nuk kishin mundësi të ishin në radhët e parë të luftëtarëve në rrugën e Allahut. Për ta mjafton nënshtrimi, bindja dhe përlësia ndaj Allahut, për të arritur kënaqësinë e Tij dhe të Resulullahut s.a.v.s.

- Më pas, është cekur mirësia dhe dhuntia e Allahut ndaj besimtarëve me lidhjen e kësaj marrëveshjeje të Hudejbijes,

e cila kishte ndaluar përkohësisht luftën në mes dy palëve, ndonëse myslimanët sipas kësaj marrëveshjeje u penguan të hynin në Mekë atë vit dhe të bënin tavafin rreth saj. (Shih ajetet: (18-19).

- Pas kësaj pason premtimi hyjnor për myslimanët, se çlirimet e reja do të vazhdojnë dhe se ata do të jenë pala ngadhënjyese. (Shih ajetet: (20-24).

- Besimtarëve ju bëhet me dije edhe njëherë se marrëveshja në Hudejbijes ishte fitorja më e madhe e myslimanëve, pas të cilës më nuk do të kishte kurrfarë pengesash deri në ngadhënjimin final. (Shih ajetet: (25-26).

- Në ajetet e fundit të kësaj sureje, vjen përgëzimi për të Dërguarin a.s. duke ia bërë me dije se i qe realizuar ëndrra e mirë, të cilën e kishte parë në Medinë, se ata do të hynin triumfalisht në Mekë, të sigurt dhe të qetë. Këtë e kishin realizuar në vitin pasues, duke kryer umren, ndërkohë që banorët e Mekës i kishin lëshuar shtëpitë e tyre për disa ditë. Krejt në fund, konfirmohet se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Zoti, e së bashku me të në shpërndarjen e dritës së Islamit do të jenë edhe sahabët e tij të ndershëm, të cilët Allahu i Madhërishëm i ka lavdëruar me epitetet më të larta e më të lavdishme. (Shih ajetet: (27-29). - vijon -

- 1 Imam Shevkani, Fet'hul Kadir, Mensure-Egjypt, 1994, vëll. V-të, f. 58.
- 2 Dr. Muhamed bin Abdurrahman esh-Shajrë, Esmau suverit-l Kurani-l Kerim, Rijad, 2011, f.14.
- 3 Fejruzabadi, Besairu dhevi-t-temjizi, Kajro, 1996, vëll. I-rë, f. 432.
- 4 Xhabir bin Zejd el Ezdij el Basrij (21 h. - 93 h.) - (642-712 e.r.), ishte nga gjenerata e tabiinëve dhe njëri prej imamëve më të mëdhenj të kësaj gjenerate. Kur vdiq ky, Katadeja pati thënë: “Sot vdiq më i dijsmi i Irakut”. Shih: Hajruddin Ez-Zirikli, El-A'lam – Kamusu teraxhim esh'her er-rrixhali ve-n-nisai mine-l arabi ve-l musta'ribine ve-l musteshrikine , Bejrut, 2002, vëll. II, f. 104.
- 5 Ibn Ashur, Et-Tahriru ve-t-Tenviru, Tunis, 1984, vëll. XXVI, f. 142; Ahmed bin Muhamed bin Abdullah et-Tavil, Muhtevejatu suverit-l Kurani-l Kerim, Rijad, 2013, f. 285.
- 6 Buhari, hadithi nr. (4835) vëll. VI, fq.347; Muslimi, hadithi nr. (794) vëll. I, f. 547.
- 7 Dr. Munire Muhamed Nasir ed-Devserij, Esmau suverit Kurani ve fedailuha, f. 391.
- 8 Transmeton Imam Ahmedi (4/107); Bejhëku në Shuabi-l Iman (2/465).
- 9 Sahihul Buhari (4281); Sahihu Muslim (794).
- 10 Grup autorësh, El-Kitabul Xhamiu li fedailil Kurani-l Kerim, f. 97.
- 11 Transmetim 'sahih', dhe e ka shënuar Hafidh Abdu-r-Rrezzaku në Musannef (2/218), ndërkohë që edhe vargu i njerëzve që e transmetojnë është i besueshëm. Shih: El-Kitabul xhamiu, f. 97.
- 12 Sahihul Buhari, (5012); Shih edhe: Ahmed ibn Fet'hi el-Bekiri, Es-Sahihu-l-Musnedu min fedailil-Kurani ve suverihit ve ajatihit, Huber, 1431 h. f. 102.
- 13 Transmeton Buhari në Sahihun e tij, hadithi nr. (4177); Shih: Shejh Muhamed bin Rizk bin Tarhuni, Mevsuatu fedailu suverit ve ajatihit-l Kuran, Xhedë, 1414 h. vëll. II, f. 120.
- 14 Sahihul Buhari “Kitabul Megazi-Gazvetul Hudejbije”, hadithi nr. (3895); Sahihu Muslim “Kitabul xhahadi ve-s-sejri- babu Sulhu Hudejbije”, nr. i hadithit (3854). Shih edhe: Fahrudin bin Zubejr el Muhsi, Ed-Durrer min sahihit fedailil-ajati ve-s-suver, UAE, 2004, f. 40.
- 15 Et-Tahriru ve-t-Tenviru, vëll. XXVI, f. 141; Sot ky vend quhet “Berkaa-l Gamim” dhe është përafërsisht 60 km. larg Mekës, shih: <https://www.pinterest.com/pin/308144799485094203/>.
- 16 Shih më gjerësisht: El-Bukai, Nadhmu-d-durrer fi tenasubi-l ajati ve-s-suver, Hajdarabad, 1969, vëll. XVIII, ff.278.

Mesazhe pa fund të Israsë dhe Miraxhit

Dr. Jusuf el Kardavi

Në zemrat tona, sërish fryn aroma e Israsë, i trazon pasionet e mallit, e të cilat janë fllad i kujtimit të Miraxhit.

Përkujtimi i Israsë dhe Miraxhit me vete sjell dhimbje dhe shpresë, e që ne i zgjedhim disa prej atyre mësimëve, që të na ndriçojnë rrugën e ardhmërisë sonë. Atëherë, ejani të dashurit e mi, të ndalemi me disa nga mësimet e Israsë dhe Miraxhit, e të marrim pak frymëzim nga kjo ngjarje, në këto rreshta që nuk do të mund t'i përfshijmë të gjitha mesazhet e kësaj ngjarjeje të madhe.

MESAZHI I PARË - NJË FIJE SHPRESE NË NJË KOHË DËSHPËRIMI

Në brendësi të çdo sprove, fshihet një dhuratë; pas çdo vështirësie, vjen lehtësimi; pas natës së errët, vjen agimi i vërtetë që fshinë tërë errësirën. Kurejshitet kishin bllokuar rrugën përballë thirrjes islame në Mekë, siç i kishin rrethuar edhe njerëzit e saj nga çdo anë, gjersa Muhamedi a.s. ishte në rrezik pas vdekjes së xhaxhait të tij, Ebu Talibit, dhe gruas së tij, Hatixhes; kështu që kishte vendosur të shkonte në Taif, e ku as aty nuk gjeti nga banorët e saj asgjë tjetër përveç kundërshtimit dhe lëndimit të tij, duke e gjuajtur me gurë. Përballë tërë kësaj situatë që çoi në dëshpërim dhe zhgënjim, gjersa dyert ishin të mbyllura e nuk kishte kah t'ia mbante, megjithatë i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., besimin e kishte të palëkundur në Zotin e tij dhe vendosi të kthehej në Mekë. Zejdi, sahabiu shoqëruar i tij, kur e pa vendosmërinë e Muhamedit a.s. për t'u kthyer sërish në Meke, pas lëndimit të tij në Taif, i tha: "O i Dërguar i Zotit, si do të riktheheni në Meke, kur banorët e saj të dëbuan nga ajo?" Atëherë ai i përgjigjet: "O Zejd, Allahu do të bëjë lehtësim dhe rrugëdalje nga ajo që sheh." Cili ishte rezultati i kësaj sigurie? Ç'ndodhi pas sprovave me të? Erdhi ndodhia e Israsë dhe Miraxhit, ashtu siç e kishte planifikuar Allahu xh.sh., një udhëtim nderimi dhe përzgjedhjeje: "Pa të meta është Lartmadhëria

e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamës (i punëve të Muhamedit).¹ Ky është një mesazh për çdo mysliman dhe besimtar, që nëse ju godet fatkeqësia, e ju pakësohen miqtë, ndërsa armiqtë ju shtohen, të afërmit largohen nga ju, ndërsa njerëzit ju braktisin, atëherë thirr: "O Allah!", dhe ji i sigurt në rrugëdalje, fitore e fuqizim.

MESAZHI I DYTË - JU E KENI UDHËHEQJEN E NJERËZIMIT, ATËHERË PSE E BRAKTISNI ATË?!

Kur Muhamedi a.s. udhëtoi nga Qabeja në Mesxhidi Aksa, ai u priu si imam në namaz peygamberëve, ashtu siç theksohet në hadithin e Muhamedit a.s. kur e tregon ndodhinë e Israsë dhe Miraxhit: "Kur erdhi koha e namazit, u priva në namaz." Namazi

Namazi i Muhamedit a.s. si imam i peygamberëve, mbart një mesazh të rëndësishëm, e ai është se të gjithë peygamberët e Zotit ia kanë dorëzuar Muhamedit a.s. udhëheqjen e njerëzimit, kështu që ndjekësit e tij e kanë për obligim ta mbajnë këtë flamur pas tij dhe të jenë pionierët dhe udhëheqësit e njerëzimit



i Muhamedit a.s. si imam i pejgamberëve mbart një mesazh të rëndësishëm, e ai është se të gjithë pejgamberët e Zotit ia kanë dorëzuar Muhamedit a.s. udhëheqjen e njerëzimit, kështu që ndjekësit e tij e kanë për obligim ta mbajnë këtë flamur pas tij dhe të jenë pionierët dhe udhëheqësit e njerëzimit, dhe se metodologjia që e ka lënë Muhamedi a.s. në mesin e tyre ka qenë metodë e lumturimit të njerëzisë dhe zhvendosjes së tyre nga errësira në dritë, a nuk ka thënë Allahu: “Gjithashtu (sikundër që ju kemi udhëzuar në rrugë të drejtë) ju kemi bërë popull të drejtë, që të bëheni dëshmitarë të njerëzve dhe që Pejgamberi të jetë dëshmitar i juaji. Ne nuk e kemi bërë obligim kthimin tënd kah Qabeja (o Muhamed!) për tjetër arsye, por vetëm për të parë se kush ndjek rrugën dhe kush do të shkojë pas Pejgamberit e për t’i dalluar nga ata që kthehen nga thembrat. Ky ndryshim është i rëndë, por jo për ata që i ka drejtuar Zoti në rrugë të drejtë. E, se, Perëndia nuk ua humbë besimin tuaj (namazin që keni bërë kah Kuds), se Perëndia, me të vërtetë, është fort i dhembshëm dhe mëshirues për njerëzit.”²

Njerëzimi mbet i mjerë nga momenti kur myslimanët e braktisën rolin e tyre dhe ua dorëzuan udhëheqjen atyre që nuk e vlerësojnë njerëzimin e që nuk dinë asgjë veç gjuhës së shkatërrimit dhe të vrasjes.

MESAZHI I TRETË - MESXHIDI AKSAJA DHE QABEJA JANË SI DY MOTRA, KUSH E NEGLIZHON NJËRËN PREJ TYRE, NEGLIZHON EDHE TJETRËN

Në Fjalën e Zotit: “Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa...”³, është një lidhje mes Qabesë dhe Mesxhidi Aksasë, prandaj këtu duhet të ndalojmë e t’i analizojmë disa aspekte:

Ndalesa e parë: Kjo lidhje na bënë me dije se çdo kërcënim ndaj Mesxhidi Aksasë është kërcënim edhe për Qabenë dhe

popullin e saj, dhe se sulmi ndaj Mesxhidi Aksasë është pararendës i sulmit ndaj Qabesë, dhe se marrja e Mesxhidi Aksasë nga duart e myslimanëve dhe rënia e saj në duart e hebrenjve do të thotë kërcënim i sigurisë në Qabe dhe Hixhaz, dhe se hebrenjtë kurrë nuk i fshehën ambiciet e tyre në Qabe.

David Ben Gurioni, kur e pushtoi Jerusalemin, e mbajti një fjalim para ushtarëve dhe të rinjve hebrenj pranë Mesxhidi Aksasë, fjalimin e tij e përfundoi duke thënë: “Kemi pushtuar Jerusalemin, dhe jemi rrugës për në Jethrib-Medine.”

Ashtu siç kishte mbajtur një fjalim edhe Golda Meir, pas pushtimit të Jerusalemit: “E ndjej aromën e të parëve të mi në Medine e Hixhaz, e ato janë vendet tona që do t’i rikthejmë.”

Për çdo mysliman, mesazhi është shumë i qartë, e kushdo që e neglizhon Mesxhidi Aksanë, do ta ketë të lehtë ta neglizhojë edhe Qabenë.

Ndalesa e dytë: Lidhja mes Mesxhidi Aksasë dhe Qabesë i bën myslimanët të ndjejnë përgjegjësinë e tyre ndaj Mesxhidi Aksasë dhe rëndësinë e saj për ta, pasi që ajo është kibleja e parë e tyre.

Në kohën kur Mesxhidi Aksaja ra në kthetrat e kryqtarëve, atë e shpëtoi Salahudin el Ejubi, i cili gjatë natës i inspektonte ushtarët e tij. Në njërin prej tendave, i gjeti ushtarët e tij duke u falur, e u tha: “Nga këtu vjen fitorja.” Ndërsa në një tendë tjetër i gjeti ushtarët e tij duke fjetur, e u tha: “Nga këtu vjen disfata.”

(Burimi: <https://islamanar.com/israa-and-meraaj-3>).

Përktheu: Dr. Faruk Ukallo.

1 . El Isra, 1.

2 . El Bekare, 143.

3 . El Isra, pjesë nga ajeti 1.

Detyrat e besimtarit ndaj atdheut

Sead Paqarizi

Si çdo individ, edhe besimtari është pjesë e rëndësishme dhe e pandashme e shoqërisë dhe jetës shoqërore, ndaj së cilës ka obligime të ndryshme, varësisht nga jeta, profesioni, puna, vendi etj. Përveç detyrave ndaj Krijuesit, fesë, familjes, shoqërisë dhe rrethit ku jeton dhe vepron, ai ka detyra të rëndësishme edhe ndaj vendit ku ka lindur, ku jeton, ku vepron dhe ku gjen qetësinë dhe ndjehet komod, pra ndaj atdheut të tij.

Ç'ËSHTË ATDHEU?

Vendi ku kemi lindur dhe jetojmë ne dhe ku kanë jetuar të parët tanë, vendi ku banon prej kohësh një popull a një komb, vendi ku lind e zhvillohet diçka për herë të parë. Pra, njeriu si krijesë e Allahut xh.sh., u krijua nga dheu mbi të cilin ai do të jetojë dhe ai është vendqëndrimi i tij në këtë botë. Njeriu lind, ushqehet, jeton dhe vdes në tokë. Kjo tokë është vendi më i veçantë dhe kuptimplotë, vendi ku individ i ndjehet i lirë dhe i gëzuar, pra është atdheu, toka e përbashkët, që njeriu e ndan me llojin e tij njerëzor dhe me krijesat e tjera të Allahut xh.sh.. Atdheu nuk mund të përcaktohet si një vend vetëm me anën materiale si ajri, uji, toka etj., por atdheu e ka edhe anën shpirtërore dhe është burim i tërësisë së vlerave dhe komponentëve të shumta si feja, gjuha, tradita, kultura etj.. Njëkohësisht atdheu ku njeriu është lindur, rritur dhe jeton është shtëpia dhe streha (trualli) e tij më e dashur, ndër dhuratat më të çmuara dhe të veçanta që Allahu xh.sh. i ka dhuruar në këtë botë. Çdo njeri, burimin e dashurisë, mallit, pasionit dhe përkushtimit ndaj atdheut e ka në natyrën e krijimit të tij, burim nga i cili vjen edhe besimi i pastër në Zot.

ATDHEU DHE BESIMI

Njeriu ka në natyrën e tij të pastër, pra në fitre, ndjenjën e të besuarit në Zotin xh.sh.. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: “Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo



është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë” (Rum, 30). Nga ky ajet kuptohet se fitre (ndjenja fillestare për besim) është e pandryshuar, ndjenjë e cila lind dhe vdes me njeriun, e që është burim i pastër i besimit dhe njëkohësisht edhe lidhjes emocionale me atdheun dhe karakteristikat (komponentët) e tij.

Po ashtu, Allahu xh.sh., burimin e lidhjes emocionale dhe dashurisë ndaj vendlindjes na e kujton edhe përmes ajetit: “Prej asaj (tokës) Ne u krijuam ju, e ju do t’u kthejmë përsëri në të, e prej saj do t’ju nxjerrim edhe një herë.” (Ta Ha, 55), duke na kujtuar që toka është fillimi dhe përfundimi ynë në këtë jetë. Më mirë të jetohet me skamje në vendlindje se me kamje në kurbet, ngase njerëzit më shumë se çdo lloj pasurie i kushtojnë dhe duhet t’i kushtojnë rëndësi vendit të tyre.

Shumë ngjarje dhe fakte historike dëshmojnë për përkushtimin që njerëzit kanë ndaj atdheut. Edhe në Kuran përmenden ngjarje që dëshmojnë lidhjet e fuqishme të njerëzve me tokën dhe atdheun e tyre. Në ajetin: “Sikur Ne t’i urdhëronim ata ‘vritni veten’ ose ‘lini shtëpitë tuaja, pak prej tyre do ta bënin këtë...’” (Nisa 66), Allahu xh.sh. e ka krahasuar dashurinë për jetën me dashurinë ndaj vendlindjes. Një argument tjetër që dëshmon se lidhja me atdheun është një ndjenjë e mishëruar te njeriu është ajeti: “...e përse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, ne që jemi dëbuar nga atdheu ynë dhe jemi ndarë nga fëmijët tanë?!” (El Bekare, 246), ku Allahu xh.sh. ndarjen nga fëmijët dhe dëbimin nga atdheu e ka konsideruar si shkak luftë.

Një ndër argumentet më të fuqishme të përkushtimit dhe dashurisë që besimtari duhet të ketë për atdheun e tij është porosia e Jusufit a.s. që trupin e tij të vdekur ta dërgojnë për ta varrosur në atdheun e të parëve të tij, të Jakubit, Is’hakut e Ibrahimit a.s.. Duke i ditur vuajtjet e Jusufit a.s. dhe vështirësitë e tij me vendin e tij, edhe pse vdiq si udhëheqës i Egjiptit, kërkoi që trupi i tij të varroset në vendlindjen e tij.

Dashurinë për atdheun e kishte të brumosur në shpirt edhe i Dërguari a.s., i cili për dashurinë që kishte ndaj vendlindjes së tij, Mekës së bekuar, është shprehur: “Sa vend i bukur që je, sa e dashur më je! Sikur populli yt të mos më nxirrnin me dhunë prej teje, kurrë nuk do të kisha banuar diku tjetër.” (Tirmidhiu, Menakib, 68). Andaj, besimtari duhet që ta ketë në konsideratë lidhjen burimore të besimit dhe ndjenjës së fuqishme që kanë njerëzit që nga lindja ndaj vendlindjes, dhe si të tillë ta ruajë paralelen e respektit, dashurisë dhe përkushtimit ndaj tyre.

DETYRAT PARËSORE NDAJ ATDHEUT

Besimtari ka për detyrë, që krahas devotshmërisë ndaj Allahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij, si dhe ndjekjes së

Mbrojtja e atdheut nga ana e besimtarit duhet të përfshijë mbrojtjen e tokave, jetës, pasurisë, fesë dhe nderit të njerëzve që jetojnë në atë vend, duke siguruar liri dhe siguri për të gjithë banorët.

parimeve fetare, të jetë i përkushtuar me bindje dhe vepra edhe ndaj atdheut të tij, duke kryer obligimet dhe detyrat që ka ndaj tij. Të gjitha vendet ndërtohen e zhvillohen mbi bazën e dashurisë që njerëzit kanë për to. Andaj besimtari përveç dashurisë dhe lidhjes emocionale ndaj atdheut, duhet të kryej edhe obligimet dhe detyrat ndaj tij, prej të cilave mund të veçohen:

DASHURIA

Më sipër u potencua se dashuria ndaj atdheut është e rrënjësuar nga Allahu xh.sh. në zemrën dhe gjenet e çdo njeriu. Dashuria ndaj atdheut kërkon sakrificë, vetëflijim, kontribut dhe angazhim maksimal për të mirën e atdheut. Dashuria ndaj atdheut kërkon individë të ngritur shpirtërisht, të ditur, syhapur, të vëmendshëm, prindër të mirë dhe profesionist, të përgatitur e shumë të përgjegjshëm.

DIJA DHE EDUKIMI

Dituria, dija, arsimimi dhe edukimi i drejtë është obligim për çdo besimtar. Me qindra herë në Kuran dhe hadithe të Pejgamberit a.s. është përmendur vlera, nevoja dhe rëndësia e dijes, arsimimit dhe edukimit. Urdhri i parë që ka zbritur, është urdhri për të lexuar, studiuar dhe medituar. Një realitet i njohur për pozitën e diturisë në Islam është po ashtu lirimi i robërve të luftës, të cilët ia kanë mësuar shkrim-leximin një myslimani. Andaj besimtari para së gjithash duhet që të jetë i ditur, të edukojë dhe nxisë të rinjtë për të mësuar, studiuar dhe edukuar në frymën shkencore, sepse kështu ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin dhe avancimin e atdheut të tij. Edukimi në frymën fetare dhe kombëtare është një traditë e të gjithë prijësve fetarë të trojeve tona. Andaj këtë traditë duhet ta vazhdojnë me këmbëngulje edhe besimtarët bashkëkohorë.

BESNIKËRIA

Prej virtyteve të larta dhe të pandara të besimtarit është edhe besnikëria, e cila përfshinë adhurimet, detyrat fetare dhe morale, me një fjalë, të gjitha sferat e jetës. Besnikëria e cila fuqishëm mbështetet në sinqeritet dhe ndershmëri, ishte cilësi e çiltër e secilit pejgamber dhe secilit besimtar të devotshëm në jetën e tyre. Standardi i tyre madhor i besnikërisë duhet të jetë model për besimtarin në çdo çështje të jetës, duke ju referuar gjithnjë parimeve fetare (urdhrave të Allahut dhe porosive të të Dërguarit a.s.).

Padyshim se besimtari ka detyrë të jetë besnik edhe ndaj atdheut të tij, që përmes saj të kontribuojë në ngritjen dhe zhvillimin e shtetit dhe kombit të tij, si dhe të ngritë besueshmërinë dhe sinqeritetin në shoqëri. Islami ndalon në çdo aspekt tradhtinë dhe hipokrizinë. Përmes besnikërisë, edhe në çështjen e atdheut, besimtari ka për detyrë të ndalojë tradhtinë dhe hipokrizinë.

MBROJTJA

Duke pasur parasysh që atdheu është vendi ku mbrohen të drejtat, vendi ku njeriu ndihet i lirë dhe i sigurt, vendi ku nuk duhet të ketë shtypje dhe dhunë, Islami ka nxitur besimtarët që të mbrojnë atdheun, duke e konsideruar këtë si një detyrë dhe virtyt të lartësuar dhe të dinjitetshëm. Allahu xh.sh. në Kuran na ka treguar se përgatitja dhe gatishmëria për mbrojtjen e atdheut është obligim: “E ju përgatituni sa të keni mundësi forcë, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata...” (El Enfal, 60). Për virtytin e mbrojtjes së atdheut, i Dërguari a.s. ka thënë: “Një ditë e një natë roje është më e mirë se agjërimi i një muaji se bashku me faljen e natës. Në qoftë se personi vdes në roje (për shkak se ka vdekur në roje), do t'i vazhdojnë sevapet edhe risku edhe me tej dhe do të jetë i sigurt kur të merret në pyetje nga melekët në varr.” (Muslim, Imare, 163).

Mbrojtja e atdheut nga ana e besimtarit duhet të përfshijë mbrojtjen e tokave, jetës, pasurisë, fesë dhe nderit të njerëzve që jetojnë në atë vend, duke siguruar liri dhe siguri për të gjithë banorët. E shpërblimin e këtij virtyti të lartë më së miri na e tregon i Dërguari i Allahut ku thotë: “Ka dy sy që nuk i prek zjarri i Xhehenemit, syri që qan nga frika ndaj Allahut dhe syri që natën e kalon në roje për Allahun.” (Tirmidhiu, 12). Prandaj, në Islam, mbrojtja e atdheut, me pasuri e me trup, është parim i fesë, dhe numërohet kontribut i shenjtë, i cili gradohet lart dhe shpërblehet shumë nga Zoti. Pikërisht për këtë, sipas mësimëve të Islamit, dëshmorët nuk vdesin.

SAKRIFICA

Sakrifica si urtësi dhe një cilësi trimërie është pjesë e pandashme e jetës së njeriut. Në shumë faza të jetës kërkohet që njeriu të jetë i gatshëm për të flijuar për një çmim apo shpërblim më të madh. Andaj edhe besimtari ndjenjën për të flijuar dhe sakrifikuar e ka të brumosur në qenien dhe shpirtin e tij. Të dërguarit e Allahut xh.sh., si Ibrahim i a.s., Ismaili a.s., Muhamedi a.s. etj., si dhe shumë besimtarë të devotshëm ishin më së shumti të sprovuar me sakrificë dhe vetëflijim. Gatishmëria për të kontribuar për atdhe, në rast se kërkohet edhe dhënia e jetës janë prej virtyteve të pandashme të besimtarit. Besimtari ka për

detyrë që kur i kërkohet të luftojë, të japë jetën dhe të flijojë për atdhe, të punojë dhe të veprojë për të mirën e përgjithshme të atdheut dhe t'i shërbejë popullit dhe shoqërisë. Përsiatja e besimtarëve rreth sakrificës dhe flijimit duhet të bëhet preokupim i vazhdueshëm, që të gjejë mënyrën dhe rrugën që personalisht të sakrifikojë dhe të japë maksimumin për fe dhe atdhe. Sakrifica e besimtarit për atdhe është dëshmi e sinqeritetit dhe përkushtimit ndaj tij.

BAMIRËSIA

Një prej detyrave të besimtarit ndaj atdheut të tij është edhe bamirësia. Bamirësia ndaj atdheut është një detyrë e përhershme, pa marrë parasysh qasjen dhe padrejtësinë e të tjerëve, veçanërisht të pushtetit, ngase atdheu nuk mund të krahasohet me askënd, e as me pushtetin, ashtu siç është urdhëruar dashuria ndaj prindërve, pavarësisht kryerjes së detyrave të tyre ndaj fëmijëve. Nëse prindërit e lënë pas dore detyrimin e tyre për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe nuk e kryejnë siç duhet, kjo nuk e mohon detyrimin për të qenë bamirës ndaj tyre. E njëjta gjë është edhe me atdheun. Njësoj siç nuk mund të justifikohet me asgjë mosbindja ndaj prindërve, po ashtu nuk mund të justifikohet me asgjë pakujdesia jonë ndaj atdheut. Andaj, në çdo kohë besimtari është i detyruar të jetë bamirës ndaj atdheut të tij dhe të kontribuojë për të.

PËRFUNDIM

Krahas detyrimeve që ka ndaj fesë, besimtari ka detyrime dhe obligime edhe ndaj vendlindjes së tij dhe vendit ku ai jeton e vepron. Lidhja emocionale me atdheun dhe dashuria ndaj tij janë të krijuara dhe të brumosura bashkë me krijimin e njeriut. Besimtari duhet të dijë që paralelja mes besimit dhe dashurisë ndaj atdheut duhet ruajtur dhe respektuar. Gjatë tërë jetës së tij duhet që të angazhohet për mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë dhe vendit në të cilin ai jeton. Këtë më së miri mund ta bëjë duke kryer detyrat dhe obligimet ndaj atdheut të tij të përmendura më lartë, si dhe të kujdeset në veçanti për respektimin dhe zbatimin e ligjeve të atdheut të tij, të mos lejojë refuzimin e atdheut dhe çështjeve që lidhen me të dhe të japë maksimumin për zhvillimin dhe avancimin e tij.

Literatura e konsultuar:

Kurani, përkthim dhe komentim nga Sherif Ahmeti
Qazim Qazimi, *Histori e qytetërimit islam*, Prishtinë 2018
Kontributi i Prijësve Myslimanë në Formimin e Vetëdijes dhe Identitetit
Kombëtar, Konferencë Shkencore 28-29 shtator 2012, Tiranë 2013
Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, *Islami nëpërmjet haditheve*, ,
Islam Ansiklopedisi, ISAM,
M. Abdullah Draz, *Kuran Ahlaki*, Istanbul 2009.
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 2002.
Nexhat Ibrahim, *Fjalë pas fjale*, Logos-A 2016.

Shpirti sipas pikëpamjes së filozofëve islamë dhe mutekeliminëve

Dr. Bahri Hoxha

A DUHET TË DISKUTOHET PËR SHPIRTIN?

Kjo pyetje mund të lind si rezultat i një kuptimi fillestar e të pamjaftueshëm të ajetit kuranor, në të cilin Zoti përmend se çështja e shpirtit është nga çështjet e Zotit dhe se juve nuk u është dhënë dije për këtë gjë veçse pak. Allahu në Kuran thotë: “Të pyesin për shpirtin. Thuaju: “Shpirti është çështje e Zotit tim, kurse juve nuk u është dhënë nga dija për të veçse pak.” (El Isra, 85).

Në fakt, dijetarë të ndryshëm, sufistë dhe mendimtarë, anonin kah një vetëpërmbytje në aspekt të studimit të shpirtit. Xhunejdi, (v.298 h.) mendonte se nga bisedat për shpirtin duhet të kufizohemi vetëm në stadin e vërtetimit të ekzistencës së tij dhe jo më tepër. Ky ishte mendimi edhe i Ibën Abasit dhe shumicës së selefivë (tri gjeneratave të para). Imam El Lekani (v.1041 h), i përkiste këtij pozicioni dhe arsyetohej se përderisa nuk kemi tekst nga Kurani apo Suneti që detajon shpjegimin rreth shpirtit, edhe ne duhet të përmbahemi nga studimet rreth tij, duke u bazuar në një kuptim direkt të ajetit, i cili flet për shpirtin dhe i cili po ashtu ka qasjen e njëfarë mohimi të një definimi të realitetit nga studimet njerëzore.¹ Mirëpo, shumica e dijetarëve të Ehli Sunetit, por dhe të tjerë, arsyetojnë me plotë të drejtë çdo përpjekje studimore që ka të bëjë me definimin e sekreteve që kanë të bëjnë me jetën shpirtërore. Imam Gazali, konsideron se njohja e shpirtit, që në realitet përbën njohjen e njeriut ndaj vetvetes, është një para rrugë, për të arritur deri te një njohuri më e saktë ndaj Zotit të Madhërisë.² Imam Fahrudin Rrazi, po ashtu me shumë endje diskuton rreth realiteteve që kanë të bëjnë me aspektin shpirtëror të njeriut. Ai në tefsirin e njohur “Mefatihul gajb”, detajon mendimet e ndryshme në historiografinë islame, si dhe argumentet e qasjet e tyre rreth kuptimit të shpirtit. Përveç kësaj edhe Imam Ibën Kajim el Xhevziye, shkroi një libër me këtë tematikë dhe e titulloi “Kitabu Rruh - Libri mbi shpirtin”. Prandaj, qëllimi i kësaj hyrjeje është definimi i saktë i

mendimit rreth validitetit të një përfshirjeje studimore islame me tematikë shpirtërore dhe realitetet e saj. Kurse, sa i përket mundësisë së penalizimit të ndonjë studimi ndaj shpirtërores, të bazuar në kuptimin e ajetit të lartcekur, mund të themi se në ajet nuk mund të ketë ndonjë shenjë që do të mund të aludonte në moslegalizimin e studimeve rreth realiteteve shpirtërore.³ Kjo mund të konkludohet duke pasur parasysh disa aspekte të rëndësishme që përmban ajeti:

Aspekti i parë lidhet pikërisht me faktin se, në pyetjen që iu parashtrua Pejgamberit të Zotit, nuk pati ndonjë qortim nga shpallja. Sikur të ishte pyetja për shpirtin diçka që është në kundërshtim me mësimet e gjithmbarshme islame, patjetër që do cekej në ajet, përderisa ajeti zbriti me qëllim të shtjellimit të shpirtit si temë. Kurse mosdhënia e një përgjigjeje që definon shpirtin, siç thotë Imam Ibën Bettali (v.449 h), aludon në pamundësinë dhe nevojën e pashmangshme për ndihmën e Zotit, për të njohur njeriu qoftë edhe realitetin e vetvetes. Imam Kurtubiu (v.671 h), thotë se përderisa njeriu nuk ka mundësi ta njoh realitetin e shpirtit që e posedon, si ka mundësi të definojë realitetin e Qenies së Zotit xh.sh.?!)

Sikur të ishte pyetja për shpirtin diçka që është në kundërshtim me mësimet e gjithmbarshme islame, patjetër që do cekej në ajet, përderisa ajeti zbriti me qëllim të shtjellimit të shpirtit si temë.


Aspekti i dytë ka të bëjë me atë se Kurani, nuk hesht, kur parashtrahet pyetja rreth shpirtit. Por, në fakt, Kurani jep përgjigje rreth asaj që pyetet. Përgjigja e ajetit është shumë e thukhtë dhe e shkurtër: “Thuaj: “Shpirti është vepër (krijesë) e Zotit tim.” Shprehja (قل) në ajet është e barasvlershme dhe identike me shprehjet e ngjashme në pyetjet tjera kudo në Kuran, ku përdoret pyetja: “të pyesin” (يسألونك) dhe përgjigja: “thuaj” قل. Dijetarët islamë kanë konsensus të plotë - ixhma, se shpirti është krijesë e Zotit.

Aspekti i tretë, ajeti në fjalë nuk mohon çdo lloj të dijes rreth shpirtit. Përkundrazi, ajeti pranon se ne kemi një nivel njohurish rreth shpirtit, veçse ato janë të pakta. shtoja kësaj, faktin se njohuritë mund të zgjerohen me një vazhdimësi në kërkime shkencore, ani pse nuk guxon të pretendohet se ato do të definojnë realitetin e plotë të shpirtit. Thënë shkurt, me studimet rreth shpirtit, assesi nuk synohet të definohet çdo aspekt që ka të bëjë me realitetin e tij si entitet, por, meqenëse, është faktori kryesor në vetë njeriun, patjetër që duhet t'i qasemi me studime në aspektet të cilat lejojnë studimet shkencore të kenë qasje rreth tij, në mënyrë që të njohim më mirë efektet e tij, balancën, etj., duke mos cenuar aspektet e gajbit që mbesin të panjohura për njeriun. Kurse në ato aspekte, ku nuk arrin dot mendja të përpilojë ixhtihad rreth aludimit të teksteve, si dhe të bëjë sinkronizimin në mes praktikës njerëzore dhe tekstit fetar, pa dyshim që edhe dijetarët islamë shfaqin përmbajtje të rreptë dhe nuk lëshohen në diskutime nga hamendja. Vetë tekstet fetare nga Kurani dhe hadithet profetike tregojnë shumë aspekte që kanë të bëjnë me shpirtin, siç është çështja e vendndodhjes së shpirtit pas vdekjes, shpirtat e dëshmorëve, gjallëria e tyre, se shpirtat kur pajtojnë mes vete afrohen dhe anasjelltas. Të tëra këto aspekte janë të shtjelluara nga tekstet fetare.

Përveç kësaj, studimet që u bënë rreth shpirtit me kalimin e kohës themeluan shkencën e rëndësishme të psikologjisë,⁴ dhe disiplinat e saj.

IDENTITETI I SHPIRTIT TE FILOZOFËT ISLAMË

Te filozofët islamë, shpirti definohet si: “Substancë abstrakte që bashkëvepron me trupin në një nivel të caktuar dhe formë të caktuar.” Shpirti, sipas pikëpamjeve filozofike nuk është trup. Ata e quajnë “جوهر مجرد” – “Substancë abstrakte ose e zhveshur”, që ka për qëllim thjeshtësinë dhe jo përbërjen. Në disa nga emërtimet që i bëjnë shpirtit, vërehet edhe togfjalëshi: (جوهر بسيط) “جوهر بسيط” puro substancë- substancë e thjeshtë”, që në kuptimin filozofik, është diçka që nuk i përket botës lëndore, e cila njihet si “bota e komponimit dhe shpërbërjes” (عالم الكون والفساد). “Bota e komponimit dhe e shpërbërjes” përfshin çdo ekzistent që gjendet nën orbitën e Hënës.⁵ Shpirti, ani pse bashkëvepron me trupin, ai nuk i përket kësaj bote, por është me esencë mbi këtë



orbitë. Si i tillë, shpirti nuk është diçka që shkatërrohet, por është ekzistent i përjetshëm, që nuk pranon zhdukjen ose shpërbërjen. Shprehja: (بسيط)“i thjeshtë - puro”, ka këtë kuptim në filozofinë islame, diçka që nuk pranon as komponim, e si rezultat as shpërbërje. Komponimi dhe shpërbërja janë karakteristikë e trupave që janë të komponuar nga “katër elementet”⁶, kurse shpirti nuk është diçka i tillë.

IDENTITETI I SHPIRTIT SIPAS DIJETARËVE TË AKIDES (MUTEKELIMNËVE)

Te dijetarët e akides ka një llojllojshmëri në mendime rreth përkufizimit të shpirtit. Ata përfaqësohen kryesisht në dy grupime kryesore:

Grupi i parë përfaqësohet nga Imam El Gazali, Imam El Asbehani, Rraziu dhe disa dijetarë të tjerë, të cilët pajtojnë me supozimin e filozofisë islame se shpirti nuk është trup, por është «substancë abstrakte». Këta dijetarë bëjnë dallimin në mes shpirtit «nefs» dhe shpirtit «rruh». “Nefs” është po kjo substancë abstrakte, kurse “rruh” është një lloj “avulli abstrakt që ngritet nga zemra deri në trurin e njeriut dhe pastaj shpërndahet në gjithë trupin përmes enëve të gjakut”.⁷ Imam Gazaliu e paraqet shpirtin (rruh) si një lloj korenti që kurdo që është prezent në trup, i jep atij një lloj energjie për lëvizje që ne e quajmë gjallëri.⁸ Këtë mendim e përkrahin edhe një mori e autorëve bashkëkohorë.

Kurse grupi tjetër që përbën shumicën e dijetarëve të shkencës së Kelamit, supozojnë se “shpirti është “trup i tejdukshëm”, i cili rrjedh në trupin e njeriut përmes një funksioni të veçantë”.⁹ Pra, shpirti sipas shumicës së mutekeliminëve është trup që ndërlidhet dhe bashkë-funksionon me trupin tonë si udhëheqës i trupit dhe komandues i tij.

FORCAT E SHPIRTIT

Filozofët islamë, me theks të veçantë, i atribuojnë shpirtit forca të ndryshme, të cilat dallojnë nga forcat trupore në shumë aspekte. Ato dallojnë si për nga natyra, po ashtu edhe për nga aspekti i kapacitetit. Forcat shpirtërore sipas pikëpamjes filozofike, nuk kanë kufizim, mirëpo kur shpirti lidhet me trupin, ato forca sikur i detyrohen kësaj lidhjeje dhe kapaciteti i tyre zbret në nivelet e kufizimit trupor. Shpirti ka forca bimore, që ndihmojnë në rritje e zhvillim, forca shtazore, që synim kanë realizimin e pasioneve dhe forca të larta që synim kanë ngritjen e njeriut në aspektin shpirtëror, moral dhe shkencor. Disa nga forcat shpirtërore edhe pas lidhjes së shpirtit me trupin ruajnë pakufishmërinë dhe jokufizimin, siç janë forca e të menduarit, të dëshirës, imagjinatës etj. Kurse shumica e mutekeliminëve, përfshirë Gazalin, Raziun e disa të tjerë, këto forca njerëzore ua përshkruajnë edhe trupit, gjegjësisht bashkimit të trupit me shpirtin.

PËRJETËSIA E SHPIRTIT

Te filozofët islam, shpirti jo që nuk vdes dhe as shkatërrohet, por ai nuk pranon fare zhdukjen, sepse shpirti në definimin filozofik qëndron si substancë e thjeshtë, e cila siç u cek, nuk mund të pranojë shkatërrim e as vdekje.¹⁰ Ky qëndrim i filozofëve islamë kuptohet si një reflektim i një ndikimi direkt i filozofisë greke dhe jo vetëm, tek mendimi filozofik islam. Pra, se shpirtat janë substanca të thjeshta dhe si të tilla nuk ka mundësi t'i nënshtrohen zhbërjes, sepse në fakt ata nuk janë të përbërë, por janë të thjeshtë. Duke u nisur nga pozicioni që gëzon shpirti në relacion me trupin sipas pikëpamjeve filozofike, në momentin kur shpirti ndahet nga trupi, shpirti fiton një liri të paparë, e cila realizohet me thyerjen e kufijve trupor në të cilët shpirti kufizohet sa ishte në trup.¹¹ Ky është momenti kur shpirti kalon në përjetësi i pavarur nga trupi në çfarëdo kohe të ardhme dhe nuk kthehet më të bashkohet me trupin. Kjo përjetësi me këtë pavarësi, i mundëson shpirtit realizimin e lumturisë së përhershme.

Kurse te dijetarët e akides islame, shpirti është krijesë e Zotit, ka fillimin e vet dhe si i tillë pranon edhe shkatërrimin. Mirëpo shpirti është i përjashtuar nga shkatërrimi në Ditën e Kiametit, me Vullnet dhe Dëshirë hyjnore. Ky është mendimi unanim i gjithë Ehli Sunetit. Ibën Abasi r.a., e përmend shpirtin në mesin e krijesave të cilat nuk do të shkatërrohen Ditën e Kiametit.¹²

Në bazë të asaj që cekëm më lartë, vërehet se ka dallime bukur të mëdha ndërmjet qëndrimeve të filozofëve islamë dhe dijetarëve të akides – mutekeliminëve në tematikën e shpirtit, dhe ky dallim i përcjell dy shkollat gati në secilën pikë të kësaj teme. Dallueshmëria në mes dy shkollave qëndron edhe në faktin se filozofia islame ndërton qëndrimet rreth tematikës së shpirtit, duke u bazuar përskaaj teksteve islame edhe në fjalët e filozofëve jo islamë. Thënë më mirë, ajo mundohet të bëjë një gërshetim në mes mendimeve të mëhershme filozofike dhe teksteve islame, duke mos pranuar të heq dorë tërësisht nga asnjëri prej këtyre dy burimeve. Përderisa te mutekeliminët, kjo çështje është prej çështjeve të gajbit dhe si rezultat, konsiderohet se mbështetja e vetme valide është ajo në tekstin fetar, thënë më ndryshe në ixhtihadet që për bazë kanë vetëm gërshetimin në mes ajeteve dhe haditheve profetike.

PËRFUNDIM

Pra, siç e cekëm më sipër, shumica e dijetarëve të akides islame arsyetojnë kërkimet rreth realiteteve që kanë të bëjnë me shpirtin si entitet, brendapërbrenda njeriut, në aspektet që nuk janë gajb. Ndërsa shkolla e filozofisë islame e konsideron si një ndër temat kryesore të studimit, në përpjekje për të definuar drejt realitetin jetësor. Dallimi në mes dy qasjeve, të asaj filozofike islame dhe akaidologjike, fillon kryesisht nga vetë definimi, duke vazhduar pastaj deri te shumica e detajeve. Shkencat që studiojnë shpirtin, nuk e studiojnë atë nga aspekti anatomik, por nga aspekti i efekteve dhe natyrës së bashkëveprimit të forcave dhe animeve të nefsit – shpirtit, në mënyrë që besimtari të dijë se si të bashkëveprojë me natyrën e vet shpirtërore.

- 1 Shih: Ibrahim el Lekvani, *Umdetul murid sherh xhehereti tevhid*, (Dar Nurul mubin, Aman 2016), vëll. 3, f.1322.
- 2 Ebu Hamid el Gazali, *Mearixh el kuds fi marifeti medarixh en nefs*, (Darul Afak el Xhedeideh, pa vit, Bejrut,) f.17.
- 3 Sepse vetë tekstet islame nga Kurani dhe hadithet profetike, janë të shumta në elaborimin e disa aspekteve rreth shpirtit, qoftë si nefs apo rruh.
- 4 Shprehja psikologji rrjedh nga gjuha greke që do të thotë: “shkenca rreth shpirtit”.
- 5 E gjithë kjo strukturë e definimit të këtyre botëve dhe dallimet në mes tyre, janë huazim i përpiktë nga filozofia greke.
- 6 Me “Katër elementet” në filozofi është për qëllim dheu, ajri, uji dhe zjarri. Nga komponimi i tyre formohet shtresa e ekzistencës e gjendur nën orbitën hënore.
- 7 Gazali, *Mearixhu nefs*, f. 17.
- 8 Po aty.
- 9 Shih: Adudedin el Ixhij, *Kitabul Mevakif*, vëll. 2, f.474. Sadudin Teftazani, *Sherhul mekasid*, vëll. 2, f. 474. Lekvani, *Umdetul Murid sherh xhehereti tevhid*, vëll. 3, f. 1322. etj.
- 10 Shih: Ebu Nasr el Farabij, *Resail El farabi*, f.135. Ibën Sina, *El Ud-huvijetu fil mead*, f.143. Jakub El Kindi, *Resail felsefije lil Kindi vel farabi ve Ibën Baxheh ve Ibn Arabij*, f.11.
- 11 El Kindi, *Resail El Kindi*, f.273.
- 12 Shih: Muhamed Nuvejhi, *El Xhenetu ve Naru*, (El Mexheletu el Urdunije fi Dirasat el Islamijeh, nr.3, vëll. 11, Jordan 2015,) f.144.

Ateizmi, kauzë apo mohim

Phd. Adnan Shala

Në jetë, shpeshherë detyrohemi t'i bindim të tjerët për gjërat që ata nuk i besojnë dhe gjithmonë këto përpjekje hasin në rezistencë. Kur mosbesimi i tyre ka të bëjë me vetë Zotin, rezistenca bëhet edhe më e ashpër. Gjatë gjithë historisë kishte njerëz të cilët e mohonin ekzistencën e Zotit në një mënyrë apo tjetër. Mirëpo mohimi i Zotit në mënyrë kategorike duke pretenduar në një kauzë përtej mohimit u paraqit relativisht vonë. Ateizmi si koncept u paraqit në modernitet. Për ta kuptuar se çfarë paraqet ky koncept dhe cilat janë kauzat apo pretendimet e tij, së pari duhet ta kuptojmë sfondin teorik të konceptit.

Kuptimi leksikor i fjalës ateizëm, sipas fjalorit të gjuhës shqipe është “mohimi i qenies së çfarëdo perëndie; mosnjohje e çdo besimi fetar.”¹ Kurse sipas fjalorit të oksfordit është

“Asgjë nuk mund t'i bindë ata që nuk duan të besojnë.” Anonim

“fakti i të mos besuarit në asnjë zot ose perëndi, ose besimi se nuk ekziston asnjë zot ose perëndi”²

Përcaktimi, përkufizimi apo edhe kuptimi i ateizmit do të jetë i mundur duke e kuptuar teizmin. Sipas shumë studiuesve, ateizmi është një gjendje opozitare e teizmit dhe varet kryesisht nga ai. Në fakt, nuk duket e mundur që ateizmi të shfaqet i pavarur nga teizmi dhe të gjejë materiale për vete, përveç se disa çështjeve jo qendrore të cilat do të trajtohen në vazhdim.

GJENEZA E ATEIZMIT

Gjatë historisë, janë shfaqur qasje të ndryshme dhe janë paraqitur pikëpamje të ndryshme për përkufizimin e ateizmit. Arsyeja për këtë është se teizmi dhe ateizmi janë paraqitur në forma të ndryshme. Përdorimi i



termi ateizëm në mënyrë të njëanshme, në njërën anë, dhe përkufizimi i gjerë i teizmit, në anën tjetër, ka rritur vështirësitë në përkufizimin e ateizmit.

Termi ateizëm, është parashtesa “a” në fillim të fjalës angleze “theism”, e cila rrjedh nga Theos në greqisht, që do të thotë Zot. Parashtesa “a” e vendosur në fillim të fjalës teizëm, siç shihet në shembujt “amoral, atipik, asimetrik”, ndryshon negativisht kuptimin e termit para se cilit është vendosur. Nëse e kuptojmë teizmin si besim në Zot, ose me fjalë të tjera, besim në ekzistencën e Zotit, atëherë do të jetë e mundur për ne që ta shprehim ateizmin si “të mos kesh besim në Zot”.³

Mospasja e besimit i cili mund të cilësohet si besim fetar apo shpirtëror, mospranimi i ekzistencës së një realiteti të mbinatyrshëm, dhe koncepti i mosbesimit përdoret shpesh si emër i përgjithshëm i qasjeve ateiste. Subjekt i këtij mosbesimi është vetë Zoti, i cili në këtë kontekst mund të cilësohet si Zoti i feve qiellore. Teizmi përbën thelbin e besimit në Zotin e feve hyjnore. Në këto fe, besohet se Zoti është “një qenie që është e përjetshme dhe e aftë për të bërë gjithçka, di gjithçka, krijon, organizon dhe mbron universin, e do të gjithmonë të mirën dhe është i lirë në veprimet e tij. Prandaj, të pretendosh ekzistencën e një Zoti me këto cilësi është në njëfarë kuptimi teizëm.

Teizmi pra në përgjithësi i referohet konceptit të një Zoti të vërtetë që krijon gjithçka, di gjithçka, është i gjithëfuqishëm. Ateizmi, në përkufizimin e tij më të shkurtër, është mungesa e besimit në Zot (theos). Për disa, ateizmi nuk është gjë tjetër veçse refuzimi i pretendimeve të teizmit. Edhe pse ky përkufizim duket mjaft i thjeshtë, paqartësia e konceptit fillon pikërisht këtu. Sot, dihet se në fe të ndryshme ekzistojnë koncepte të ndryshme për Zotin. Përveç teizmit, ekzistojnë kuptime të ndryshme për Zotin si deizmi, panteizmi, pananteizmi dhe politeizmi. Në këtë rast, nëse ateizmi është mohimi i teizmit, domethënë refuzimi i një ideje konkrete të Zotit, atëherë të gjitha besimet që nuk kanë idenë teiste të Zotit janë besime ateiste. Me fjalë të tjera, kuptimet e ndryshme të Zotit si panteizmi, politeizmi, pananteizmi do të jenë një kuptim ateist.⁴

Prandaj, ndarja konceptuale midis teizmit dhe ateizmit duhet të jetë e qartë: teizmi është një mohim i ateizmit, ateizmi është një mohim i teizmit dhe ato janë të kundërta ontologjike të njëra-tjetrës. Megjithatë, nëse Zoti ekziston dhe nëse ne mund ta dimë nëse Zoti ekziston, janë dy pyetje të ndryshme. Nëse Zoti ekziston është një çështje ontologjike. Njohja e ekzistencës së Zotit është një çështje epistemologjike.⁵

Teizmi në përgjithësi i referohet konceptit të një Zoti të vërtetë që krijon gjithçka, di gjithçka, është i gjithëfuqishëm.

Është e rëndësishme të theksohet se një pretendim ontologjik nuk mund të konsiderohet si një pohim i shëndoshë në mungesë të një rruge të qartë epistemologjike, përndryshe do të konsiderohej një pozicion i pajustificueshëm apo i pa argumentueshëm. Nëse dikush beson se pretendimi “Zoti ekziston” është i vërtetë, atëherë duhet të besojë njëkohësisht se “Zoti nuk ekziston” është jo i vërtetë. Të besosh të dyja si të vërteta ose jo të vërteta në të njëjtën kohë është kontradiktore.⁶ Për këtë arsye bëhet një ndarje ndërmjet ateizmit dhe agnosticizmit. Mirëpo ky dallim do të trajtohet me vonë.

Gjatë përkufizimit të ateizmit vërejmë se disa thonë se ateizmi realisht nuk është mohim i teizmit, mirëpo te ateistet mungon koncepti për Zotin. Sipas atyre që mbrojnë ateizmin, një ateist nuk duhet ta shohë veten si një person që mbron ekzistencën e Zotit. Sepse ateisti gjithsesi nuk e ka idenë apo konceptin e Zotit.

Prandaj, ai person nuk mund të jetë në gjendje të mohojë diçka për të cilën nuk ka asnjë ide.⁷ Sipas këtij përkufizimi, një ateist nuk duhet të thotë “Nuk ka Zot”, sepse për të mohuar ekzistencën e Zotit, do të kuptohet se çfarë është Ai. Megjithatë, askush prej tyre nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë përfundimisht Zotin dhe të marrë informacion të mjaftueshëm për Të. Mohimi i ateistit do të fillojë kur të përcaktohet Zoti, gjë që nuk është e mundur. Sipas këtij përkufizimi, një ateist deklaron se nuk pretendon asgjë. Prandaj, ai nuk e konsideron të nevojshme të sjellë prova për të mbështetur pikëpamjet e tij mbi veten e tij. Sipas tij, kushdo që pretendon ekzistencën e Zotit është teist. Prandaj, teisti



dhe jo ateisti është i detyruar të sjellë prova për të mbështetur pretendimin e tij.

Ateizmi, duhet të përkufizohet në një kuptim më të ngushtë si mohimi i vetëdijshëm i ekzistencës së Zotit. Sipas këtij përkufizimi, nga njëra anë, ateisti nuk beson në ekzistencën e Zotit, nga ana tjetër, ai me vetëdije përpiqet të sigurojë prova për të treguar mungesën e tij, me fjalë të tjera, ai përpiqet të përgënjeshtrojë provat e paraqitura në favor të ekzistencës së Zotit. Në këtë proces, ateisti kritikon pretendimet e bëra nga teisti në favor të ekzistencës së Zotit ose parashtron argumente spekulative si “problemi i së keqes” kundër ekzistencës së Zotit.⁸

KUR DOLI NË SKENË ATEIZMI

Dilema që buron vetvetiu pas ballafaqimit me këto pretendime është se kur doli në skenë ateizmi. Historia e ateizmit mund të datojë në kohët e lashta. Pretendohet se disa nga filozofët e lashtë ishin ateistë. Këta janë filozofë materialistë, të cilët njihen veçanërisht për pikëpamjet e tyre atomike. Empedokliu dhe Demokriti mund të jenë pjesë e këtyre mendimtarëve. Këta mendimtarë argumentuan se nuk ka asgjë tjetër përveç atomeve. Rrënjët e ateizmit shkojnë në periudhat e para të historisë së filozofisë, por kuptimet e ateizmit në periudhat e lashta, mesjetare dhe moderne ishin të ndryshme nga njëra-tjetra. Disa filozofë të lashtë mohuan të kuptuarit e Zotit të asaj periudhe. Megjithatë, këta mendimtarë nuk mund të thuhet se janë ateistë në kuptimin modern. Për shembull, filozofët atomistë pohuan se edhe perënditë përbëhen nga atome. Pra kemi mohim të natyrës dhe jo vetë qenies së Zotit. Ksenofani hodhi poshtë konceptin antropomorfist të Zotit të asaj kohe, por kjo nuk do të thotë se ai ishte ateist në kuptimin më të gjerë. I njohur për pikëpamjet e tij materialiste, Empedokliu beson në riinkarnimin e shpirtit. Demokriti thotë se shpirtat e njerëzve dhe të kafshëve përbëhen nga një lloj atomi i veçantë. Përveç kësaj, këta filozofë atomistë hodhën poshtë determinizmin. Siç shihet, megjithëse këta filozofë janë ateistë në kuptimin e ngushtë, nuk duket e mundur t'i cilësojmë si ateistë në kuptimin e gjerë.⁹ Ateizmi në kohët e lashta ishte krejt i ndryshëm nga ateizmi modern sot.

Ateizmi modern është një mohim i vetëdijshëm i Zotit si qenie krijuese ku për pasojë mohohet edhe vetë akti i besimit në mos ekzistencë të Zotit. Thënë më ndryshe, ateist nuk është ai që beson se Zoti nuk ekziston, por ai që nuk beson se Zoti ekziston.

Ateizmi nuk është një fenomen njëdimensional. Disa ateistë nuk janë të bindur për ekzistencën e Zotit, disa nuk

*Ateizmi,
duhet të
përkufizohet
në një kuptim
më të ngushtë
si mohimi i
vetëdijshëm i
ekzistencës së
Zotit.*

besojnë në ekzistencën e Zotit dhe disa nuk e dinë atë. Ka qëndrime të ndryshme ndaj besimit në Zot midis atyre që e përkufizojnë veten si ateistë. Klasifikimi përgjithësisht i pranuar i ateizmit është të ndajë ateizmin në dy dimensione kryesore, ateizmin praktik dhe teorik. Më vonë, ateizmi teorik ndahet në dysh si ateizëm pozitiv dhe negativ, dhe ateizmi praktik ndahet në ateizëm pasiv dhe aktiv.¹⁰

Të gjitha këto klasifikime tentojnë që pretendimet e tyre t'i paraqesin në rrafshin filozofik që t'ju krijojë atyre mundësinë e kundërshtimit të teizmit me argumentet e teizmit. Pra, teizmi përdorë argumentin kozmologjik për argumentimin se zinxhiri shkak-pasojë nuk mund të shkojë në pafundësi, mirëpo duhet të ketë një shkaktar fillestar, e ai është Zoti. Kurse ateizmi të njëjtin argument e përdorë për të thënë se ky zinxhirë nuk ka fillim, për këtë arsye materia është e pa fillim dhe se Zoti nuk ekziston.

Sipas botëkuptimit islam, secili fëmijë lind në natyrshmëri, pra është mysliman. Të njëjtën qasje, ateistët mundohet ta adaptojnë në mendimin ateist, ku sipas tyre çdo fëmijë lind ateist, nga këndvështrimi i atyre që e shohin ateizmin jo si një refuzim aktiv të mendimit teist (botëkuptimin e feve qiellore), por si mungesë besimi në Zot. Sipas kësaj qasjeje njerëzit mësojnë fenë e shoqërisë dhe kulturës në të cilën janë rritur më vonë. Për këtë arsye, shumica dërrmuese e njerëzve ndjekin fenë e prindërve të tyre, kulturën në të cilën ata kanë lindur dhe janë rritur.¹¹ Pra njeriu teorikisht mund të jetë ateist, mirëpo nga mënyra e jetesës është teist.

Pas të gjithave që u thanë deri më tani, mund të themi se ateizmi mund të përkufizohet si një mohim direkt apo indirekt, i pjesshëm apo i plotë i qenies apo cilësive të Zotit të paraqitura në botëkuptimet teiste. - vijon -

1 <https://fjalorthi.com/ateiz%C3%ABm> (parë për herë të fundit më 03/01/2023).

2 <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/atheism> (parë për herë të fundit më 03/01/2023).

3 Topaloğlu, Aydın, *Tanritanmazlıgım Felsefi Boyutları: Teizm ya da Ateizm*, İstanbul, 2001,

4 Malik, Shoaib Ahmed, (Defining Atheism and the Burden of Proof) *Philosophy* 93 (2) 281.

5 Malik, Shoaib Ahmed, 281.

6 Malik, Shoaib Ahmed, 281-2.

7 Topaloğlu, Aydın, 16.

8 Topaloğlu, Aydın, 17.

9 Sevinç, Kenan (Ateizmin Boyutları ve Tipleri) *İslami İlimler Dergisi*, Yıl 12, Cilt 12, Sayı 3, 2017, 108.

10 Sevinç, Kenan, 117.

11 Türk, Aydın. *Ateizmi Anlamak*, (İstanbul, Propaganda Yayınları, 2012) 15.

Një peygamber i përkushtuar ndaj paqes (1)

Flamur Vehapi

RËNDËSIA E SHEMBULLIT PROFETIK

Sipas pikëpamjes islame, çdo profet i Allahut, që i është dërguar njerëzimit, mes të tjerash ka qenë edhe i dërguar për drejtësi, barazi e paqe. Siç pohon Kurani: “...Pastaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin.” (El Bekare, 213).

Duke studiuar jetët e këtyre profetëve dhe duke jetuar sipas mësimeve e shembujve të tyre, njerëzit mund të shohin udhëzime kuptimplote dhe zgjidhje për problemet e tyre. Ndonëse myslimanët nxiten t'i ndjekin mësimet e mbarë profetëve dhe të mësojnë prej tyre, është Profeti Muhamed, ai, të cilit i drejtohen të parit, dhe kjo për dy arsye.

Mësimet e tij, të cilat vendosën një traditë të bazuar në dashurinë e nderimin njerëzor, i mësuar njerëzit që të jenë qytetarë të sinqertë dhe përgjegjës.

Së pari: ai ishte profeti i fundit, të cilit iu dha dërgesa përfundimtare – Kurani, i cili ngërthen dhe plotëson porosinë e të gjithë profetëve të mëparshëm.

Së dyti: fjalët dhe veprat e tij janë regjistruar imtësisht në hadithe, kështu që kemi qasje ndaj Sunetit - shembullit të tij, më tepër se në rastin e profetëve të tjerë. Profeti Muhamed a.s. gjatë jetës së tij ishte dhe mbetet ende dikush me të cilin lehtësisht mund të ndihesh i lidhur, të identifikohesh e ta ndjekësh, sepse ai ishte njeri i zakonshëm, transparent në mënyrën e jetesës dhe sjelljen e tij. Për nga shkalla e rëndësisë, Suneti vjen fill pas fjalës së Zotit, ngase Profeti Muhamed a.s. shihet si trupëzimi i Kuranit.¹

Për myslimanët, Profeti a.s. është gjithçka që një mysliman dëshiron të jetë në jetën e tij, por për ta pranuar Muhamedin si Profet të Zotit - që është pjesë e dëshmisë së besimit - duhet pranuar se Shpallja që ai mori është



prej Zotit. Ndaj, kushdo që pranon Islamin, e ka për detyrë t'i ndjekë të dy: Kuranin e Sunetin. Kurani u kujton myslimanëve: “O besimtarë! Binduni Allahut, binduni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit.” (En Nisa, 59). Dhe disa ajete më pas: “Jo, pasha Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden plotësisht.” (En Nisa, 65).

Meqë tash Profeti a.s. nuk është gjallë që të “gjykojë në të gjitha mosmarrëveshjet,” myslimanët mund të vazhdojnë ta kërkojnë këshillën dhe gjykimin e tij nëpërmjet Sunetit. Kësodore, të mësuarit mbi konceptin e zgjidhjes së konflikteve pa e qëmtuar personalitetin, karakterin, rrëfimin dhe rrugën e Profetit Muhamed a.s., do të ishte i pakuptimtë.

Edhe vetë Profeti a.s. besonte në edukimin me anë të shembullit. Mësimet e tij, të cilat vendosën një traditë të bazuar në dashurinë e nderimin njerëzor, i mësuan njerëzit që të jenë qytetarë të sinqertë dhe përgjegjës. Kjo është një ndër arsye të kryesore pse njerëz të të gjitha shtresave e pranuan gjerësisht Islamin gjatë kohës së Profetit. Ata u mahnitën nga sjelljet e tij, sidomos nga qasja ndaj njerëzve, mikut e armikut, siç do të shohim në këtë kapitull. “Për atë, mejdani ishte mjete i fundit për ta mbrojtur një çështje të drejtë. Por, kur u detyrua të luftonte për të drejtat njerëzore, ai nuk u lëkund.”²

Kur lexojmë për përfshirjen e Profetit në veprimet luftarake, disa kritikë të krishterë mes të tjerash theksojnë që Isai (Jezui) a.s. nuk do të kishte bërë ose mësuar kurrë gjëra të tilla. Fillimisht, ata e shpërfillin krejtësisht “frymën tepër luftarake dhe dhunën e haptë në disa pjesë të Dhiatës së Vjetër - një shpallje e përqaftuar me pasion në tërësinë e saj nga Jezui. Për më tepër, shumë nga këta kritikë “i fshijnë disa nga pohimet në dukje të papërputhshme të Jezuit, si alegorike dhe metaforike.”³ Dhe së dyti, pika të cilën kritikët e humbasin tërësisht nga sytë është mjedisi jetësor i këtyre dy burrave. Siç do të shkruante profesor Joel Hayward: “Ata u japin pak rëndësi dallimeve të qarta në përvoja dhe përgjegjësi ndërmjet Muhamedit e Jezuit. Jezui ishte udhëheqës shpirtëror i një grupi të vogël ithtarësh në kohë zaptimi, paqeje relative dhe sigurie vetjake anekënd vendit. Ai vuajti vdekjen, sipas shkrimeve krishtere, por “mbytja” e tij nga pushteti i Romës erdhi pas një shpërthimi të shkurtër të zemërimit shtetëror, që në të vërtetë pasoi disa vite në të cilat ai arriti të predikonte anëmbanë, pa kundërshtime të ashpra e pa dhunë të njohur. Përkundrazi, Profeti Muhamed (në shumë mënyra si Moisiu ose Joshua) e shihte veten jo vetëm si udhëheqës shpirtëror, por edhe si prijës politik e ligjvënës i një shoqërie masive, e cila donte të ishte e moderuar, e drejtë dhe gjithëpërfshirëse, por vuajti persekutim të organizuar të

ashpër e luftërat nga entitete të tjera politike, që ia kishin mësyre rrënimit shoqëror të saj. Përgjegjësitë e tij (përfshirë ushqimin, edukimin, qeverisjen e mbrojtjen fizike të dhjetëra mijëra fëmijëve, burrave dhe grave) ishin shumë të ndryshme.⁴

Duke lënë mënjanë çdo parakonceptim, është e dukshme se puna e suksesshme e Profetit Muhamed a.s. dhe porosia gjithë-ndikuese e tij ishin të qarta në mënyrën se si ai arriti ta shndërronte një popull të prapambetur e luftëdashës në një popull të qytetëruar, që më pas drejtoi një pjesë të madhe të globit, nga Spanja deri në Kinë për gati një mijë vjet. Siç kanë theksuar shkrimtarë të ndryshëm, Profeti a.s. dhe ithtarët e tij krijuan një mënyrë jetese më të drejtë e më të barabartë se çka do që arabët dhe rrethina për anë kishin parë ndonjëherë.⁵ Kemi shembuj të bollshëm që mund të mësohen nga sjellja e Profetit, i cili ka qenë politikisht i drejtë dhe me vlera të larta morale e etike.⁶

PROFETI MUHAMED A.S. PARA PROFETËSISË

Pa dyshim, karakteri i Muhamedit a.s., edhe para Islamit madje, ka qenë i rrallë në krejt Arabinë. Duket se Allahu e krijoi një karakter të mrekullueshëm dhe po e mbante atë në një gjendje të kulluar, që më vonë të mund ta mbante detyrën hyjnore të profetësisë.⁷ Teksa po rritej, rioshi Muhamed a.s. askurrë nuk u përul para idhujve paganë që ishin tejobanë në Mekë, dhe i shpërfillte sjelljet prapanike të njerëzve të paditur atëbotë. Ai tashmë ishte bërë ‘el emîn - besniku’, ndër paganët mekasë, për shkak të karakterit të tij rreptësisht të sinqertë.

Ai ishte njeri i dhembshur, i cili shqetësohej thellësisht për njerëzit e tij të rrënuar. Ai mbahet mend si njeri me dashuri të madhe për skamnorët dhe jetimët e vendit, për të dobëtit, robërit, dhe për lëneshat e pa ndihmuara.⁸ Ishte edhe mjaft largpamës. Ai e dinte fare mirë se, që një shoqëri të kishte mirëqenie, duhet të ishte e drejtë dhe të kujdesej për nevojat e gjindjes, sidomos të varfërve, përndryshe uria e pakënaqësia

Ai ishte njeri i dhembshur, i cili shqetësohej thellësisht për njerëzit e tij të rrënuar. Ai mbahet mend si njeri me dashuri të madhe për skamnorët dhe jetimët e vendit, për të dobëtit, robërit, dhe për lëneshat e pa ndihmuara.

mund ta shpije shoqërinë në sfida e përkeqësime më të mëdha. Ndaj, edhe para profetësisë së tij, Muhamedi a.s. e ngarkoi veten për t'i ndihmuar fatligët, dhe kushdo që e njihnte shfaqte aq përndërimit sa që iu dha emërimi "Mbrotjtësi i jetimëve dhe grave në moshë". Më pas, kur ai u martua me një grua tregtare - me të cilën punonte me vite - kaluan pjesën dërrmuese të jetës duke ndihmuar nevojtarët.

Përderisa merrej me mënyrën se si mekasit udhëhiqnin punët e tyre, posaçërisht ato tregtare, Muhamedi riosh, iu bashkua pleqve dhe krerëve të qytetit për të themeluar aleancën Hilf el-Fudul, e njohur si "Lidhja e të virtytshmëve". Kjo lidhje u bë pas një ngjarjeje që kishte ndodhur në Mekë, kur një shitës jemenas kishte bërë thirrje te krerët e fisit Kurejsh, se një mekas i shquar nuk ia kishte paguar plotësisht mallrat që kishte marrë. Si përfundim, në këtë kuvendim, anëtarët u zotuan që të merrnin masa e të respektonin parimet e drejtësisë, në mënyrë që të parandalonin mospajtimet e ardhshme dhe të ndërtonin marrëdhënie të ndershme ndër njerëzore.⁹ Roli i Muhamedit a.s. ka qenë jetik në këtë lidhje, dhe parimet që u lantuan aty përputhen tërësisht me parimet e etikës islame.

Lidhur me karakterin e tij paqësor qysh në rini dhe ballafaqimin me konflikte dhe zgjidhjen e tyre, rrëfimet historike na e përshkruajnë Muhamedin a.s. si kaheër i besueshëm nga populli për ndërmjetësim në mospajtime në vendin e vet, Mekën. Kjo nuk ka qenë aspak e lehtë të zbatohet atëbotë në shekullin VII, në Arabinë fisnore. Vijon një nga shembujt e shumtë se si Muhamedi riosh i ka trajtuar situatat tejet sfiduese dhe të ndjeshme të përplasjeve, teksa përgatitej nga Krijuesi që të bëhej i dërguari i Tij i fundit.

Kur Qabeja apo Shtëpia e Shenjtë e Islamit në Arabinë Saudite u dëmtua nga vërshimet, fise të ndryshme u përpoqën ta rindërtonin. Përgjatë rinovimit, Guri i Zi që është pjesë e faltore, u hoq. Sidoqoftë, kur erdhi koha që të kthehej në faltore, fiset nuk arrinin të ujdisheshin se kush prej tyre do ta kishte nderin për ta vënë. Krerët e fiseve të cilët kishin punuar fort për rindërtimin, tashmë ishin tërësisht të ndarë duke formuar grupe të veçuara dhe duke qenë buzë lufte. Teksa argumentet vazhdonin, prijësi më i urtë dhe i moshuar këshilloi që të prisnin deri në ag dhe vendimi t'i lihej njeriut të parë që do të hynte në shenjtërore. Ai njeri qëllon të ishte rioshi Muhamed. Me t'u marrë vesh se që ai, të gjithë ndien lehtësim se çështja tashmë ishte në duart e "të besueshmit".¹⁰

Duke parë tendosjet mes grupeve, Muhamedi a.s., pranoi sfidën për ndërmjetësim, ndonëse edhe gabimi më i vogël do ta shndërronte Mekën në një vend gjakderdhjeje. Pa shenja shqetësimi, Muhamedi a.s., kërkoi nga prijësit që t'i sillnin një pelerinë dhe në qendër ta vendosnin Gurin e Zi. Pastaj, kërkoi nga çdo prijës që ta mbanin pelerinën nga secili skaj e ta bartnin Gurin e Zi deri te skuta ku kishte qenë gjithnjë. Atëherë, Muhamedi a.s. vetë e vuri gurin në vend, duke i lënë të kënaqur të gjitha fiset e përfshira në mosmarrëveshje. Kështu, ai e shpëtoi gjendjen nga dalja jashtë kontrolli, duke



e vendosur gurin me duart e veta pa as kundërshtimin më të vogël nga dikush prej grupeve.¹¹ Kjo flet për respektin e njerëzve për Muhamedin a.s. dhe aftësinë e tij për t'i trajtuar të gjitha grupet njësoj dhe drejtësisht.

Pas kësaj ngjarjeje, prijësve të fiseve mekase iu bë e qartë se rioshi Muhamed ishte shpëtuesi, dhe kësodore ata vazhduan me punët e përditshme si zakonisht. Por, për Muhamedin a.s., kjo nuk kishte ndonjë peshë, sepse një ngjarje e tillë ishte ndër qindrat ndërkëmbje që ai gjykonte se kërkonin vëmendje. Për atë, kjo zgjidhje mosmarrëveshjeje ishte thjesht një trajtim i përkohshëm i sëmundjeve të rrethit të tij, të cilat mund të rishfaqeshin nga çasti në çast duke shpërthyer në dhunë e gjakderdhje, siç ishte e zakonshme në Arabinë para-islamike. Ndaj, ai kreptohej e pikëllohej shumë për mjedisin dhe shpesh shkante në shpellën Hira në malet e Mekës për të përsiatuar, duke qëndruar larg nga trazirat e rrungajat e qytetit. Dhe një natë, teksa ishte në shpellën Hira, ku engjëlli Xhibril ia recitoi atij ajetet e para të Kuranit: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte." (El Alak, 1-5). Atë natë ai u bë profet, i dërguari i fundit i Allahut. Muhamedi a.s. ishte katër dhjetë vjeçar.

VITET E PROFETËSISË NË MEKË

Sakaq, pas pranimit të shpalljes, Profeti a.s. nisi ta predikonte Islamit privatisht, kurse më pas haptas. Ai dhe ithtarët e tij u ballafaquan me dhunë dhe përndjekje. Po të njëjtit njerëz, që paraprakisht e kishin nderuar shumë dhe quajtur "besniku", tani i drejtoheshin me emra përbuzës e sulme fizike. Kjo fe e re që Muhamedi a.s. po e predikonte, kërcënonte privilegjet ekonomike dhe shoqërore që kurejshët i gëzonin, sepse përfaqonte koncepte si barazi, përlujtje dhe falje. Megjithatë, sipas Kuranit, një mohim i tillë ndaj Profetit Muhamed nuk ishte aq e veçantë, duke pasur parasysh se profetët e mëhershëm si Isa (Jezui), Musa (Moisiu), Ibrahim

(Abraham), Nuhu (Noe) e të tjerë, u mohuan dhe keqtrajtuat ashpërsisht. Dhe, po si profetët tjerë, edhe Muhamedi a.s. ishte i durueshëm dhe ngulmues në misionin e tij. Aq i durueshëm qe ai, sa që për hir të paqes dhe njanimit të përlajtjeve, duroi të gjitha vështirësitë e veta dhe të ithtarëve të tij që ia bënë mekasit. Ai e kishte kuptuar se durimi qe thelbi kryesor për arritje. Në të vërtetë, durimi ngjau të jetë çelësi i arritjes afatgjatë për ndryshimin e mjedisit të tij zemërgurë, të pacipë dhe të ligë.

Profeti dhe grupi i tij i vogël me myslimanë të rinj, duruan fyerjet dhe përqeshjet në fillim, të cilat pastaj kaluan në keqtrajtme fizike; teksa faleshin, mekasit u hidhnin myslimanëve pjesë të shtazëve të ngordhura ose u bënë ndërkëmbje teksa ata ecnin në qytet. Në fund, kur nuk po e përmbanin më tërbimin, mekasit filluan haptas t'i rrahin e fshikullojnë, djegin e mundojnë myslimanët e pambrojtur, në çfarëdo mënyrë që mund të përfytyronin dhe i braktisnin në agoni. Mekasit e dinin që nuk mund ta mbysnin Profetin a.s., sepse ai ishte nën mbrojtjen e fisit të tij, sidomos ungjit të tij, Ebu Talibit. Kështu, ata sajuan shestim tjetër. Ata nisën një të moshuar mekas për te Profeti a.s. për t'i ofruar pasuri, privilegj dhe prijësi të Mekës, veç po të hiqte dorë nga misioni i tij. Në kthim, Profeti Muhamed a.s., tha: "Mixhë, sikur të ma vendosnin Diellin në dorën e djathtë dhe Hënën në të majtën, nuk e pranoj këtë derisa Allahu të bëjë që e vërteta të ngadhënjëjë, përndryshe do vdes duke u rrekur."¹²

Shpalljet e para të Profetit u përqendruan kryesisht në Njëshmërinë e Zotit dhe parimet themelore të besimit. Lufta - madje edhe për vetëmbrojtje - ende nuk i ishte urdhëruar Profetit dhe shoqërisë së re myslimane. Ndaj, myslimanët përballeshin me dy zgjedhje të vështira: të duronin keqtrajtimin e paganëve mekasë ose të braktisnin vendlindjen - Mekën. Duke parë vështirësitë që myslimanët e pambrojtur po kalonin - urinë, mundimin, vrasjen - Profeti a.s., për herë të parë urdhëroi pesëmbëdhjetë prej tyre, jo të luftonin për vetëmbrojtje, por të udhëtonin shtehtas për në Abisini, që ishte toka e mbretit të njohur të krishterë, Nexhashiut. Ndërsa vetë Profeti qëndroi në Mekë me të tjerët, duke vazhduar t'u mësonte besimin e ri njerëzve.

Mirëpo, për myslimanët që ngelën në Mekë gjërat filluan të përkeqësoheshin. Kurejshët ishin të tërbuar që Muhamedi a.s., e kishte refuzuar ofrimin e pasurisë dhe prijësisë dhe që njerëzit po ktheheshin në Islam pareshtur, pavarësisht trajtimit që u bëhej. Kështu, ata ranë në ujd kundër Profetit a.s. dhe fisit të tij (përfshirë myslimanët e jomyslimanët) dhe të gjithë myslimanëve të tjerë. Atyre iu bë një bojkot ekonomik dhe social, ku për tre vite Kurejshët as nuk bënë shitblerje, as nuk u shoqëruan e as nuk u martuan me ta. Profeti a.s., fisi i tij dhe myslimanët ishin të detyruar të strehoheshin në male, ku bënë jetë të rëndë dhe në privim të ashpër. Thuhet që, si pasojë e kësaj vështirësie, gruaja e Profetit, Hatixhja, dhe ungji i dashur i tij, Ebu Talibi vdiqën menjëherë pas përfundimit të bojkotit. Me vdekjen e Ebu Talibit, Kurejshët

u bënë më të egër në sulmet e tyre ndaj Profetit a.s., kështu që ai vizitoi qytetin e Taiftit me shpresën për të fituar përkrahës.

Njerëzit atje jo vetëm që shkakuan ta pranonin atë dhe mesazhin e tij, por e hodhën jashtë qytetit dhe i lanë që rrugaçët dhe fëmijët ta gjuanin me gurë. Kur Profeti a.s. i shpëtoi turmës, thuhet se sandalet e tij ishin mbushur me gjak nga plagët që mori, por kur njëri nga engjëjt ofroi ta shkatërronte qytetin, Profeti mohoi, dhe në vend të kësaj u lut për udhëzimin e tyre në Islam.¹³ Edhe përballë keqtrajtimit të ashpër dhe ofrimit të mundësisë për ndëshkim, përgjigjja e Profetit a.s. ishte falja dhe lutja për keqbërësit e tij.

Keqtrajtimi i Profetit a.s. dhe i pasuesve të tij vazhdoi. Për trembëdhjetë vjet, Profeti a.s. luftoi kundër fyerjeve, talljes, keqërrjes, keqtrajtimit fizik dhe sanksioneve ekonomike e shoqërore ndaj popullit të tij. Ai kurrë nuk reagoi ndaj sharjes apo keqdashjes ndaj përndjekësve të tij me të njëjtën mënyrë. Ai kurrë nuk përdori dhunë fizike apo forcë. Ai thjesht e kreu detyrën e tij hyjnore me dinjitet e hir dhe me mjete të jo dhunës (një praktikë sot që zakonisht, nëse jo veçmas, i atribuohet Mahatma Gandit të Indisë).

Ndërkohë, numri i myslimanëve në qytetin e afërt të Jethribit ishte rritur ndjeshëm me përpjekjet e Profetit, dhe myslimanët mekasë po lëviznin ngadalë në Jethrib. Kurejshët mekasë druheshin se, nëse Pejgamberi a.s. mërgonte në Jethrib, myslimanët do të kishin një këmbatisje fuqie, nga e cila do t'i sulmonin ata në Mekë. Ata nuk mund të lejonin që kjo të ndodhte dhe e vetmja zgjidhje ishte vrasja e vetë Profetit a.s. Kurejshët sajuan një mashtrim, me të cilin zgjodhën një burrë nga çdo fis mekas për të vrasur Profetin a.s., me shpatat e tyre njëkohësisht. Në këtë mënyrë, fisi i Profetit nuk do të ishte në gjendje të hakmerrej kundër të gjitha fiseve të tjera në të njëjtën kohë. Pasi mësoi për këtë mashtrim vrasjeje, Profeti a.s. mërgoi në Jethrib (më vonë do të quhej Medine), njerëzit e të cilit më parë ishin zotuar se do ta mbronin dhe mbështesnin atë dhe myslimanët mekasë.

1 Hadith sahih.

2 Afzal Iqbal, *The Prophet's Diplomacy*, 1975, xvi-xvii.

3 Shembull, shih Lluca 22:36, ku Jezusi i nxit dishepujt të shesin rrobat e tyre për të blerë shpata, dhe Mateu 10:34 "Mos mendoni se erdha të sjell paqen në tokë! Unë nuk erdha për të sjellë paqen, por një shpatë". Shih gjithashtu Joshua 6:21; Ligji i Përtërirë 7:1-3 dhe 20:16-17. (Për më shumë mbi temën, shih Hayward, 2012, f. 9).

4 Joel Hayward, *Warfare in the Qur'an*, 2012, f. 10.

5 Mark Weston, *Prophets and Princes*, 2008, f. 13.

6 Ziauddin Sardar, *What Do Muslims Believe?*, 2007, f. 2.

7 Muhamad Ibn Ishaq, *The Life of Muhammad*, 2004, f. 81.

8 Sa'eed Al Qahtani, *A Mercy to the Universe*, 2007, ff. 87-90.

9 Ibn Ishaq, 2004, ff. 57-58.

10 Po aty, ff. 85-86.

11 Iqbal, 1975, f. 3.

12 Tahia Al-Isma'il, *The Life of Muhammad*, 2006, fq. 90.

13 Dhjetëra vite më vonë, banorët e Taiftit u bënë myslimanë.

Përemri lidhor¹ në gjuhën e Kuranit

Shkelzen Hoxha

Gjuha e Kuranit është ndryshe nga çdo gjuhë tjetër. Ajo i drejtohet masës, së pari si strukturë e jashtëzakonshme, e pastaj edhe si një formë që përmbush zemrën, të cilën e ka zbritur Ai që krijoi gjuhën dhe që i di fshehtësitë e saj. Deri vonë, egzgejeza përdorte stilistikën, në mënyrë që të gjente bazë racionale për ta argumentuar mbinatyrshtësinë e Kuranit. Mirëpo, sot, shumë pak myslimanë (vetëm të specializuarit e fushës) mund ta krahasojnë objektivisht ndonjë ajet kuranor me vargje të rimuara, sidomos të rimuara sipas periudhës para islame.

Kështu që, studiuesit e rinj, duhet që këtë kriter ta tejkalojnë duke hulumtuar në thesaret e këtij libri hyjnor, për ta argumentuar origjinën mbinatyrore të tij.

Malik ibën Nebij, thotë se aspekti letrar i Kuranit, i cili në sytë e egzgejetëve tradicionalë ishte objekt kryesor për studim, gjithnjë e më tepër e ka humbur rëndësinë e vet në kohën tonë, sepse më tepër është orientuar në aspektin shkencor se sa në atë letrar.²

Apriori njihet fakti se, në mënyrë që në gjuhën arabe të vendosë mendimin e vet religjioz dhe nocionet monoteiste, Kurani doemos e ka tejkaluar kornizën klasike të letërsisë para islame. Në realitet, ai në literaturën arabe realizoi përmbysje të vërtetë, duke ndërtuar instrumentin teknik të shprehjes së tij. Nga një anë, ai e ka zëvendësuar vargun metrik me prozën ritmike, e nga ana tjetër, ka sjellë mendim të ri, duke vendosur nocione dhe tema të reja në mënyrë që të ndërlihdë kulturën para islamike me rrymën monoteiste. Por, nocionet e kësaj rryme nuk janë përkthyer thjesht në Kuran. Ai këto i ka adaptuar dhe asimiluar në kulturën arabe.

Kurani i drejtohet natyrës së njeriut me të gjitha indikacionet dhe frymëzimet të cilat janë të strukturuar në qenien e tij dhe në ekzistencën rreth tij, ai është mrekulli për njerëzimin.³ Veçoritë e tij janë të shumta, prej tyre do ta përmendi një, që ka të bëjë me aspektin gjuhësor, e cila luan rol të madh në ndërtimin e diskursit të tij me tipare të theksuara siç janë gjithëpërfshirja dhe koherenca.

Gjuha e Kuranit lë gjurmë të pashlyera si nga ana figurative poetike, ashtu edhe nga forma dhe përmbajtja (kuptimi). Kjo edhe është veçantia e tij.

PËREMRI LIDHOR

Shumë kohë para Muhamedit a.s., arabët e kishin përsosur artin e tyre letrar dhe kishin arritur shkëlqim të veçantë në të. Aftësia e tyre për të prodhuar vepra me vlera të mëdha letrare ishte e pakrahasueshme me secilën kulturë dhe vend tjetër. Historia nuk njih popull tjetër tek i cili fjala dhe bukuria e saj të kishte po kaq rëndësi dhe po kaq zhvillim,⁴ siç ishin arabët.


Në këto rrethana ku bukuria e fjalës kishte kaq vlerë “erdhi” Muhamedi a.s. dhe filloi shpallja. Siç dihet, citatet kuranore kanë zbritur për shkaqe dhe rrethana të caktuara, mirëpo kuptimi i tyre mbeti valid edhe për ne sot, dhe do të jetë i tillë edhe për gjeneratat e ardhshme. Ndonëse një pjesë e citateve u janë drejtuar njerëzve apo grupeve të caktuara, mesazhi i tyre i tejkalon personazhet, ndërsa pjesa dërmuese e citateve kuranore janë gjithëpërfshirëse.

Kjo si deklaratë tingëllon mirë, por si mund ta argumentojmë? Këtë më së miri e argumenton fakti i përdorimit të përemrit lidhor në Kuran. Ky përemër (me të gjitha trajtat e tij) në Kuran përmendet 1446 herë, mesatarisht Kurani ka 600 faqe (varion sipas botimit), që i bie se në çdo faqe të tij, ky përemër përmendet 2 ose 3 herë ($1446 \div 600 = 2.41$).

Përmes kësaj qasje, pra duke vënë në qendër trajtimin e dukurisë – problematikës, e jo personazhet dhe çështjet në vetvete, diskursi kuranor ka arritur të jetë mbi kohën dhe individët. Këtë pretendim do të mundohem ta elaboroj shkurtimisht me dy shembuj:

Siç e dimë, ballafaqimin kryesor Pejgamberi a.s. e kishte me fisin Kurejsh. Ata për 23 vjet e përgënjeshtruan, izoluan, përjashtuan, luftuan, lidhën aleanca kundër tij dhe pasuesve të tij. Emri Kurejsh përmendet një herë të vetme në tërë Kuranin, bile edhe atë në kontekst pozitiv. Tërë ajetet e zbritura për ta u janë drejtuar duke përdorur përemrin lidhor si: “ata të cilët mohuan...”, “ata të cilët të nxorën...”, “ata të cilët bënë shirk...”.

Kështu, pas afër 23 vjetësh, kur shumica e kurejshitëve pranuan Islamin, pas çlirimit të Mekës, dhe u rreshtuan në safë me Muhamedin a.s. asnjëherë nuk u ndjen ngushtë nga leximi i ajeteve kuranore, ndonëse shumë prej tyre (ajeteve



në kontekst negativ) ishin zbritur për ta. Kurejshitet asnjëherë nuk ishin në siklet, ngase Kurani fliste për njerëz me cilësi të caktuara (që tanimë ata nuk i kishin) dhe s'kishin pse të ndiheshin ngushtë.

Kjo u realizua në mënyrë të mrekullueshme falë përdorimit të përemrit lidhor që i jep kuptim konceptit që pasqyron ngjarja, problemi, zgjidhja e jo individët.⁵

Ky ishte shembulli i parë, ndërsa në shembullin e dytë, Allahu xh.sh. thotë: *“Cili është më i mirë, ai që themelet e ndërtesës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij, apo ai që themelet e ndërtesës së vet i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës.”* (Et Tevbe, 109).

Në këtë ajet, i Madhi Allah flet për dy xhami, për xhaminë e ndritur të Pejgamberit a.s. dhe për atë që njihet si “mesxhidu dirar” xhamia e sherrit. Kjo e fundit ishte një faltore të cilën e kishin ndërtuar hipokritët me iniciativën e Ebu Amir, i cili ishte edhe i ftuar në solemnitetin e hapjes së saj.

Kjo ndodhi pas disfatës së idhujtarëve në betejën e Hunejn, ku Ebu Amiri iku në Sham dhe ishte i vendosur dhe u betua se do të luftonte kundër Pejgamberit a.s. dhe prej atje porositi bashkëmendimtarët të përgatisin armë e të forcohen, dhe të ndërtojnë një faltore si vend tubimi, ndërsa ai do të shkonte te sunduesi bizantin, ku prej atje do të sillte ushtri për ta luftuar të Dërguarin a.s..

Hipokritët pasi ndërtuan xhaminë, shkuan te Pejgamberi a.s. dhe i thanë atij: “E ndërtuam për të dobëtit, për të sëmurët, për ndonjë natë të vështirë me shi, e kemi dëshirë të vish ti, të falësh në të e të na e bekosh.” Pejgamberi a.s. u vesh, u përgatit të shkojë, mirëpo zbriti Xhibrili a.s. me këtë ajet: *“Cili është më i mirë, ai që themelet e ndërtesës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij, apo ai që themelet e ndërtesës së vet i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?!”*

Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës” (Et Tevbe, 109).

Në sot, pas gjithë këtyre shekujve, në këtë ajet njihemi me dy xhami, e para që ishte ndërtuar për adhurim e bashkim, kurse tjetra për rrënim e përçarje. Allahu nuk i përmendi me emra këto dy xhami, nuk na ngarkoi me detaje, por përmendi veçoritë e tyre. Kështu ky ajet (si shumica e ajeteve) është gjithëpërfshirës dhe valid kuptimisht për çdo xhami, në çdo kohë dhe në çdo cep të botës. Varësisht qëllimit të ndërtimit, ajo ose do të jetë xhami “në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij” ose “në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit”.

Shembuj të tillë në Kuran hasim shumë shpesh (siç u potencua më lartë), shkak i prezencës së përemrit lidhor në këtë masë, madje secila fjalë, ajet, faqe, e sure kuranore, pos vlerës dhe rëndësisë që ka si libër i shenjtë, ka vlerën dhe domethënien artistike dhe strukturore të ndërtimit të tekstit.

Do të doja që në vend të përfundimit të këtij shkrimi modest, ta sjell kritikën që dr. Mustafa Mahmud, i bënë temë që shtjelluam, pra, ai e sheh se stilistika e ndërtimit të Kuranit vazhdon të jetë argument që dëshmon superioritetin e fjalëve të Kuranit karshi çfarëdo fjale tjetër.

Ai thotë: “Kurani nuk është poezi, e as prozë. Ai është i strukturuar me një strukturë e posaçme të fjalëve, të cilat janë të radhitura në një mënyrë që me të e zbulon atë muzikalitetin e brendshëm të tij. Ekziston dallimi i madh ndërmjet muzikës së brendshme dhe asaj të jashtme. Si shembull të marrim vargjet e bukura të poetëve të shquar, ti i dëgjon, mallëngjehesh dhe dridhesh, por kjo muzikë është e jashtme. Këtë e ka përpiluar poeti me rimë të bukur, muzika këtu arrin të dëgjohet nga jashtë, e jo nga brenda, nga bukuria e rimës, nga metrika poetike, e nga përzgjedhja e fjalëve. Por kur e shqipton: *“وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَىٰ ، وَالصُّحَىٰ ، Pasha mëngjesin dhe natën kur qetësohet!”*, ti gjëndesh para një rimimi hyjnor, metrikës poetike dhe rimimi të dyfishtë të pjesëve. Por, edhe përkundër kësaj, muzika gufon prej çdo shkronje. Prej nga? Në ç'mënyrë? Kjo është muzikë e brendshme, është njëra nga fshëhtësitë e strukturës kuranore, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me strukturën letrare. Çdo shprehje, vetë për veten e saj paraqet vepër melodike, prej së cilës shpërthen muzika nga brenda, nga vetë fjalët, ndërmjet fjalëve, pas fjalëve, në mënyrë të habitshme, kështu që fare nuk e di se si mbaroi kjo.”⁶

1 Përemrat lidhorë janë përemrat me të cilët i referohemi një fjale a një fjalie të tërë. Ata zënë vendin e një grupi emëror ose të një përemri dhe shërbejnë për të lidhur dy pjesë të një fjalie të përbërë. P.sh. Në klasë dukeshin nxënësit që lexonin. Përemrat lidhorë në gjuhën shqipe janë: që, i cili, e cila, të cilët etj.

2 Malik ibën Nebij (1996), *Fenomeni Kuranor*, Agora, Mitrovicë, P. 127-131.

3 Sejjid Kutub, *Shenja në rrugë*, (Shkup P, 2002), f 24.

4 Ismail Faruku, *Mrekullia gjuhësore e Kuranit*, (Prishtinë, 2010).

5 Ebu Zejd el Idrisij. *El-Ismu-l mevsul edatun litahlidi-l Kur'an*. Shih online: <https://www.youtube.com/watch?v=kW3BvADuOSE> (parë për herë të fundit më: 12.01.2022).

6 Mustafa Mahmud, *Kurani, përpjekje për të kuptuarit bashkëkohor*, (Mitrovicë, Agora, 1997) f. 6-7.

Etika e mikpritjes në legjislacionin islam

Dr. Ilmije Kuqi

Në Islam, mikpritja e mysafirit dhe nderimi i tij, janë vepra të nderuara dhe të dashura për myslimanin e sinqertë dhe një dëshmi e qartë e fuqisë së besimit të tij, kuptime të cilat janë nxjerrë nga mësimet e Profetit a.s., i cili na nxiti ta nderojmë mysafirin.

Islami është kujdesur t'u sigurojë njerëzve gjithçka që do t'i ndihmonte ata të arrijnë qëllimin për të cilin Zoti i Madhëruar i krijoi, e që është të adhurojnë vetëm Zotin. Për këtë, Islami paraqiti një program të kompletuar që ndihmon në arritjen e këtij qëllimi. Ai ligjësoi ibadete dhe transaksione që ndihmojnë në formimin e njeriut si individ dhe komunitetit si shoqëri, si dhe bëri thirrje për respektimin e moralit të mirë dhe idealeve fisnike.

Sistemi moral që buron nga Islami, konsiderohet si një nga aspektet e rëndësishme për të cilat Islami është kujdesur në forcimin e kësaj ndërtese, andaj ka bërë thirrje për ndershmeri, guxim, bujari dhe vlera të tjera morale. Një ndër këto vlera morale është edhe mikpritja e mysafirit dhe nderimi i tij. Mikpritja konsiderohet një nga këto aspekte të rëndësishme të sistemit moral islam, të cilin ai dëshiroi ta rrënjoste dhe ta thellonte në jetën e myslimanit, për shkak të ndikimit të madh në thellimin e kuptimeve të vëllazërisë, mbjelljen e vlerave në shoqëri, si dhe vendosjen e kuptimeve të dashurisë mes myslimanëve.

Në Islam, mikpritja e mysafirit dhe nderimi i tij, janë vepra të nderuara dhe të dashura për myslimanin e sinqertë dhe një dëshmi e qartë e fuqisë së besimit të tij, kuptime të cilat janë nxjerrë nga mësimet e Profetit a.s., i cili na nxiti ta nderojmë mysafirin. Një ndër këto hadithe, është hadithi, të cilin e transmeton Ebu Hurejra

r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Kush beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit, le ta nderojë mysafirin e tij*.”¹

Nderimi i mysafirit konsiderohet si një nga manifestimet më të larta të bujarisë dhe një nga cilësitë e bukura, me të cilat kanë qenë të stolitur pejgamberët a.s. dhe me të u karakterizuan njerëzit bujarë. Kush shquhej për mikpritje, shquhej edhe për statusin e tij të lartë në mesin e popullit të tij.

Juristët islam kanë përmendur rregulla të mirësjelljes për mikpritjen e mysafirëve që duhen mësuar dhe zbatuar, sepse ato rrjedhin nga Kurani, Suneti dhe zakonet fisnike që u trashëguan brez pas brezi. Prandaj, në vijim do t'i përmendim disa rregulla etike-morale më të rëndësishme të mysafirit dhe të nikoqirit.

ETIKA E MYSAFIRIT

Ndër rregullat e mirësjelljes që duhet të respektojë mysafiri, në mënyrë që të jetë një mysafir i lehtë, janë:²

1. Është mirësjellje që mysafiri të mos vonohet e t'i lë duke e pritur dhe as të mos nxitoj e t'i befasoj, para se të jetë plotësisht i përgatitur. Gjithashtu ai nuk merr askënd me veti, përveç se me lejen e nikoqirit.

2. Ai nuk zë vendin më të mirë për t'u ulur, por duhet të jetë i përulur dhe i thjeshtë. Ai nuk ia ngushton vendin të pranishmëve, por nëse i zoti i shtëpisë i sinjalizon që të ulet në ndonjë vend, ai nuk e kundërshton atë, sepse i zoti i shtëpisë e njuh shtëpinë e tij më mirë se mysafiri. Por,

nëse disa nga të ftuarit i referohen atij të ngrihet nga ai vend, ai ngritët në shenjë respekti.

3. Prej etikës së mysafirit është që mos sugjeroj asgjë, pasi i zoti i shtëpisë mund ta ketë të vështirë ta sjellë atë. Kjo është kështu nëse mysafiri mendon se kjo nuk është e mundur për nikoqirin ose se ai e urren këtë gjë. Mirëpo, nëse ai e di se ai kënaqet dhe gëzohet me sugjerimin e tij dhe kjo është e lehtë për të që ta bëjë, atëherë kjo nuk është e qortuar që t'i sugjerojë.

4. Mysafiri nuk duhet të nënçmojë e as ta përbuzë ushqimin e të zotit të shtëpisë, por çfarëdo që atij i servohet, ha dhe falënderon.

5. Gjithashtu, ai nuk ka pse të pyesë pronarin e ushqimit se ushqimi është i lejuar apo i ndaluar?!

6. Ai nuk e fillon ushqimin, nëse me të është dikush që meriton të paraprijë me këtë, siç është ndonjë i moshuar. Krejt kjo bëhet si shenjë respekti ndaj atyre që janë në moshë.

7. Pavarësisht se sa i uritur të jetë mysafiri, ai gjithmonë duhet të hajë në formën më të mirë, të hajë ngadalë dhe të mos nxitojë. Ai ha njësoj siç ha në shtëpinë e tij, sepse kjo është drejtësi, ose më shumë se që ha në shtëpinë e tij, sepse është preferencë. Ai nuk lë asgjë që e lakmon shkaku se të tjerët e shikojnë, sepse ajo është shtirje, por vazhdon dhe ha si zakonisht dhe nuk e heq zakonin e tij, por ai e mëson

Mysafiri nuk duhet të nënçmojë e as ta përbuzë ushqimin e të zotit të shtëpisë, por çfarëdo që atij i servohet, ha dhe falënderon.

vetveten me sjellje të mira në vetmi, në mënyrë që mos të ketë nevojë të shtiret në bashkësi.

8. Ai kur ha e bënë kafshatën e vogël dhe e përtpë mirë dhe nuk e hapë gojën shumë. Nuk e ngre kafshatën tjetër para përpirjes se kafshatës së parë.

9. Ai nuk i shikon shokët e tij dhe as nuk e shikon ngrënien e tyre, por e ulë shikimin dhe preokupohet me veten e vet. Gjithashtu, nuk duhet të shikojë shumë kah vendi nga i cili del ushqimi, ngase kjo është dëshmi e lakmisë.

10. Ai nuk prekë asgjë nga trupi dhe rrobat, për shkak të mundësisë që kjo të mos i pëlqejë shokëve të tjerë. Nëse kollitet ose teshtin e kthen kokën anash, ose e vë dorën në gojë, sepse mund të dalë diçka nga goja dhe të bjer në ushqim ose në rroba të dikujt tjetër, veprim që urrehet nga të tjerët.

11. Nuk bën diçka që neveritën të tjerët, nuk shkund duart në enë, nuk e ngreh kokën mbi enë kur e futë kafshatën në gojë. Nëse nxjerr diçka nga goja, si bërthamë, kockë etj., e kthen fytyrën anash nga ushqimi dhe e heq me dorën e majtë.

12. Mysafiri mund të ushqejë kotelen, qoftë ajo e të zotit të shtëpisë apo jo, por atij nuk i lejohet ta ushqejë qenin - edhe nëse qeni është i të zotit të shtëpisë. Ai nuk ka të drejtë t'i japë lypësit dhe askujt që vjen për ndonjë nevojë. Gjithashtu, atij





nuk i takon marrja e pjesës së mbetur të ushqimit me veti, përveç nëse pronari i ushqimit jep leje për të.

13. Ai lutet për pronarin e ushqimit që Zoti t'ia shtojë bereqetin, ta mëshirojë dhe ta falë. Ai thotë: *“O Zot, bekoje atë me atë që i ke dhënë, lehtësoja ta bëjë më mirë se kjo, bëjë të kënaqur me atë që i ke dhënë, fale, mëshiroje dhe na bëjë ne dhe atë ndër falënderuesit!”* Mandej, mysafiri kërkon leje prej të zotit të shtëpisë që të largohet dhe nuk largohet veçse me pëlqimin e të zotit të shtëpisë dhe me lejen e tij dhe kujdeset për ruajtjen e ndjenjave të tij gjatë këtij qëndrimi.

ETIKA E NIKOQIRIT

Ndër rregullat e mirësjelljes që nikoqiri duhet t'i respektojë ndaj mysafirit, janë:³

1. Përshpejtimi i sjelljes së ushqimit është një nga nderimet e mysafirit. Kështu që nëse mysafirët vinë dhe një ose dy vonohen nga koha e premtuar, u silltet ushqimi atyre që kanë ardhur, sepse nderimi i të pranishmëve është më parësor. Nga kjo bën përjashtim nëse personi i vonuar është i varfër, ose është prej atyre që i thyhet zemra në rast se nuk pritet, në këtë rast nuk ka asgjë të keqe vonimi i ushqimit.

2. Gjithashtu nga etika është edhe sjellja e ushqimit në sasi të mjaftueshme, sepse nëse silltet më pak se sa mjafton ka mungesë respekti, ndërsa në tepricë ka shtirje, përveç në qoftë se ai jep shumë dhe me këtë ai synon që Zoti t'i sjell bereqet shkaku i bujarisë së tij në ushqimin e tyre.

3. Mikpritësi nuk e lë ngrënien derisa të tjerët të ngopen edhe po që se ai është ngopur, ngase mund të ndodhë që të tjerët të ngushtohen të hanë pas tij. Kështu që ai e zgjat dorën dhe ha pak nga pak, derisa ata të ngopen. Transmeton

Xhafer ibën Muhamedi nga babai i tij, i cili thotë: *“I Dërguari i Allahut kur hante me njerëz, ai ishte i fundit prej tyre në ngrënie.”*⁴

Nëse është prej atyre që hanë pak, ai ndalet në fillim dhe ha nga pak, kështu që kur mysafirët arrijnë ka gjysma e ushqimit, ai ha me ta dhe mbetet i fundit, ashtu siç ka vepruar Pejgamberi a.s. dhe shumë nga sahabët r.a.. Por, nëse ai abstenon për ndonjë arsye, ai të pranishmëve u kërkon falje, në mënyrë që atyre t'u largohet turpi. Transmetohet nga Ibën Umeri r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kur të shtrohet tryeza, askush mos të ngrihet derisa të ngrihet tryeza, as mos ta ngre dorën edhe nëse është ngopur, derisa njerëzit të ngopen dhe le të kërkojë falje,⁵ ngase njeriu e bën shokun e tij të turpërohet e të abstenoj (nga ngrënia), ngase ndoshta ka nevojë për ushqim.”*⁶

4. Është e preferuar që nikoqiri t'i thotë mysafirit: Hani, pa insistuar dhe nuk i thotë me shumë se tri herë. Sa i përket betimit për të ngrënë, siç bëjnë disa, kjo është e ndaluar, sepse kjo është e tepruar.

5. Prej nderimit të plotë të mysafirit është që fytyra e nikoqirit të jetë e buzëqeshur dhe të flet mirë. Në tryezë nuk flet diçka nga e cila neveritet njeriu apo që frikësohet, siç është përmendja e vdekjes, sëmundjes, etj. Nikoqiri i shërben vetë mysafirit dhe me ftesën e tij nuk synon të mburret, por synon ta kryejë një sunet.

6. Mysafirin nuk e ulë me mysafirë të cilët janë të rëndë, sepse mysafiri i rëndi e bënë atë të mos ha lirshëm në sofër me ta.

7. Gjithashtu, ai nuk zemërohet me shërbëtorin e tij para mysafirëve dhe nuk ia ngushton familjes furnizimin shkaku i mysafirit.

8. Ai nuk nxiton në ngritjen e llojeve të ushqimit para se të sigurohet se mysafiri të jetë mjaftuar me to, pra derisa ata të ndalën së ngrëni. Gjithashtu, i zoti i tryezës nuk e lë ngrënien para se të tjerët ta lënë atë, por mbetet i fundit prej tyre që e lë ngrënien.

9. Nëse kanë mbaruar ushqimin dhe kërkojnë leje, ai nuk duhet t'i pengojë, sepse kjo mund të jetë një barrë për ta. Ai del me mysafirin deri në derën e shtëpisë dhe kjo është sunet dhe është nga nderimet e mysafirit.

1 Buhariu në *Sahih*, nr. i hadithit: 6018, v.8, f.11; Muslimi në *Sahih*, nr: 47, v.1, f.68.

2 Sagdi, *En-Netefu fi el-Fetava*, fq.244; Mefatihul el-Xhinan, fq.293-307; El-Hedijetu el-Alajeh, fq.257-260; Ed-Durrer el-Mubaha, fq.47-50.

3 Mefatihul el-Xhinan, fq. 298-300; El-Hedijetu el-Alajeh, fq.257; Ed-Durrer el-Mubaha, fq.47-50.

4 Shuab el-Iman, nr: 5636, 8/161. Ali el-Karij, Mirkatu el-Mefatih, V. 7, f.2740, dhe thotë se hadithi: *“Është mursel (i tejkaluar).”*

5 Le të kërkojë falje dhe le ta tregojë justifikimin e tij nëse ngritët.

6 Ibën Maxheh në *Sunen*, nr: 3295, 2/1096; Shuab el-Iman, nr: 5477, 8/47. El-Busiri, në *Misbahu ez-Zuxhaxhe*, 4/14, dhe thotë: *“Ky sened është i dobët.”*

Fadil Rashiti, imami që ua dha lamtumirën e fundit xhematit për t'u flijuar për atdhe

RRËFIMI I BAJRUSH RASHITIT, BABAIT TË DËSHMORIT FADIL RASHITI

“I thash, shyqyr që paske pshtu bre djali jem, më tha, ah, më ke uru mirë, i thash pse bre djali jem. Tha pishman jam ba pse se kam meritë me u vra deri sot. Për Zotin, qito fjalë mi ka thanë në telefon”, kështu rrëfen bisedën, babai i dëshmorit dhe imamit, Fadil Rashitit për dashurinë dhe vendosmërinë që djali i tij të japë jetën për çlirimin e vendit.

I ulur këmbëkryq në odën e tij tradicionale, Bajrush Rashiti, po qëndron edhe sot i buzëqeshur. Ai, buzëqeshjen nga fytyra e tij nuk e largon për asnjë çast. Madje as kur flet për djalin e tij, Fadil Rashitin, që nuk jeton më në këtë botë. Me admirim të madh flet për djalin e tij të vogël, teksa kujton me saktësi çdo fjalë të djalit dhe imamit kur fliste për çlirimin e vendit.

Thuajse e gjitha jeta e tij dhe çdo gjë që kishte bërë, dëshmojnë dashurinë e tij të madhe që të luftojë për çlirimin e vendit, por edhe të vdes për të. Ai la gjithçka, familjen, xhaminë e mbushur me besimtarë ku ishte imam, studimet në Fakultetin e Studimeve Islame ku ishte absolvent dhe gjithçka tjetër për të dhënë jetën për liri.

Bajrush Rashiti nga Petrova e Shtimes, thotë se vendosmëria dhe trimëria e Fadilit për t'iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ka bërë të fortë atë, por edhe familjarët e tij. Ai thotë se ndjehet krenar që djali i tij dha jetën për çlirimin e vendit, duke u bërë pjesë e luftës dhe se nuk është penduar asnjëherë që ai u bë një nga çlirimtarët e vendit.

“Në xhami shpesh ju ka thanë, o besimtarë ai që s’vdes për atdhe nuk ka për çka tjetër, ky atdhe është shtëpia e vendi jonë. Bile dikush i thojke qysh ti hoxhë e me shku në luftë, ai thoshte që unë në shpi të askujt s’po shkoj, në shpi teme, në tokë tonë s’po na lajnë. Kjo tokë e jona u kanë gjithmonë, s’kemi ku me shku tjetër”



“Kurrë s’jam kanë pishman, vallahi hale s’ka njeri që m’ka pa pikë të lotit tu qit për to edhe kam marrë pjesë në varrim të tina”, thotë Bajrush, babai i imanit dëshmor.

Bajrush, thotë se djali i tij ishte rritur në një frymë ku veç të tjerash kishe ndjekur edhe shoqërinë që kishin shtyrë atë të bëhej pjesë e luftës për çlirim. Ai tregon edhe ngjarjet prej të cilave e kuptonte se djali i tij do të jetë në vijë të parë të frontit për çlirimin e vendit.

“Njëherë më kujtohet, erdh një i afërm me ma ndreq rrymën, ke Fadili këtu, tha Fadil ta kam gjet një nuse për hoxhë, po edhe miqtë janë të mirë. Njëherë s’foli hiq, kur i tha prapë, ja nisi me kesh Fadili, edhe i tha: “këqyre çka po të them, e di që koha ka ardh, po besën po ua dha, viti 1998 pa luftë s’ka me na zanë, e atëherë kush të jetë, le të martohet.” Ata se harroj kurrë, më kujtohet mirë”, përmend ai si rast kur ka qenë i bindur se djali i tij do t’i bashkohej luftës së UÇK-së.

Një gjë të tillë ai e bënte edhe nga pozita e imanit në ligjëratat dhe hytbet e tij para besimtarëve në xhaminë e Petrovës, ku bënte thirrje që të luftohej për liri.

“Në xhami shpesh ju ka thanë, o besimtarë ai që s’vdes për atdhe nuk ka për çka tjetër, ky atdhe është shtëpia e vendi jonë. Bile dikush i thojke qysh ti hoxhë e me shku në luftë, ai thoshte që unë në shpi të askujt s’po shkoj, në shpi teme, në tokë tonë s’po na lajnë. Kjo tokë e jona u kanë gjithmonë, s’kemi ku me shku tjetër”, rrëfen babai i tij.

Bajrush Rashiti, kujton hytben lamtumirës të djalit të tij para se t’i bashkohej radhëve të UÇK-së, ku nga ajo hytbe ai u tregoi besimtarëve se më nuk do të ketë mundësi t’ua falte namazet.

“Në hytben e fundit e ka thanë mirë, tha se në xhami nuk vjen ma. Bile do pleq u preken shumë, se nuk u kanë kallaj në fillim me thanë po shkoj në UÇK, e dimë na krejt. Qatë ditë ju patë thanë se kish kësi zana UÇK jemi me ty, e ai ju tha. ‘Leni këto UÇK jemi me ty, po hajdi me mu, une ju çoj ku është vendi te UÇK-ja’. Prej asaj hytbe veç u kuptu edhe ma nja dy muaj se kam ditë as ku është”, rrëfen babai i tij.

Për dy muaj më radhë, Bajrush nuk e kishte ditur se ku e ka djalin e tij të vogël, përveçse që i është bashkuar UÇK-së, por pa një përshëndetje me familjen. Ai ishte nisur në luftë menjëherë pas hytbes.

Megjithatë, dy muaj më pas, ai thotë se për herë të parë e vizitoi familjen, por kishte qëllim që të kërkonte falje që

“Unë sot ndihna shumë mirë që jam baba i Fadil Rashitit, po nuk kam qejf me më dhanë privilegje apo lavde, për shkak se me dëshirë të vetën është shku, e ka marr kjo tokë.”

kishte shkuar pa lejen e babait. Sipas tij, një gjë të tillë nuk e kishte kërkuar nga frika se nuk do ta lejonte t’i bashkohej UÇK-së.

“Mas dy muaji e kishin ndrru pikën edhe ka ardh ka nejt pak. Hoxha tha nuk jam ardh fort me ju pa, po veç me ju kërku falje se edhe me Kuran thotë që duhet me u konsultu me prind kur të shkojsh në luftë, e nuk të kam pyet se jam frikësu që nuk po më len se mendjen e kam pas me të pyet. Tani i thash, ja udha e mbarë të qoftë, tash je i lirë, bon çka dush se hallallin e ki prej meje”, thotë ai.

Veç të tjerash ai thotë se kushtet për ushtarët e UÇK-së kanë qenë jashtëzakonisht të vështira dhe se janë munduar që t’i ndihmojnë luftëtarët që gjendeshin në malet e Kosovës.

“Qatë kohë ka qenë shumë keq puna e ushqimit se furra skish, kështu që u thamë grave të katunit, gatuni bukë sa të mundeni që mas darkës të vinë t’i marrin ushtarët se atje s’kanë qysh”, shton ai.

Fadili kishte ëndërruar që të fitojë shkallën më të lartë që Krijuesi mund t’i japë një njeriu. Babai i tij rrëfen një bisedë nga pyetjet e shumta të një të afërmi që i kishte bërë Fadilit në cilësinë e imanit.

“Tash s’fundi më ka tregu burri i hallës së Fadilit, shpeshherë kur është kthyer prej Medresesë është ndalë te halla në vizitë edhe e kish pyet ai, çka është ma e vlefshme për atë dynja që mundet njeriu me fitu në këtë dynja. Fadili i kish thanë: “Vallahin me vdek për atdhe, fitimi ma i madh është për mu, sen s’më intereson pasuria as asgjë tjetër”, citon babai të ketë thënë Fadili gjatë kësaj bisede.

Bajrush tregon edhe një bisedë të shkurt telefonike me Fadilin gjatë kohës sa ai ishte pjesë e UÇK-së, ku veç të tjerash tregon dëshirën e Fadilit për të dhënë jetën për çlirimin e vendit.

“Kur u thy ofensiva e Jezercit, pas disa dite, se ka pas bombardime tri apo katër ditë pa ndërprerë, edhe më telefoni me telefon ajror a ku ta di unë. I thash shyqyr që paske pshtu bre djali jem, më tha, ah më ke uru mirë, i thash pse bre djali jem. Tha pishman jam ba pse se kam meritu me u vra deri sot. Për Zotin qit fjalë ma ka thanë në telefon.”

Ai tregon që Fadili ka insistuar në luftë edhe atëherë kur ka qenë gati e pamundur të luftohej për shkak të mungesës së armatimit.

“Kanë tregu masanej që edhe kur ka ardh komanda me u tërhjek prej Jezercit pas bombardimeve të shumta, shokët e



BAJRUSH RASHITI
Babai i Fadilit

Fadilit janë tërënjë, ai ka refuzo. Edhe thojshin që i kemi bërë be, disa herë që të tërënjëket prej atij vendi edhe dikur i kish thanë: “Mos um përbeni, se ik prej Petrove, ik prej Jezercit për çka jemi dal na.” Në ato momente tregojnë që Fadili veç dy bume edhe pesë fishekë i kish pas, se tri ditë pa nal hiç luftimet.”

Ai thotë se tre muaj para se të binte dëshmor kishte parë për herë të fundit djalin e tij. Teksa thotë se me shumë vështirësi dhe peripeci mori pjesë në varrimin e tij.

“Na u kallum këtu krejt edhe u dasht me u shpërngul në Ferizaj, veç ma nuk e kam pa kurrë djalin. Dikun ma shumë se tre muaj, edhe në televizor veç kallëzojshin, po na për to nuk e kemi ditë që ka vdek. Tani të nesërmen veç na kanë tregu që djali ka ra shehid. Kur ka shku e kam prit që ka me ra shehid se lufta është luftë, veç kurrë ma s’um ka shku mendja që me thanë pse u vra i jemi. Dikush duhet me u vra në luftë, egjelja vrahët, ymerlia jeton.”

Ai thotë se për çdo ditë të jetës së tij, ndihet krenar me djalin e tij dhe se asnjëherë nuk është penduar që i dha leje djalit të tij që të japë jetën për çlirimin e vendit.

“Unë sot ndihna shumë mirë që jam baba i Fadil Rashitit, po nuk kam qejf me më dhanë privilegje apo lavde, për shkak se me dëshirë të vetën është shku, e ka marr kjo tokë. Kur e merr pushkën në luftë, nuk e di askush se a shpëton apo jo.”

“Kurrë s’jam kanë pishman, vallahin hale s’ka njeri që m’ka pa pikë të lotit tu qit për to, edhe kam marr pjesë në varrim të tina, unë e di qysh me 100 të zeza kam shku, mirëpo kam shku në varrim të tij”, thotë ai.

KUSH ISHTE FADIL RASHITI

Fadil ef. Rashiti ishte imam në xhaminë e fshatit Petrovë të komunës së Shtimes dhe njëkohësisht absolvent në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Ai lindi më 9 janar 1975 në fshatin Petrovë, ndërsa arsimimin e filloi në shkollën fillore “Bajram Curri” në vendlindje, duke vazhduar më pas shkollimin në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë.

Më pas, Fadil Rashiti, vijoi mësimet në Fakultetin e Studimeve Islame (FSI) në Prishtinë në vitin 1998. Ai ka punuar imam i xhamisë në Petrovë gjatë viteve 1993-1998.

Në mars të vitit 1998, duke parë situatën e rënduar në të gjithë Kosovën, ai vendosi t’i bashkohej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka qenë ushtar aktiv në Krojmir të Lipjanit në Brigadën “Ahmet Kaçiku”. Pas një kohë qëndrimi në pikën e Krojmirit, ai do të kalonte në fshatin Rrancë të komunës së Shtimes, për të formuar një pikë të re të Zonës Operative të Nerodimes. Kontributi i tij në këtë pikë ishte i pakontestueshëm. I veshur me uniformë të UÇK-së, Fadil ef. Rashiti, namazin e xhumasë së parë e fali në shtabin e kësaj pike në Rrancë. Fadili Rashiti ka qenë pjesëmarrës në shumë beteja në grykën e Carralevës.

Forcat serbe, të trishtuara nga veprimet e ushtarëve çlirimtarë në këto anë, sidomos nga fundi i shtatorit 1998, kishin marrë ofensivë për të depërtuar në zonat malore, ku ishin të përqendruara forcat e UÇK-së, veçanërisht në fshatin Jezercë të Ferizajt. Kjo ofensive, Fadilin me shumë shokë, Emrush ef. Sumën, Basri ef. Topallin, Kadri Ademajn etj., do t’i gjente të sistemuar nëpër istikame në kuadër të brigadës “Ahmet Kaçiku”.

Pas kësaj beteje, Fadili me disa shokë, shkuan në Shqipëri për t’u furnizuar me armë. Mirëpo, me datën 14 dhjetor 1998, duke u kthyer me armatim nga Shqipëria, në kufirin artificial Kosovë-Shqipëri, në Gorozhup, Fadili ra shehid, së bashku me komandantin Mujë Krasniqin – Kapuçin dhe me bashkëlufëtaretë të tjerë.

Fadil efendiu është varrosur në Marinë të Skenderajt, ku është ngritur lapidari i përbashkët për të rënë në Gorozhup.

Realizoi: M.Sc. Agron Canolli

E drejta e gruas myslimane përballë ideologjisë së të drejtave të njeriut, feminizmit e islamofobisë (1)

Edlira Durmishaj

Nëse tonet verbale janë lehtësisht të identifikueshme, ato të gjuhës së shkruar duket se kanë më shumë forcë. Unë besoj në forcën dhe magjinë e fjalës. Në forcën dhe magjinë e dialogut dhe komunikimit me të gjitha mjetet dhe instrumentet e tij. Sot, ashtu me pak marifet, dua të përcjell pak nga ajo që e jetësojmë çdo ditë individualisht, dhe në bashkësi. Dua të shkruaj për kufijtë, limitet, liritë e të drejtat.

Në shekullin e arritjeve industriale, diplomacive dhe zhvillimit ekonomik, duket se shqetësimet e njeriut dhe shoqërive tona janë sërish historitë e vjetra të ricikluara nga aktorë të rinj. Në thelb, shqetësimet e njeriut janë bazike, të thjeshta e të kuptueshme. Ato janë nevoja që lidhen ngushtë me mirëqenien ekonomike, sigurinë fizike, paqen dhe jetën. Të gjes tonin e të drejtës apo qoftë edhe të nënvizosh një shqetësim në optikën konvencionale të shoqërisë civile, nuk është fort e thjeshtë.

Së pari duhet të përkthesh problemin personal, në interes publik që më tutje këtë ta servosh si dilemën e tyre, në të kundërt dinamikat me të cilat zhvillohet fasada e mekanizmit, janë aq fanatike sa, çështja jote do të mbetet pa lexuar, pa përkthyer, pa kuptuar e si rrjedhojë e parëndësishme, pa vlerë, e frustruar dhe pa dinjitet, pa kufij konceptual, pa të drejta, e neglizhuar.

Së dyti, duhet të ndash mendjen se, në rrugëtimin tënd drejt aktualizimit të qëllimit final, kryefjala e punës tënde është fakti se mundin tënd do ta gjes në rreshtat e atyre që nesër, do të listohen në anën e duhur të historisë. Praktikisht,

“Me tonin e duhur njeriu mund të thotë gjithçka. Në tonin e gabuar, asgjë. Marifeti është gjetja e tonit.” - George Bernard Shaw

do të thotë se ndoshta në këtë rrugë do të kesh vetëm Zotin e parimet hyjnore e sërish të mos ndalesh.

Të përballësh forcën e mentalitetit, kundër rrymës dhe ta ndryshosh atë kërkon vullnet e pasion për të vërtetën, ashtu si vetëm një besimtar mund ta ketë. Në fakt, gratë besimtare myslimane janë shumë më të predispozuara të përballen me dialogun e publike. Jo për ndonjë arsye të veçantë, por për faktin e zgjedhjes së tyre personale për të shprehur identitetin e tyre fetar.

Fetë përcaktojnë identitetet shoqërore dhe individuale, e në këtë kontekst grua myslimane, dukshëm është një mesazh i

zëshëm e cila me tonin e duhur thotë shumëçka, ashtu pa folur, vetëm me ekzistencë.

Duket sikur mesazhi mbi trupin e tyre, përveçse deklaroi guxim për sistemin e vlerave hyjnore të sendërtuara në praktika të moralit dhe etikës, njëkohësisht deklaroi qëndrim mbi koncepte të rëndësishme të diskursit publik të një sfere konceptuale, por edhe të stilit të jetesës. Në kontekstin e përballjes së ideologjive kulturore, politike, sociale, epistemologjike dhe atyre etike, shpesh ndodhin përplasje konceptuale, të cilat kërkojnë shtrimin e dialogut dhe gjetjen e kanaleve të komunikimit, pse jo dhe ndërtimin e tyre nëse mungojnë.

Në kontekstin e kulturës shqiptare, edhe pse në nivel informal, identiteti fetar i gruas myslimane gjen praninë dhe respekt, ai përballë në mënyrë gati artificiale me propagandë të importuar. E imponuar mediatisht përmes mediumeve televizive dhe politikave globale që paraqiten si vazhdimësi e



agjendave të rrymave që mbajnë flamurin e të drejtave të njeriut me prirje ekstreme islamofobe, feministe dhe ndoshta edhe rryma politike të fuqizuara nga filozofi imperialiste, e supremaci kulturore, të cilat në emër të flamurit të politikës së supremacisë ideologjike ndoshta pa dashur instrumentalizojnë edhe mekanizma si ai i të drejtave të njeriut. Vitin që shkoi, në realitetin e politikës së shtetit të Kosovës, të gjithë ishim dëshmitarë se sa herë u vu në pikëpyetje e drejta e arsimit të vajzave besimtare me shami, ani pse tekstet, instrumentet, që mbrojnë të drejtat universale të njeriut janë të qarta, e zezë mbi të bardhë.

Me keqardhje, asgjë nuk ndryshoi në nivelin formal. Me pretekstin se shteti është laik, duket sikur gjuha e të drejtave të njeriut gjithashtu është laike. Në kuptimin që, të dyja palët që kërkojnë emancipim dhe respektimin e të drejtave universale dhe lirive thelbësore, nuk arrijnë të gjejnë pikën e takimit në një debat publik. Nuk arrijnë të takohen me njeriun. Nuk arrijnë ta mbrojnë njeriun. Por çfarë mbrojnë atëherë? Ngrihet pyetja: *A janë realisht të drejtat e njeriut universale? Mbi çfarë ideologjie janë ndërtuar? A diktojnë këto të drejta gjuhë që zhvesh nga publikja? A ka nevojë religjioni për të drejtat e njeriut? A kanë nevojë të drejtat për religjionin? e të tjera pyetje si këto, natyrshëm më përshkojnë vetëdijen dhe ndërgjegjen prej pale interesi.*

Duke pasur parasysh klimën aktuale, themelimi i ditës botërore për ndërgjegjësimin kundër diskriminimit ndaj mbulesës së gruas myslimane është edhe më e rëndësishme.

Liria fetare është një hap drejt dialogut dhe sa kohë që ka dialog, ka shpresë për përmirësim dhe emancipim.

Duke pasur parasysh klimën aktuale, themelimi i ditës botërore për ndërgjegjësimin kundër diskriminimit ndaj mbulesës së gruas myslimane është edhe më e rëndësishme.

Dita Botërore e Hixhabit është një ngjarje që ne duhet të jemi krenarë që ta promovojmë, mbi të gjitha për të drejtën e manifestimit të religjionit dhe bashkëjetesës fetare. Kjo ditë nuk është një ditë feste, por notë proteste kundër fanatizmave, diskriminimit dhe stereotipizimeve e paragjyqimit ndaj grave myslimane përmes ndërgjegjësimit, edukimit dhe fuqizimit të tyre.

A KA NEVOJË RELIGJIONI PËR TË DREJTAT?

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të grave në Islam janë të mishëruara në parimet e tij më të vlefshme, sepse Islami njeh të drejtat fetare, sociale, ekonomike, ligjore dhe politike të grave.

A KA NË FAKT NJË LIDHJE LOGJIKE MIDIS FESË DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT?

Por nëse të drejtat e njeriut konsiderohen më të rëndësishme se dekretet fetare, ku është vendi i besimit fetar në jetën publike? Feja shprehet si në praktikë ashtu edhe në mendim. Është një gjë të thuhet se bindjet tona fetare nuk duhet të



ndikojnë negativisht në kuadrin politik apo në të mirën më të madhe të shoqërisë. Është krejt tjetër të argumentohet se normat universale të të drejtave të njeriut nuk duhet t'i lënë hapësirë ndërgjegjes fetare. Megjithatë, kjo është pikërisht ajo që po ndodh në shumë pjesë të botës, ku komunitetet fetare ndiejnë se zërat e tyre po heshtin ose po hidhen poshtë. A mundet shteti ta mbrojë lirinë fetare, kur ka mënyra të ndryshme të përcaktimit të fesë dhe mënyra të ndryshme të praktikimit të të njëjtit besim? A mundet feja e jetuar në të gjitha manifestimet e saj vërtet të mbrohet gjithmonë me ligj?

CILAT JANË SHEMBUJT E ÇËSHTJEVE ETIKE NË FE?

Çështjet e trajtuara janë identiteti dhe autoriteti fetar; personalja dhe privatja; martesë dhe familja; ndikimet dhe përdorimi i kohës, parave dhe burimeve të tjera personale; cilësia dhe vlera e jetës; pyetje të së drejtës dhe të gabuarës; barazia dhe dallimi; konflikti dhe dhuna dhe çështjet globale.

Çështja këtu është nëse të drejtat e njeriut mund të konsiderohen si të vetë-drejtura dhe të qëndrueshme në kuptimin e një botëkuptimi të konsoliduar në të cilin bazohet *besimi në dinjitetin universal njerëzor*. Në këtë drejtim, mund të bëhet dallimi ndërmjet fesë dhe besimit.

A KA NEVOJË E DREJTAT PËR RELIGJIONIN?

Në fakt, liritë fetare nuk janë thjesht të pajtueshme me të drejtat e njeriut, por me kërkesat themelore të respektimit të lirive dhe të drejtave. *Duke ofruar kushtet për lulëzimin dhe mirëkuptimin njerëzor, religjioni sublimon dhe inkurajon vlerat që të drejtat e njeriut kërkojnë të mbrojnë.*

Termi fe rrjedh nga latinishtja “religio” në kuptimin e një lidhjeje. Ndërsa feja mund të shfaqet si doktrinë, rregulla dhe hierarki, besimi i referohet bindjes autentike dhe angazhimit konkret.

Është dijetari mysliman Abdullahi en Na'im, ai që ka sugjeruar zhvendosjen e debatit mbi “fenë dhe të drejtat e njeriut” nga interpretimet tekstuale të recetave dhe ndalimeve në kuptimin dhe praktikën aktuale të besimit (2004).¹ Në të vërtetë, ratifikimi i traktateve, krijimi i gjykatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut – nuk mjaftojnë. Baza morale për një bindje mbi të cilën mbështetet sjellja e përgjegjshme duhet të ushqehet vazhdimisht mbi bazën e një botëkuptimi të përbashkët nga të interesuarit.

Veçanërisht, për aq sa nocioni i të drejtave të njeriut duhet të mbështetet në individualizëm, është individualizmi “përgjegjës”² ai që ka rëndësi. Me sa duket, kjo nuk është e njëjtë me individualizmin “posedues”. Megjithatë, e para mund të degjenerojë lehtësisht në të dytën.

Janë pikërisht ato kultura në të cilat individualizmi posesiv ka rrënjë të forta – dhe kjo përfshin fshatin global si të tillë

Duke ofruar kushtet për lulëzimin dhe mirëkuptimin njerëzor, religjioni sublimon dhe inkurajon vlerat që të drejtat e njeriut kërkojnë të mbrojnë.

– të cilat përfshijnë vështirësi të mëdha me të drejtat ekonomike dhe sociale, që në fazën e përcaktimit të standardeve.

Ndërsa individualizmi mund të ofrojë një bazë të mjaftueshme morale për respektimin e lirive themelore të secilit, ai është i pamjaftueshëm si bazë për të pranuar nevojat e njerëzve të tjerë si themel për pretendime të justifikuar.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore presupozojnë jo vetëm individë të lirë, por një komunitet që pranon përgjegjësinë për përmbushjen e nevojave themelore të secilit. Për sa i përket realizimit të të drejtave të njeriut, çështja e vërtetë është e një natyre morale kulturore: Si e shohin njerëzit njëri-tjetrin? A e shohin njëri tjetrin si mundësi e mirë për bashkëpunim apo si një kërcënim? Cila është baza e besimit të njerëzimit në lirinë, përgjegjësinë, barazinë dhe vlerën e jetës njerëzore në vetvete? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje nuk mund të jetë universale, pasi jo të gjithë ndajnë të njëjtat bindje themelore, ironikisht.

Pse të drejtat e njeriut kanë nevojë për besim? Teoritë etike u përgjigjen dy pyetjeve kyçe rreth jetës sonë të përbashkët morale: 1. Çfarë duhet të bëj?; dhe 2. Si duhet të jetoj? Pyetja e parë synon të ndihmojë njerëzit të kuptojnë se cilat veprime u kërkohen moralisht. Pyetja e dytë synon të ndihmojë njerëzit të përcaktojnë elementët kryesorë të jetesës së mirë ose të një jete të virtutshme.

Çlirimi i njerëzimit nga mëkati fillestar, fuqizimi i qenieve njerëzore dhe dhënia atyre përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre është thelbi i moralit dhe etikës në Islam: “Çdo shpirt do të mbahet përgjegjës për atë që ka bërë.” (74:38)

Në shumicën e shoqërive perëndimore gjuha politike është ajo e liberalizmit dhe individit është në qendër të botëkuptimit liberal. Liberalizmi pranon dhe lavdëron zgjedhjen individuale, sepse e njeh individin mbi kolektivin. Kjo i ka dhënë shoqërisë një model të ri lirie, së bashku me një rend të ri shoqëror ku feja nuk ka më një rol kaq të lartë.

Nëse gjuha e të drejtave të njeriut duket kulturalisht moderne, gjuha fetare, shpesh duke treguar një botë përtej luftës tokësore për të drejta, duket jo moderne. Besimi fetar

nuk është zvogëluar krahas shfaqjes së shtetit kombëtar, migrimit masiv dhe globalizimit, edhe nëse strukturat dhe hierarkitë tradicionale klerikale janë gërryer gradualisht.

Modestia myslimane konsiderohet të jetë seksualisht jokonformiste nga vëzhguesit francezë, të cilët e dënojnë atë jo vetëm si të ndryshme, por edhe si disi të tepruar, madje edhe perverse.

An-Na'im, A.A. 2004, 'The Best of Times, and the Worst of Times: Human Agency and Human Rights in Islamic Societies', *Muslim World Journal of Human Rights* Vol. 1, no. 1.

CELAM (Episcopal Conference of Latin America), 1993, *Nueva Evangelización, Promoción Humana, Cultura Cristiana*, "Jesucristo Ayer, Hoy y Siempre, IV conferencia General del Episcopado Latinoamericano, Santo Domingo, Republica Dominicana, 12-28 Octubre 1992, Santo Domingo: Ediciones MSC.

De Gaay, Fortman, B. 1995, 'Human Rights, Entitlement Systems and the Problem of Cultural Receptivity', in A. An-Na'im, J.D. Groot, H. Jansen, and H.M. Vroom, *Human Rights and Religious values: an Uneasy Relationship*, Grand Rapids, Eerdmans.

De Gaay Fortman, B., K. Martens & M.A. Mohamed Salih 2010, *Between Text and Context: Hermeneutics, Scriptural Politics and Human Rights*, NY: Palgrave Macmillan.

De Swaan, A. 1988, *In Care of the State: Health Care. Education and Welfare in Europe and the USA in the Modern Era*, Cambridge: Polity Press.

Fukuyama, F. 1992, *The End of History and the Last Man*, London and New York: Penguin Books.

Hoffmann, S. 1995, "Dreams of a Just World", *The New York Review of Books*, 2 November, 54-57.

McCullum, H. 1995, *The Angels Have Left Us: The Rwanda Tragedy and the Churches*. Geneva: WCC Publications.

Lasch, C. 1994, *The Revolt of the Elites and the Betrayal of Democracy*, New York: W.W. Norton.

Leary, V.A. 1990, *The Effect of Western Perspectives on International Human Rights*, in A.A. An-Na'im and F.M. Deng (eds), *Human Rights in Africa: Cross-Cultural Perspectives*, Washington D.C.: The Brookings Institution.

McCullum, H. 1995, *The Angels Have Left Us: The Rwanda Tragedy and the Churches*. Geneva: WCC Publications.

Mirraosavi, A. 2010, *The Quran and Religious Freedom. The Issue of Apostasy*, in B. de Gaay Fortman, K. Martens and M.A. Mohamed Salih, *Between Text and Context: Hermeneutics, Scriptural Politics and Human Rights*, New York: Palgrave Macmillan.

Rawls, J. 1972, *A Theory of Justice*, Oxford: Oxford University Press.

Rawls, J. 1999, *The Law of Peoples. With "The Idea of Public Reason" Revisited*, Cambridge (Mass.): Harvard University Press.

Wronka, J. 1998, *Human Rights and Social Policy in the 21st Century*, Lanham (MD): University Press of America.

The Political Theory of Possessive Individualism (Hobbes to Locke) by C. B. Macpherson/Review by: Leroy Taylor Vol. 14, No. (JUNE, 1965), pp. 240-244 (5 pages Published By: Sir Arthur Lewis Institute of Social and Economic Studies

1 Një studiuësi i njohur ndërkombëtar i Islamit dhe të drejtave të njeriut në perspektivat ndërkulturore, En-Na'im ligjëron lëndë në të drejtën ndërkombëtare, të drejtën krahasuese, të drejtat e njeriut dhe ligjin islam. Interesat e tij kërkimore përfshijnë konstitucionalizimin në vendet islamike dhe afrikane, sekularizmin, Islamin dhe politikën.

2 The Political Theory of Possessive Individualism (Hobbes to Locke) by C. B. Macpherson/Review by: Leroy Taylor Vol. 14, No. 2 (JUNE, 1965), pp. 240-244 (5 pages Published By: Sir Arthur Lewis Institute of Social and Economic Studies

Dashuria

Amër Halid



Po të mos e kishte krijuar dashurinë Allahu xh.sh. te ne, njerëzimi nuk do të kishte ambicie për pasardhës dhe për vazhdimësi të jetës.

Ata që i bëjnë padrejtësi dhe e nëpërkëmbin këtë fjalë të shenjtë, të tillët duan t'ia largojnë pastërtinë dhe dëlirësinë që ka kjo fjalë. Kujdes, mos t'ju ikën dashuria e vërtetë. Jo dashuria e atyre që e kuptojnë dashurinë si kënaqësi, e as e atyre që bëjnë thirrje për të, por që kurrë nuk e shijojnë ëmbëlsinë e saj.

Tema për dashurinë është një nga temat më të rëndësishme, si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Ne do të shkruajmë sinqerisht dhe me fjalë që burojnë nga zemra. Do të shkruajmë haptazi për të vërtetën, për sinqeritetin ndërmjet djemve dhe vajzave, e do të përpiqemi që vërtet t'i hapim zemrat tona. Sigurisht

se unë jam kujdesur që të hyj direkt në temë, ngase disa djem dhe vajza, do të thonë se ne e dimë se çfarë do të shkruhet për këtë temë, andaj edhe refuzojnë mbarimin e leximit të këtij shkrimi. Në fillim, dua ta bëj një pyetje të rëndësishme: A është dashuria instinkt i natyrshëm që e ka krijuar Allahu xh.sh. për njeriun? A mund të jetojë njeriu pa dashuri?

Natyrisht, ju e dini se ne po shkruajmë nga aspekti fetar, dhe do ta imagjinoni se ne do të themi se dashuri është ta duash babanë dhe nënën. E vërtetë! Kjo është një lloj i dashurisë. Në esencë, dashuria është ta duash Allahun xh.sh.. Por, më lejoni që të flas për dashurinë, që përmes saj nënkuptohet dashuria e burrit për gruan. A mund të ndodh që njeriu të mos ketë nevojë për dashuri? Të jetojë pa dashuri

apo pa e dashur atë ndokush? Natyrisht se jo, nuk mund të gjendet ndokush që jeton pa dashuri.

Kjo është natyrshmëri dhe instinkt. Po të mos e kishte krijuar dashurinë Allahu xh.sh. te ne, njerëzimi nuk do të kishte ambicie për pasardhës dhe për vazhdimësi të jetës. Instinkti është një nga arsytet që e bën botën të vazhdojë. Asnjëherë nuk mund të mendojmë për shkatërrimin e instinktit dhe se nuk mund që ne ta zhdukim atë nga jeta jonë, ashtu siç nuk mund ta injorojmë dhe të mos flasim për të. Disa mund të mendojnë se, përderisa ne po flasim nga aspekti fetar, nuk ekziston diçka që quhet dashuri. Kjo është një logjikë e gabuar.

Instinkti ka filluar që nga fillimi i jetës, që nga krijimi i Ademit a.s.. Në hadithin profetik, tregohet se kur Ademi a.s. hyri në Xhenet, u mërzitë, edhe përkundër se ai jetonte në Xhenet, ai ndjeu se diçka po i mungonte. Ai ndjeu nevojën për Havanë. Këto fjalë nuk janë fantazi, mirëpo janë fjalë nga hadithi i Pejgamberit a.s.: “Derisa ai ishte në gjumë, Allahu krijoi nga brinja e tij Havanë, dhe kur u zgjua ai e pa atë afër tij dhe i tha: Kush je ti? Unë jam grua – tha ajo. I tha si e ke emrin: Hava – iu përgjigj. E pyeti se përse je krijuar, ndërsa ajo iu përgjigj: “Që të gjesh prehje, qetësi tek unë”, d.m.th., ajo ishte shenja e qetësisë – rahatisë, e kurrsesi robëreshë apo mall i tij.

Nëse lexoni disa libra qiellor dhe jo qiellor te fetë e tjera, është e habitshme se tek ata, Havaja shihet me syrin e fajësisë – kërkoj falje për këto fjalë që po i shkruaj – por, ajo (gruaja) shihet sikurse nuk është nga lloji njerëzor, d.m.th., një rang më i ulët se burri. Ka nga ata që e konsiderojnë atë shkaktare të mëkatit të Ademit, të tillët mendojnë se ajo ishte shkaktare e zbritjes së Ademit në tokë dhe shkaktare se përse ai hëngri nga pema e ndaluar. Por, në realitet, Kurani nuk i thotë këto fjalë, përkundrazi, ai i vendos që të dy së bashku në një shkallë, në një nivel të përgjegjësisë: “U bëri vesvese atyre dyve shejtani.” (El Araf, 20).



Në ajet nuk thuhet se Iblisi “qeshi” me Havanë, apo se e ka mashtruar dhe kaq. Por ai u soll rreth tyre dhe u bëri lajka – vesvese atyre të dyve së bashku. Përgjegjësia është e përbashkët. Që të dy hëngrën nga pema dhe që të dy pastaj zbritën në tokë. Thuhet se Ademi vazhdoi ta kërkonte Havanë derisa u takuan në kodrën e Arafatit. Ademi ishte ai i cili qe lodhur shumë dhe vazhdoi ta kërkonte Havanë derisa arriti tek ajo.

Në fakt, në librat e mufesirëve (komentuesve të Kuranit), do të gjesh fjalë shumë të bukura. Çështja është të tregojmë nevojën e qetësisë dhe jo hamendësime të cilat i shohin disa.

Kurtubiu përmend se melaqet e pyetën Ademin a.s.: “A e do Havanë?” “Po!” – tha. I thanë Havasë: “A e do Ademin?” “Jo!” – tha ajo, e në zemrën e saj kishte shumë më shumë dashuri se në zemrën e Ademit. Unë këtë po e tregoj dhe po e përmend që të shohim të gjithë se instinkti ka filluar qysh nga krijimi i Ademit dhe Havasë.

Për hadithin që flet se Havaja u krijua nga brinja e Ademit, dijetarët thonë: Përse u krijua nga brinja e tij derisa ai ishte në gjumë e jo i zgjuar? Kjo që Ademi mos ta ndiente dhimbjen e krijimit të Havasë. E kundërta e lindjes së një fëmije, kur gruaja është e zgjuar. Thonë se ndjenjat e Havasë janë më të forta se ndjenjat e Ademit. Ajo nuk gërditet (shqetësohet) nga procesi i lindjes dhe nuk u kushton vëmendje dhimbjeve të saj. Ademi nuk do të mund ta përballonte këtë proces.

Këtu po parashtrojmë ide dhe kuptime që ne të arrijmë të pikëpamja islame për gruan.

Nga këto ide është që Ademi është krijuar nga toka – dheu, e Havaja nga brinja, d.m.th. nga diçka e gjallë. Për këtë, e shohim se kur Ademi veproi në këtë dynja, qoftë si tregtar, prodhues, luftëtar apo bujk, ai u morr dhe punoi me materialin nga është krijuar, pra me elementet e tokës.

Ndërsa, Havaja, punoi, veproi dhe u morr me shpirtin, me njeriun. Ajo edukoi dhe u bë nënë, motër, grua, vajzë, kështu ajo punoi me diçka të gjallë, andaj edhe për këtë u quajt Hava, ngase është krijuar nga jeta. (Hava i thuhet ajrit, frymëmarrjes).

Sigurisht kjo është gruaja dhe se ky është roli i saj. Mes burrit dhe gruas ka raporte shumë të bukura dhe të vlefshme.

Çfarë mendoni sikur të ndiejmë edhe pak gjallëri me rrëfimin e dy të dashurve të mrekullueshëm, zotërinë tonë, Ibrahimin a.s. dhe gruan e tij, Sarën. Ai e donte shumë atë, jetoi me të 80 vjet, e ajo nuk lindi fëmijë, por ai për hir të dashurisë ndaj saj nuk donte të martohej asesi me tjetër grua. Kjo ishte deri në atë nivel, sa që ai nuk e martoi zonjën Haxhere (nënë e Ismailit), deri atëherë kur një gjë të tillë ia kërkoi Sara. Ai u detyrua që të martohej që të ketë pasardhës. A mund që dashuria të arrijë deri në atë nivel, ku për 80 vjet nuk dëshironte t'i lëndonte ndjenjat e gruas së tij. Pasi e martoi Haxheren dhe ajo e lindi Ismailin, Sara pati zili, dhe kjo është në natyrën e gruas. Ajo nuk donte të jetonte më me Haxheren në të njëjtin vend. Ibrahim a.s. u pajtua dhe e mori Haxheren dhe birin e tij, Ismailin, dhe i largoi në një vend të largët, ndoshta vetëm për të kënaqur gruan e tij të dashur. Çfarë mendoni për këto marrëdhënie elegante të klasës së lartë?

Dashuria është e nevojshme dhe e bukur, por... cila është ajo dashuri?

Ta shohim tregimin e zotërisë sonë, Amër ibën Asit, kur erdhi te Pejgamberi a.s.. Muhamedi a.s. po kthehej si fitimtar nga ekspedita që quhej “Dhate Selasil”. Amër ibën Asi donte të kishte hise në zemrën e Pejgamberit a.s., andaj edhe i tha: “Kush është personi më i dashur te ti?” Ai, a.s. tha: “Aisheja”. (Kuptimi i hadithit transmetohet në Sunenin e Tirmidhiut.)

A të ka ndodhur ta pyesësh dikë, se kush është njeriu më i dashur tek ai, e të thotë: gruaja ime. Sfidoj që ta hapim një

revistë dhe të lexojmë për ndonjë nga njerëzit që kanë marrë famë të madhe, që të thonë se njeriu që më së shumti e duan është gruaja. Por, Pejgamberi a.s. e tha këtë me thjeshtësi dhe ia përmendi edhe emrin e saj gjithashtu.

Ta shikojmë dashurinë e Omer ibën Hatabit ndaj gruas së tij. Një shok të Pejgamberit a.s. e mërzipte shumë gruaja e tij. Ajo gjithmonë e pandërprerë e ngrite zërin dhe fliste me zë të lartë pranë tij. Nga bezdisja që kishte, ai shkoi të ankohej tek prijësi i besimtarëve, Omer ibën Hatabi r.a.. Kur u afrua të trokiste në derë, dëgjoi zërin e gruas së Omerit, e cila po fliste me zë më të lartë se Omeri dhe zëri i saj po dëgjohej në rrugë, u kthye i dëshpëruar. Kur deshi të largohej, Omeri r.a. e hapi derën, dhe i tha: “Sikur po doje të vije tek unë.” Ai tha: “Po, erdha të ankohej për ngritjen e zërit nga ana e gruas sime, por e pash që edhe ti qenke në hall sikurse unë.” Omeri r.a. i ktheu një përgjigje elegante, duke i thënë: “Ajo më ka duruar (duron), më lan rrobat e mia, ma shtron shtratin tim, mi edukon fëmijët e mi, e pastron shtëpinë time, e të gjitha këto i bën, e Allahu nuk e ka obliguar me këto. Ajo i bën këto nga vullneti i saj, dhe të gjitha këto i ka përballuar, e si mos ta duroj e ta përballojë unë ngritjen e zërit të saj.” Kjo është dashuria elegante.

T'i shohim metodat që gjenden sot në aktualitetin tonë. Lidhje miqësie, apo bashkëjetesë, siç e quajmë ata lidhjen mes djemve dhe vajzave. Cilat janë pasojat e kësaj lidhje dhe cilat janë problemet që dalin nga kjo? Ta shikojmë efektin e këtyre lidhjeve, pasi që vërtetua se dashuria është bazë dhe se nuk ka ndonjë problem në lidhje me të. Dashuria ka pamje fisnike në fenë tonë. Të rinjtë flasin vetë dhe na rrëfejnë për realitetin e tyre. Djali dhe vajza mund të ndiejnë disa emocione, e pastaj kur e kuptojnë se kanë gabuar, përpriqen t'i përmirësojnë gabimet e tyre, mirëpo, për fat të keq, në formën e gabuar, duke bashkëjetuar.

Unë mendoj se kjo është për shkak se Zoti i Madhëruar i do robërit e Vet. Prandaj, Ai e ka krijuar dashurinë për ta. Por, ajo që dua t'iu them vajzave është se humbjet e tyre në këto marrëdhënie janë shumë të mëdha, e më e thjeshta prej tyre, është ajo që vajza ndien se është poshtëruar dhe konsumuar dhe se më nuk është ajo vajza e përkëdhelur dhe e çmuar në shtëpinë e familjes së saj. Ajo vepër e shëmtuar është gjëja e parë që ajo me partnerin e saj e bën, duke qenë larg familjes, sidomos babait. Atëherë ajo fillon ta gënjejë familjen e saj, fillon të ketë probleme në shtëpi. Ajo fillon ta ndiejë se ajo duhet ta drejtojë botën e saj, e vetme dhe pa mendimin e të tjerëve.

Në fakt, humbjet e vajzës nga ky lloj marrëdhëniesh aventureske, dua t'i përmbledh me disa fjalë të thjeshta. Kur i ndaloi Islami këto lidhje, shtrohet pyetja se a i ndaloi për shkak se ai dëshiron t'i kufizojë njerëzit, apo kjo gjë është në interes të të gjithëve? Mendohet se 95% e këtyre lidhjeve “aventureske” nuk mbarojnë me martesë. Pra, vajzës i thuhet zemra dhe është ajo që humb. Andaj, nëse djali ka dhimbje dhe vuan nga depresionet, atëherë lidhja mbaron. Por, si është gjendja me vajzën? A ka ndonjë gjë në Islam që thotë se kjo marrëdhënie është e ndaluara.



Nuk i lejohet femrës të ketë shok apo mik të dashur, sepse vajza dëmtohet dhe i lëndohet dinjiteti kur lidhja e saj dështon. Arsye tjetër e refuzimit të kësaj miqësie është shkatërrimi i familjeve pas martesës, për të cilën folëm pak më parë. Unë kam shumë vajza të afërta, për të cilat di se i kanë njohur shumë djem dhe e kundërta, djem që kanë njohur shumë vajza dhe që i gënjejnë prindërit e tyre. Kështu që, imagjinoni që të gjitha vajzat të jenë të tilla dhe që të mos martohet me asnjërin. Plaken dhe nuk arrijnë të martohen.

Natyrisht, djali për dy- tri vjet “qëndron i lumtur”, por mbetet gjithë jetën i pikëlluar. Po kështu edhe vajza. Zoti i Madhëruar thotë: “Dhe drejtësia nuk është që të vini në shtëpinë nga shpina e tyre, por drejtësia është ai që është i devotshëm, i cili hyn në shtëpi nga dyert e tyre dhe kini frikë Allahun që të gjeni shpëtim.” (El Bekare, 189).

Pra, një vajzë që gënjen familjen e saj, është një tradhtarë ndaj babait dhe nënës së saj, përderisa ajo shoqërohet me një djalë të ri, pa dijeninë e tyre. Ky baba që mundohet dhe djersitet për ty, ti a ia kthen bamirësinë duke futur dikë prapa shtëpisë, apo thjesht duke e lajmëruar babin se ka shkuar me dikë pa lejen e tij vetëm përmes telefonit?

Një pyetje për vajzën, nëse babai yt dëgjon nga dikush tjetër se ti je duke folur me një djalë deri në orët e vona të mëngjesit, duke përdorur fjalë të ndaluara e të turpshme, çfarë do të ndodhte me ty? Padyshim se kjo për ty do të nënkuptonte një lloj shkatërrimi e kolapsi. Me siguri se nuk do të mund ta shikonit babanë tuaj në sy. Çfarë thua për faktin se Zoti i Madhëruar është Ai që ju sheh? E ke imagjinuar këtë? Ku është turpi ndaj Zotit të Madhëruar? Si ndihesh ti kur e di që Zoti të dëgjon kur i thua këto fjalë? E vërteta është se një femër humbet shumë nga turpi kur hyn në lidhje të tilla dhe kur e gjen veten duke bërë gjëra që nuk i ka imagjinuar se shkojnë me natyrën e pastër të saj.

Përktheu nga arabishtja: Shpend Hulaj

Dashuria dhe kujdesi ndaj prindërve

“Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mira ndaj prindërve të tij...” (El Ankebut, 8)

Isa Tërshani

SHPËRBLIMI PËR SJELLJE TË MIRË NDAJ PRINDËRVE ËSHTË I NJËJTË ME SHPËRBLIMIN E HIXHRETIT DHE TË XHIHADIT.

Ligjëratat dhe temat që flasin për respektin dhe bindjen ndaj prindërve janë të pafundme. Por, unë kam për qëllim që t’u drejtohem në veçanti të rinjve. Në këtë temë, do të flasim se si duhet të jenë raportet tuaja me prindërit tuaj. Synojmë që me këtë shkrim modest, sadopak, të kontribuojmë në afrimin e zemrave të të rinjve, me zemrat e prindërve të tyre. Dhe qëllimi tjetër është që të rinjtë tanë ta adhurojnë Zotin e Madhëruar dhe të fitojnë kënaqësinë e Tij nëpërmjet respektit të prindërve. Do të sjellim disa këshilla praktike, me të cilat mund t’ua bëjmë qejfin prindërve tanë dhe njëkohësisht të fitojmë edhe kënaqësinë e Zotit të Lartmadhëruar.

Një nga karakteristikat dalluese të myslimanit të vërtetë është trajtimi me respekt dhe mirësi i prindërve të tij. Ai me këtë e çon në vend njërin nga urdhrat më të rëndësishëm të Islamit, siç konfirmohet me Kuran dhe Sunet. Myslimani i cili e kryen këtë urdhër, duhet të jetë i pajisur me sjellje të mirë dhe të respektueshme ndaj prindërve të tij. Allahu i Madhëruar thotë: “Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve...” (En Nisa, 36). Nga ajeti në fjalë shohim se dëgjueshmëria ndaj prindërve vjen menjëherë pas dëgjueshmërisë ndaj Allahut xh.sh..

Kjo fe e ka ngritur pozitën e prindërve deri në atë shkallë, sa që nuk ka qenë e njohur në ndonjë besim tjetër, për shkak se Allahu xh.sh. e ka vendosur mirësinë dhe respektin ndaj prindërve vetëm një shkallë më poshtë se besimin në Të dhe mos shoqërimi në adhurim me Të.

Ka shumë ajete, të cilat e përforcojnë porosinë se kënaqja e prindërve vjen e dyta me radhë pas kënaqjes së Allahut xh.sh., dhe se respektimi i tyre konsiderohet virtyt njerëzor, i cili është vetëm një hap më poshtë besimit në Të. Kështu, myslimani i vërtetë është shumë më i njerëzishëm dhe më



respektues ndaj prindërve se sa ndaj ndonjë krijese tjetër në këtë botë.

POZITA E PRINDËRVE

Kurani famëlartë na paraqet një fotografi të gjallë të pozitës së lartë të prindërve dhe na sqaron mënyrën e shkëlqyeshme, me të cilën i trajton ata, nëse njëri ose tjetri jeton deri në pleqëri dhe arrin moshën e dobësisë dhe paafësisë, ku thotë: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuron tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahu përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.” (El Isra, 23-24).

Ky është një obligim hyjnor për myslimanët, i cili është paraqitur në formën e një urdhri të prerë dhe absolut: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë...” Këto fjalë tregojnë lidhjen e fortë që ekziston ndërmjet adhurimit të Allahut dhe trajtimit të prindërve me respekt dhe mirësjellje. Kjo e ka ngritur pozitën e prindërve deri në atë masë që njerëzit e urtë, reformatoret dhe filozofët, kurrë nuk ia dolën ta realizojnë.¹ Ky ajet nuk ndalet vetëm me theksin për respektin ndaj prindërve, mirëpo vazhdon t'i mobilizojë forcat e mëshirës, përdëllimit dhe mirësisë në zemrat e fëmijëve, në mënyrë të butë, që është plot humanitet ku thotë: “Nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka nxënë pleqëria pranë kujdesit tënd...”

Në ajet posaçërisht theksohet që të kujdesemi për prindërit tanë kur t'i arrijë pleqëria dhe kur kujdesi dhe ndihma jonë është më se e nevojshme për ta. Kjo s'do të thotë se nuk duhet të jemi të dëgjueshëm ndaj prindërve derisa ata ende janë të rinj dhe të fortë. Është e vërtetë se prindërit pleq ndonjëherë nga pak janë edhe më të “bezdisur”, çdo gjë ju pengon, pyesin disa herë për një çështje, sepse kanë dëshirë të dinë më tepër se sa ndoshta ju duhet etj.. Kjo është shenjë pleqërie dhe seniliteti,² andaj duhet të jemi të durueshëm. Por, mos të harrojmë, se një gjë e tillë, na pret edhe neve. Kur ata të arrijnë moshën e pleqërisë dhe dobësisë, ata janë nën kujdesin tuaj dhe ju duhet të mos ankoheni, e as të mos zemëroheni me ta: “...atëherë mos u thuaj atyre as “of-oh,” as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre...” (El Isra, 23).

Ju duhet të zgjidhni fjalë të mira kur flisni, fjalë që do t'i bëjnë ata të ndihen të dëshiruar dhe të dashur: “Po atyre

Në ajet posaçërisht theksohet që të kujdesemi për prindërit tanë kur t'i arrijë pleqëria dhe kur kujdesi dhe ndihma jonë është më se e nevojshme për ta.

thuaju fjalë të mira dhe të buta, respektuese.” (El Isra, 23). Dhe lutu për ta për të mirat e paharrueshme që t'i kanë bërë, pasi ata u kujdesën për ju kur ishit të vogël dhe i dobët: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.” (El Isra, 24)

Prindërit, Allahu xh.sh. i ka në mbrojtje, e ne na urdhëron që t'i dëgjojmë, na e ndalon që edhe me një thirrje, “uh” ose “oh” t'ua bëjmë me dije se mërzhitemi, ose se nuk na vjen mirë dhe e kemi rëndë me ta. Ka djem dhe vajza që largohen prej prindërve të vet. Madje ka edhe prej atyre, të cilët, prindërit e tyre i thërrasin me emra të papëlqyeshëm dhe sillen keq me ta, etj. Harrojnë se kjo do të mund t'iu bëhet shkak të zhyten në të liga dhe të futen në gjynahe të mëdha. Ai i cili vërtet beson dhe respekton Allahun xh.sh., ai me siguri do t'i respektoj edhe prindërit e vet, për arsye se e di se është dëshirë dhe urdhër i Zotit të Madhëruar.³

RASTI PËR TA FITUAR XHENETIN

Kjo është një mirësi që ne të gjithë e kemi në shtëpitë tona, por që nuk ia dimë vlerën e vërtetë të saj. Kjo mirësi lidhet ngushtë me dy njerëzit që kanë sakrifikuar për ty më shumë se kushdo tjetër dhe lutja e tyre është e pranuar. Njëri prej tyre është nëna jote. Ajo vuajti kur të nxori në dritë. A mos vallë mbaruan vuajtjet e saj me lindjen tënde?! Jo vallahi! Kur fëmija qan, qan edhe nëna bashkë me të, e kur fëmija gëzohet edhe nëna gëzohet bashkë me të. Sa e sa net kanë kaluar e ajo nuk ka vënë gjumë në sy, vetëm e vetëm që fëmija i saj të flejë i qetë. Kjo është nëna. Kjo është krijesa për të cilën Pejgamberi a.s. tha: “Shërbeji nënës se Xheneti është nën këmbët e saj.”⁴

Xheneti në tokë është nën këmbët (respektin) e kësaj krijese kaq të mrekullueshme, të cilën e respektoi Zoti i Madhëruar dhe Pejgamberi i Tij, por fatkeqësisht nuk e respektojnë një pjesë e konsiderueshme e njerëzve.

Prindi tjetër është ai ushtari i panjohur, është babai yt. Del në mëngjes dhe kthehet në mbrëmje. Për hatër të fëmijës së tij, ai bëhet koprrac e frikacak dhe mundohet të kursej diçka nga xhepi i tij, sepse tashmë ai ka një emër tjetër, ka emrin “baba”. Ai pakëson nga qejfet dhe shoqëria e tij, bën çdo lloj pune vetëm për fëmijën e tij. Pak njerëz e dinë se ç'vuan babai.

Këta janë ato dy krijesat për të cilët kemi përgjegjësi para Allahut të Madhërishtë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Secili prej nesh e njih veten e tij dhe kur mendojmë për këtë gjë, dalim në përfundim se jemi neglizhentë ndaj tyre.⁵ Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Qoftë i nënçmuar, qoftë i nënçmuar, qoftë i



nënçmuar!” Kush o i Dërguari i Zotit? - i thanë. “Ai që i arrin të dy prindërit, ose njërin prej tyre në moshë të pleqërisë, e nuk hynë në Xhenet.”⁶

Në një hadith tjetër thotë: “Tri lutje janë të pa kthyer tek Allahu: Lutja e atij që i është bërë e padrejtësi, lutja e udhëtarit dhe lutja e prindit për fëmijën e vet.”⁷

Transmetohet nga Ebu Derda r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Prindërit janë dera e mesme e Xhenetit.”⁸ Nga këto thënie të Pejgamberit a.s. dhe të ngjashme me këto, na bëhet me dije se hyrja në Xhenet - në mes tjerash - varet edhe prej respektit dhe dëgjueshmërisë ndaj prindërve.

DISA VEPRIME TË PAKUJDESSHME NË RAPORT ME PRINDËRIT

1. Mungesa e dialogut me prindërit – Të rinjtë që i përkasin kësaj kategorie, zakonisht qëndrojnë të heshtur në familje, ata nuk kanë gatishmërinë të hapin një bisedë me prindërit e tyre dhe shumicën e kohës e kalojnë në dhomën e tyre duke qëndruar para kompjuterit apo me celularin në dorë, e duke i anashkaluar prindërit. Nëse ti o vëlla i përket kësaj kategorie, a mendon se kështu e kënaq Zotin?!

2. Mungesa e këshillimit me ta – Ka të rinj që nuk i vlerësojnë këshillat e prindërve dhe nuk tregojnë asnjë interesim për këshillat e tyre. Edhe pse prindërit kanë një përvojë të gjatë, këshillat e tyre refuzohen nga një kategori fëmijësh. Nëse një këshillë të caktuar ua bën një nga miqtë e tyre, ata e pranojnë dhe e vënë në zbatim menjëherë, edhe pse të njëjtën këshillë ua ka dhënë babai para një viti. Pra këshillohu me ta, edhe nëse mendon se këshilla e tyre nuk është e nevojshme.

3. Ndjenja e sikletit për shkak të sjelljeve të tyre – Ndonjëherë, të rinjtë kryejnë akte në kundërshtim me vullnetin dhe dëshirën e prindërve, për të shprehur pakënaqësinë me sjelljet e tyre. Ka të rinj, të cilët ngasin makinën me shpejtësi marramendëse, thjesht sepse prindërit

e tyre i konsiderojnë akoma të vegjël. Me këtë akt, ata duan t’u thonë se janë rritur tashmë. Andaj, bëj durim për sjelljet dhe reagemet jo të drejta të prindërve. Mos shfaq pakënaqësi ndaj sjelljeve të tyre, se kjo është më e dobishme për ty.

4. Nuk ua dinë për nder prindërve për gjithçka kanë bërë – Ka të rinj që besojnë se prindërit nuk kanë ndonjë kontribut në formimin e tyre, ata besojnë se nuk kanë kurrfarë obligimi ndaj tyre, sikur fare s’janë munduar për ta. Pra pyeti dhe interesohu për preokupimet që i kanë pasur për ty. Ofrroje ndihmën tënde çdoherë.

5. Pranojnë që miqtë dhe shokët t’ju shajnë dhe ofendojnë prindërit – Është fakt që te të rinjtë është përhapur sharja me prindër dhe më e keqja është se e shohin si diçka normale, përkundër asaj se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ndër gjynahet e mëdha është kur dikush të shajë prindërit e tij.” Dikush ndërhyri dhe e pyeti: “E si mund të shajë njeriu prindërit e tij, o I Dërguar I Allahut?!” Muhamedi a.s. u përgjigj: “Shanë prindërit e dikujt tjetër dhe ai shanë prindërit e tij.”⁹ Një ditë, Ebu Dherri u zemërua, dhe i tha Bilalit: “O biri i zezakes.” Bilali r.a. u ankua te Pejgamberi a.s.. Ai e thirri Ebu Dherrin dhe i tha: “A e ke fyer Bilalin?” “Po” - iu përgjigj. “A e ke përmend nënën e tij?” “Po!” - i tha. Pejgamberi a.s. ia ktheu: “Ti ende ke gjurmë të xhahiljetit (injurancës).”¹⁰

Sa madhështore është kjo fe, e cila na mëson për humanitetin dhe sjelljen njerëzore, e sidomos na mëson se si duhet të sillemi me prindërit, çfarë shikimi duhet të kemi, të mos mrrolemi, si duhet ta kemi zërin, të mos e ngremë zërin, të kemi fytyrë të buzëqeshur dhe mos të bëjmë shaka pa vend me ta. Sa më shumë shtohet respekti, bamirësia me prindërit, aq më shumë shtohet edhe afërsia me Krijuesin e Madhërisëm.

Andaj, lutu për ta tek Allahu, gjallë qofshin apo të vdekur, që t’i falë, bëj vepra të mira që do t’u bëjnë mirë atyre në Ahiret, vizitoji dhe ki kujdes ndaj miqve të tyre dhe jep sadaka për ta.

1 Dr. Muhamed Ali el Hashim, *Muslimani Ideal*, (Prishtinë: Sh.B. Fjala e Bukur, 2008.) f. 67.

2 Mikel Ndrecaj, *Fjalor fjalësh e shprehje të huaja*. (Prishtinë: Rilindja, 1986.) f. 620. Senil-i (lat. Senilis-i plakut) Karakteristikë për plakun, i cili ka humbur vetitë mendore të njeriut të pjekur.

3 Ejup Mazllami, *Përktheu. Hutbe dhe vaze të zgjedhura II*. (Tetovë: Shtëpia botuese “ASR” 2001.) f. 185.

4 Nesaiu, *Sunenu en Nesaij*, (Rijad, Mektebetu el Mearifi lineshri et Tevzi, 2008.) Hasen sahih, hadithi nr. 3104. f. 478

5 Ferid Piku, *Mesazhe nga zemra*, (Shkup, Furkan ISM, 2015.) f. 441.

6 Muslimi, *Sahihu Muslim*, (Damask - Siri, Muessesetu er Rrisaletu nashirun, 2013). Sahih, nr. 6510.

7 Tirmidhiu, *Sunenu et Tirmidhij*, (Rijad, Mektebetu el Mearifi lineshri et Tevzi, 2008.) Hasen, nr.1905.

8 Ibni Maxhe, *Sunenu ibnu Maxheh*, (Rijad, Mektebetu el Mearifi lineshri et Tevzi, 2008.) Sahih nr.3663.

9 Buhariu, *Sahihu el Buhari*, (Kajro. Daru el Gadi el Xhedid, 2013.) nr. 5971.

10 Amër Halid, *Xheneti në shtëpitë tona*, (Shkup, Furkan ISM, 2011.) f.195.

Gruaja – prehja e zemrës, qetësia e shpirtit

Mimoza Sinani

Lumturia e shoqërisë është familja e lumtur. Familje do të thotë grua. Gruaja është themeli i shoqërisë dhe shtylla e familjes. **Ajo** është lidhësja që i bashkon pjesëtarët e shoqërisë njerëzore.

Ajo është edukatorja jo vetëm e fëmijëve të saj, por e gjithë njerëzisë. **Ajo** është bijë e prindërve fisnikë, është motër e vëllait të moralshëm, është mbesë e gjyshërve besimtarë, është gruaja e burrit me moral të lartë, është nënë e bijve të saj. **Ajo** iu përngjan akvareleve të mbushura me shpresë, dritë, mall e dashuri. **Ajo** është kryevepra e krijimit, simboli i virtytit, burimi i pastër i ndërtimit të brezave. Nga ajo zënë fill gjërat më tokësore e jetësore si: buka, malli, dashuria, gëzimi, paqja, drejtësia, humanizmi.

Ajo në moshën e saj vajzërore është si një petale e butë, një lule delikate, një manushaqe erëmirë. Është e bukur si një ujëvarë në rënien natyrale, e pastër si një vesë luleje që vezullon mbi petal. **Ajo** rrezaton flatra bukurie si një zanë që del nga hojet kristalore. **Ajo** është si një kopsht me polen lulësh, ku flatrat e fluturave shëtisin ëndrrat e saj të bardha. Atë e ndriçon drita e yjeve të qiellit dhe e shoqëron melodia e këngës së engjëjve.

Ajo është si një perlë me shkëlqim dhe bukuri të pakrahasueshme. Ashtu si perla që qëndron e mbështjellë me guaskën e saj, edhe ajo e vendos mbulesën e saj që shkëlqimi i saj të ruhet dhe të mbetet përherë. Mbulesa paraqet për të një oazë në hijen e së cilës ajo strehohet dhe është simbol i një sërë vlerash të larta morale. Allahu ia urdhëroi vendosjen e saj me qëllim që pamja e saj dinjitoze e jashtme të jetë në harmoni me brendinë e saj të pastër, me shpirtin e saj të dëlirë e të kthjellët.

Ajo është shembulli i vërtetë i dëlirësisë, i pastërtisë, i krenarisë, i dinjitetit, i sinqeritetit, i fisnikërisë, i kryerjes së

Ajo ka një kod të veçantë lirizmi, që buron nga mënyra se si ajo e percepton të bukurën. Është bukuria e dashurisë universale që ajo rrezaton pafundësisht plot freski.

shumë ibadeteve, i sakrificës në rrugën e Allahut, si dhe i kontributit në mësimin dhe gjurmimin e së vërtetës.

Ajo, pavarësisht nga pasuria, pozita dhe fama e saj, lumturinë më të madhe e gjen në martesë. Martesa është një ndjenjë e lashtë primordiale, e mbjellë në gjenet e çdo femre.

Ajo e ndërton kështjellën e vet jetësore mbi baza të forta, themelet e së cilës i përforcon me moralin dhe besimin e saj fetar. Ajo e lartëson kështjellën e saj të lumturisë duke vendosur një mbi një gurët e çmuar të fisnikërisë, të krenarisë, të dinjitetit.

Ajo nuk pret që dikush t'ia shtrojë jetën me petale që të ecë përmbi to, nuk pret që të jetë mes të mirave për të dhënë më të mirën e saj, por është modeste si zambaku i ujit, bukuria madhështore e të cilit nuk krijohet në një lëndinë të blertë apo mbi ujëra kristali, por mbi ujin e ndenjtur të një

liqeni që është duke shtuar.

Ajo është tharmi i përhershëm i dashurisë, është një pemë e bukur me degëza plot lule që jep fruta në çdo stinë. Një ditë ndihet zëri i një foshnje dhe si një engjëll vjen në jetë bebja e bukur, të cilën ajo e mban në prehër dhe i këndon ninullën e shpirtit të saj. Shpirti i saj, i mbushur me fijeza lumturie, dridhet nga ndjenja e ëmbël si mërmërima e një liqeni. Të qarat e foshnjës i tingëllojnë si cicërima zogjsh në një qiell maji.

Ajo i ngjason një oqeani energjetik me hapësira dallgëzuese, brenda të cilit gjenerohen, projektohen, vrundullojnë dhe shpërthejnë dimensione të tjera jete. Nga fytyra e saj shpërthen një aureolë rrezatuese, buzëqeshja e saj është plot rizim lulësh e lirizëm transparent, plot dritësi e potencë amësie.



Ajo ka një kod të veçantë lirisie, që buron nga mënyra se si ajo e percepton të bukurën. Është bukuria e dashurisë universale që ajo rrezaton pafundësisht plot freski.

Ajo bën lidhjen e magjishme të dashurisë së saj me trashëgimtarët dhe shtrin një urë bashkimi dhe komunikimi mes së kaluarës dhe të sotmes dhe të sotmes me brezat që do të vijnë.

Ajo formon vatrën e vet familjare ku fëmija i saj sheh dritën e jetës dhe hedh hapat e parë, ku ai qesh dhe qan, ku ai luan dhe ëndërron. Kjo strehëz e ngrohtë familjare është parajsa e mbretërisë fëmijërore që kapërcen kohësinë konkrete dhe ndërtohet në kohën e përjetshme.

Ajo i përcjell me fjalët e ëmbla nektar fëmijët e saj në mësim, provim, punë e kudo... **Ajo** kujdeset për fëmijën e saj ashtu siç kujdeset për një fidan të vogël zambaku a trëndafil. **Ajo** nuk kursen asgjë për t'u përkujdesur për fëmijët e saj ashtu si një nikoqire e mirë që vadit pa u lodhur lulet e shumëllojshme, që të rinojnë me bukurinë e petaleve të puthura nga vesa e mëngjesit.

Ajo tregohet e dhembshur dhe e durueshme gjatë edukimit të fëmijëve të saj, duke mbjellë te ta ndjenjën e butësisë, të mirësisë, të dashurisë, të qetësisë, të fisnikërisë, të paqes, të mëshirës. **Ajo** i dhuron shoqërisë dhuratën më të shtrenjtë: fëmijë me dhunti të larta morale, fëmijë të ditur dhe besimtarë, fëmijë të udhëzuar në rrugë të drejtë, fëmijë fisnikë dhe të zellshëm...

Ajo fiton mirësjelljen, respektin dhe dashurinë e njerëzve rreth e rrotull saj.

Brenda petaleve të kujtesës së saj ruhet blerimi i dashurisë së përhershme... Kjo buron nga vetë natyrshmëria e krijimit të saj që e ka gjenezën te Krijuesi i gjithësisë.

Ajo krijon një botë me dashuri të thellë e të virtytshme, të pastër e të kthjellët, që u jep një bukuri të veçantë gjërave jetësore.

Ajo edhe në moshë të shtyrë është mbretëresha e familjes dhe qëndron në fronin e saj duke dhënë kumte fisnike që ushqejnë së brendshmi botën shpirtërore të fëmijëve, të nipërve dhe të mbesave të saj të shumtë, të cilët do të jenë ndihmë për të në pleqëri dhe thesar për të pas vdekjes.

Ajo edhe kur plaket dhe balli i qëndiset nga rrudhat e margaritarta dhe flokët i qëndisen nga thinjat e mëndafshita, nuk e humbet madhështinë dhe nderimin nga fëmijët e saj.

Ajo nuk rrëzohet kurrë nga vjeshta e trishtimit. Çdo çast i jetës së saj është shkruar me kode në qelizat e qenies së saj. Çdoherë kur shkunden degëzat e kujtimeve, ajo ndien tingujt e butë shpirtërorë që e lidhin atë me njerëzit më të afërt e mbi të gjitha me Krijuesin Madhështor.

Ajo krijon një botë me dashuri të thellë e të virtytshme, të pastër e të kthjellët, që u jep një bukuri të veçantë gjërave jetësore.

Vështirësitë socio-ekonomike të dimrit

Dr. Mirsad Asllani



“Bujari në këtë botë është afër njerëzve, në botën tjetër do të jetë afër Allahut në Xhenet, larg Xhehenemit. Kurse, koprraci është larg Allahut, Xhenetit dhe njerëzve, afër zjarrit të Xhehenemit!”

PUNONI DHE INSISTONI PËR HUMANITET DHE SOLIDARITET NË SHOQËRI

Gjendemi në ditët më të vështira të vitit, ditët e ftohta të dimrit, të cilët nuk pyesin, a je i varfër apo i pasur, i moshuar apo i ri, i shëndetshëm apo i sëmurë. Prandaj, është obligim kolektiv i gjithë shoqërisë, si një shoqëri socio-humane, që t’u dalim në ndihmë të gjithë atyre që kanë nevojë dhe assesi nuk duhet të lejojë që në shoqërinë tonë, të ketë prej atyre që vuajnë në këto ditë të vështira të dimrit. Në këto ditë të vështira, disa kanë nevojë për ndihmë ekonomike, por ka edhe prej atyre që janë një numër respektabil që kanë nevojë për ndihmë sociale-humane. Në shoqërinë tonë, për shkak të emigrimeve të shumta, kemi një numër të madh të moshuarve që qëndrojnë mirë në aspektin ekonomik-material, mirëpo, për shkak të moshës dhe vështirësive të dimrit, ata kanë nevojë për ndihmën humane, p.sh. për shkak temperaturave të ulëta, ftohtit, borës, shiut etj., nuk kanë mundësi të lëvizjes nga shtëpia e tyre dhe kanë nevojë për dikën që t’u blejë ushqime, ilaçe, të paguajë shërbimet komunale etj.. Ebu Hurejre r.a., përcjell se i Dërguari i Allahut, a.s., ka thënë: “Atij që ia largon besimtarit një brengë të kësaj bote, Allahu do t’ia largojë një brengë të Ditës së Kiametit. Kurse kush ia lehtëson ndonjë vështirësi atij që ka, Allahu do t’ia lehtësojë në këtë botë dhe në të amshueshmen.” (Muslimi, 2699). Por, ka

edhe nga ata që realisht kanë edhe vështirësi ekonomike, ngase, në vendin tonë dimri sjell papunësi të shtuar, sepse një numër i madh i njerëzve punojnë punë fizike, që gjatë stinës së dimrit ndërpriten, por gjithashtu edhe për shkak të komunikimit të dobët mes njerëzve për shkak të kalimit të shumicës së kohës në ambientet e mbyllura. Prandaj, besimtari i vërtetë, njeriu si qenie socio-humane duhet të ketë gjithmonë parasysh vëllain, fqinjin, familjarin, fafesisin, mikun, kolegun, por edhe gjithë shoqërinë në të cilën jeton dhe nuk duhet të jetë kurrë dhe assesi egoist duke menduar me moton: “Kush nuk është për veten e tij, nuk është për askënd!”

Qëndrimet apo mendimet e tilla, mësimet islame i mohojnë. Të menduarit të tillë, njeriu duhet t’i shmanget, ngase Islami na mëson ndryshe, Libri i Zotit dhe këshillat e Pejgamberit a.s., na mësojnë ndryshe, madje të kundërtën e kësaj. Enes ibën Maliku r.a., përcjell se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Nuk beson askush nga ju derisa nuk dëshiron për vëllain e tij atë që dëshiron për vete.”¹ Për sjellje të tilla, Pejgamberi i Allahut a.s., premtan parajsën e Zotit. Muhamedi a.s., një ditë i tha shokut të tij Jezid b. Esed el Kasiut: “A e do Xhenetin?” Ai ia ktheu: “Po!” Atëherë Pejgamberi a.s., i tha: “Atëherë dëshiro për vëllain tënd atë që do për veten.”²

Njeriu, gjithmonë duhet të kujdeset për kohën dhe pasurinë e tij, të mos ketë shpenzime në mënyrë të panevojshme, të

punojë me ndershmëri dhe të kursejë, por nga ana tjetër, nuk duhet të jetë dorështrënguar, sepse Allahu ua tërheq vërejtjen atyre që janë dorështrënguar: “...e dikush prej jush bën koprraci, e kush bën koprraci, ai bën kundër vetës, Allahu s’ka nevojë ...” (Muhamed, 38). Duhet të ndajmë atë të mirë që e kemi dhe të jemi bujarë me njerëzit, sepse për njerëzit e tillë, Allahu ka përgatitur xhenetet e Tij: “Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një Xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.” (Ali Imran, 133-134).

Në këtë kontekst, ka ardhur edhe transmetimi nga nëna e besimtarëve, Aisheja r.a., për ata që ndihmojnë njerëzit në aspektin ekonomik dhe janë bujarë, duke na mësuar dhe transmetuar fjalët e Pejgamberi a.s., i cili ka thënë: “Bujari në këtë botë është afër njerëzve, në botën tjetër do të jetë afër Allahut në Xhenet, larg Xhehenemit. Kurse, koprraci është larg Allahut, Xhenetit dhe njerëzve, afër zjarrit të Xhehenemit!”³

Të ndihmuarit e njerëzve në aspektin material, Allahu xh.sh. e konsideron sikurse huazim ndaj Vetes, dhe premtion shumëfishimin e mirësisë dhe shpërblimit: “S’ka dyshim se ata që japin lëmoshë (sadaka) dhe vullnetarisht i japin hua Allahut, atyre u shumëfishohet dhe ata kanë shpërblim të madh ... Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë, e që Ai t’ia shumëfishojë atë dhe ai ka një shpërblim të mirë.” (El Hadid, 8-11).

Në këtë kontekst edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. na mëson: “Nuk ka asnjë ditë që njerëzit të zgjohen pa zbritur dy engjëj. Njëri prej tyre thotë: “Allah, shtoja atij që jep!”, ndërsa tjetri thotë: “Allah, shkatërrojë pasurinë e koprracit!”⁴ (Buhariu, 1442 dhe Muslimi, 2692). E ngjashme me këtë është transmetuar edhe në hadithin kudsij, ku Zoti xh.sh. thotë: “Shpërndaj o biri i Ademit dhe do të të jepet!”

SI DHE SA T’I NDIHMONI NJERËZIT NË KËTO DITË E VËSHTIRA TË DIMRIT?

Para se të gjithash, njeriut duhet ta pastrojë nijetin (qëllimin) e tij, atë që ndanë nga munda i tij, ashtu siç ka ardhur në ajetet kuranore, ta ndajë për hir të Allahut, që të fitojë mirësi e kënaqësinë e Tij. Më pastaj, besimtari duhet të jetë i lumtur dhe i kënaqur që ka mundësi t’i lumturojë të tjerët, sepse, thotë një fjalë e urtë popullore: “Lumturia personale është në lumturinë e të tjerëve (duke i ndihmuar të tjerët).” Njëkohësisht duhet të kuptojmë se në këto ditë të vështira nuk ka gjë më të bukur se të jesh në lutjet e të varfërve dhe nevojtarëve.

Kur themi “Ta ndihmosh të varfrin apo nevojtarin në këto ditë të vështira”, nuk do të thotë se duhet të jemi shumë të



pasur për ta pasur mundësinë e ndihmës ndaj nevojtarit, ngase Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive dhe ne do të mirremi në pyetje në Ahiret, në bazë të mundësisë që kishim në këtë botë. Kështu që, njeriu duhet të ndihmojë aq sa ka mundësi. Nëse nuk është në gjendje t’ia lehtësojë nevojtarit gjithë dimrin, le ta bëjë gjysmën e dimrit, apo vetëm një pjesë, apo vetëm një ditë. Nëse nuk mund ta ndihmojë me një ndihmë madhore, le të jetë ndihma solide, apo minimale, duke mos e braktisur minimalen vetëm pse nuk mund ta arrijmë maksimalen, etj. Qëllimi është që të jemi pranë të afërmeve, familjes, miqve, pranë shoqërisë, të varfërve, nevojtarëve etj., qëllimi është të jemi pjesë e lumturisë së tjetrit, pjesë e gëzimit, buzëqeshjes, në suazat e mundësisë që na ofrohen. Ngase, ka thënë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Më i dashuri tek Allahu është ai që u sjell më shumë dobi njerëzve dhe vepra më e dashur tek Allahu është të fusësh një gëzim në zemrën e myslimanit ose t’i largosh atij një brengë; t’ia lash borxhin apo t’ia largosh urinë. Sikur të eci me vëllain tim për t’i zgjidhur atij një hall është më e mirë për mua se një muaj itikaf në këtë xhami.”⁵ Duke vepruar për të mirën e gjithë shoqërisë, në mënyrë që gjendja e saj të ndryshojë, e ajo ndryshohet vetëm me reforma, me përpjekje të përbashkëta dhe me angazhime, e më pastaj vjen edhe ndihma e Allahut: “... Allahu nuk e ndërton një popull derisa ata vetveten nuk e ndërrojnë.” (Er R’ad, 11).

1 Buhariu, 13, Muslimi, 45.

2 Ahmedi, 4/70.

3 Tirmidhiu, 1961.

4 Buhariu, 5352, Muslimi, 2178.

5 Taberaniu.

A është Islami fe e paqes apo e luftës?¹

Akademik Enes Kariq

Debati mbi këtë temë zhvillohet për shekuj me radhë. Ata që pretendojnë se Islami është fe e luftës, e lexojnë historinë në mënyrë selektive, sikurse dhe ata të cilët pretendojnë se myslimanët gjithmonë dhe kudo kanë qenë paqebërësit, sikur lulja në kopsht. Ekzistojnë, natyrisht, disa fakte të cilat i respektojnë shumë historianë. Për shembull, ka qenë mesjeta islame, nga shekulli XVIII deri në shekullin XVI, sipas epokës kristiane, e cila ka krijuar qytete që ishin multikulturore dhe multifetare. Miliona të krishterë janë integruar në kalifatet myslimane, shpesh si njerëzit e komuniteteve të veta, por edhe si mësues, mjekë, tregtarë etj. Natyrisht, të krishterët dhe hebrenjtë kanë pasur statusin e “pasuesve të Librit», i njohën myslimanët si sundimtarë, por e kanë gëzuar lirinë e konsiderueshme të praktikimit të fesë dhe zakoneve të tyre. Në periudha të gjata të paqes, lulëzuan shumë komunitete rajonale të krishterë, veçanërisht ato të ritit lindor. Hebrenjtë në perandoritë e mëdha islame, më pak a më shumë, jetonin në aleancë me kalifët dhe sulltanët, dhe se ato aleanca ishin shumë të ngjashme me aleancat e sotshme të jetesës së hebrenjve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ne nuk duhet të harrojmë se në shekullin XV dhe XVI, Gadishulli Iberik në njërin anë dhe pjesët perëndimore të Azisë së Vogël në anën tjetër, i zëvendësuan zotërimin. Të krishterët rekonkuistë e sekuestruan Gadishullin Iberik, ndërsa në anën tjetër, osmanlinjtë e çliruan Kostandinopojën, dhe pjesë të mëdha të Ballkanit. Myslimanët dhe hebrenjtë janë fshirë tërësisht nga Spanja dhe Portugalia, por kjo me të krishterët nuk ka ndodhur nën sundimin e osmanlinjve. Gjithashtu, kisha në Ballkan që sot quhet Kisha Ortodokse Serbe, është stabilizuar nën sundimin e osmanlinjve.

A ËSHTË KURANI LIBRI QË BËN THIRRJE PËR DHUNË?

Sigurisht që sot ka myslimanë të cilët e lexojnë Kuranin në mënyrë të dhunshme, të ngurtë. Sot, kësi lloj grupesh myslimane ka gjithnjë e më shumë, në keqardhje time dhe të gjithë neve. Mirëpo, unë ngrihem në mbrojtje të Kuranit. Kurani nuk është për t'u fajësuar për interpretime të ngurta që rrjedhin prej tij. Ashtu sikur që nuk është fajtor Friedrich Nietzsche për lexime fashiste dhe naziste të recitimit të veprave të tij. Gjithashtu, nuk mendoj se “Kapitali” i Karl Marksit është fajtor për gulagët e Stalinit. As nuk mendoj se e ka fajin uraniumi nga i cili formohen bombat e tmerrshme. Jo. Çdo gjë mund të keqpërdoret. Me lirinë njerëzore është edhe keqpërdorimi. Në qoftë se mbi ndonjë njeri derdhni një ton të trëndafilave të bukur, ju mund ta shtypni atë, ta vrisni.

Historianët e matur janë të vetëdijshëm se marrja e qyteteve të mëdha në anën tjetër të Mesdheut zgjati për më shumë se një mijë vjet, për shkak të frymës së drejtë dhe pluraliste të Kuranit e cila është përhapur në shoqëritë myslimane. Në Kuran thuhet: “Ata që besuan dhe ata që ishin hebrenj, të

Është mirë të shmanget etiketimi i cilësdo fe me terma të tmerrshme, si terrorizëm, ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi, duke përfshirë edhe Islamin.

krishterë dhe sabejë, që kanë besuar në Zotin dhe botën tjetër (Ahiretin), që besuan dhe punuan vepra të mira, i takon shpërblim te Zoti i tyre! Ata nuk do kenë frikë dhe ata nuk do e humbnin shpresën!” (El Bekare, 62). Natyrisht, në Kuran ka pika të mprehta sa u përket disa dogmave të krishtera, të tilla si Triniteti, si dhe të disa besimeve të hebrenjve, por mesazhi i Kuranit

është mjaft i vendosur: Zoti është Krijuesi i të gjithëve, Zoti është Zot i të krishterëve, myslimanëve, hebrenjve, adhuruesve të zjarrit, dhe jobesimtarëve. Në faqen e parë të Kuranit thuhet se Zoti është - *Rabbu l-'alamin*, Zoti i të gjitha botëve, Zoti i të gjithë njerëzve, i të gjithë Universit.

Në këto ajete kuranore fshihet edhe prozeletizmi mysliman. Sipas Kuranit: “Çdo palë krenohet me atë që ka realizuar për vete.” (Muminun, 53). Kuranin duhet lexuar si një tërësi. Ata që nga të tjerët u etiketuan si “terroristët myslimanë”, nuk e lexojnë atë si një tërësi, pra, për këtë arsye ata thirren në pjesë të veçanta nga Kurani dhe mbjellin tmerr në tokë. Të mos harrojmë se Kurani vetë është mbajtur në tërësinë e tij. Edhe romakët e lashtë, si dhe mistikët e Islamit, kanë thënë se librat hyjnorë i ngajnë botës. Ato janë botët në fjalë. Në qoftë se ne në këtë tokë jetojmë vetëm në afërsi të vullkanit, do të konkludojmë se kjo botë është vetëm zjarr, tym, lavë, tmerr. Por, nëse lëvizim pak më larg nga vullkani, do të vërejmë se në këtë botë mbizotëron bukuria. Pra, kështu është edhe me Kuranin, e në qoftë se doni edhe me Biblën. Jezu Krishti (Jezusi, Isai a.s.) nuk bëri thirrje për luftërat e kryqëzatave, e as në rekonkuizëm (ripushtim) kur ai në Dhiatën e Re (sipas Mateut, 10:34) ka thënë: “Mos mendoni se unë erdha të sjelli paqen mbi tokë! Unë nuk erdha të sjelli paqen, por shpatën!” Mistikët islam flasin për shpatën me të cilën duhet prerë vese të veta të këqija, të këqijat e veta. Në pasionet e veta të shpirtit, të ashtuquajturit “terroristët islam” me aktet e veta të dhunës dëmin më të madh ia shkaktojnë vetë myslimanëve, spiritualitetit të tyre tradicional.

ISLAMI – “EKSTREMIZMI I DHUNSHËM” OSE “IDEOLOGJIA RADIKALE”

Është fakt se ekziston një numër i ditur i mediave në Perëndim që në një mënyrë të përgjithësuar nxisin kundër

Islamit. Në lidhje me këtë, që herët, por shumë mirë, shkroi Edward Said në librin e tij “*Farkëtimi i Islamit*”. Edward Saidi, një shtetas arab, i krishterë maronit, shpesh e mbrojti Islamin kundër sulmeve “mongole” të mediave perëndimore.

Është mirë të shmanget etiketimi i cilësdo fe me terma të tmerrshme, si terrorizëm, ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi, duke përfshirë edhe Islamin. Vrasësi Anders Behring Breivik, bëri një krim të tmerrshëm, dhe atë e shpjegonte me krishterimin. Nuk është e mirë që të themi për të se është terrorist i krishterë. Kjo do të fyente të krishterët dhe besimtarët e tjerë. As nuk është e mirë që për veprimet terroriste të IRA-s të themi se janë përhapës të “terrorizmit katolik”. Kështu që, edhe ne myslimanët ndjejmë ankth të tmerrshëm në zemër, kur çdo ditë dëgjojmë nga mediat e krahut të djathtë, fraza të tilla si ‘terrorizmi islamik’ dhe ‘radikalizmi islamik’. Është e nevojshme sot, të paktën në nivelin e terminologjisë, në mediat të punohet në “deislamizimin” e akteve terroriste. Duhet filluar nga hapa të vegjël, për të parë efektet e mira.



A ËSHTË I ASHTUQUAJTURI “TERRORIZMI ISLAMIK” PRODUKT I RELIGJIONIT

Kjo pyetje godet në vetë thelbin e problemit. Në fillim të tetorit qëndrova në Berlin, më është promovuar romani im “Këngët e zogjve të egër” në gjermanisht. Në ato ditë, pak eca rrugëve të Berlinit të bukur, disa orë endesha nëpër rrugët. Refugjatët kudo, kudo myslimanët lypsa. Qindra prej tyre, nënat me fëmijë, sytë e trishtuar dhe të përplotur, një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes aktuale të myslimanëve. Nëna qëndronte pranë murit të një ndërtese të madhe, hixhabi mbi kokën e saj dhe fëmija në krahun e saj të majtë, kurse dorën e djathtë e mbante të shtrirë duke lypur. Kjo është një nga imazhet e mia të multikulturalizmit nga Berlini i përmbytur me refugjatë. Në mbrëmje u thash gjermanëve të mi: A nuk do ishte më e mençur për qeveritë tuaja që të investonin miliarda euro në zhvillimin e paqes, institucioneve, ekonomisë së dobishme në Lindje të Afërt dhe të Mesme? Tani ato miliarda keni për t’i shpenzuar këtu, në mes të Evropës, në refugjatë të uritur, në shkreti dhe mjerim. Gjermanët e mi mikpritës ishin heshtur, vërejtja, se është më mirë që ata të mos i hedh në brengë.

Natyrish, multikulturalizmi është diçka e mirë, e lavdërueshme, e kthjellët. Nëpërmjet multikulturalizmit, ne shohim se Zoti i Gjithëfuqishëm edhe në pjesët e tjera të botës kishte dhënë poetë brilant dhe të shkëlqyer, piktorë, filozofë. Nëpërmjet multikulturalizmit, ne shohim se ne nuk jemi “populli i vetëm i zgjedhur”. Evropa pas vitit 1945, veçanërisht ajo që quhet Evropë Perëndimore, është një kanavacë e madhe, sikur e gjeografisë dhe e historisë, ku projekti multikulturor është duke shkuar mirë.

PAQJA ÇON NË TË MIRËN

Sa herë që flas për konfliktet dhe mospajtimet ndër myslimane sot, jam i vetëdijshëm për ndikimin e Amerikës, Rusisë, Izraelit, fuqive evropiane, dhe jam i vetëdijshëm për gishtat e tyre të vëna në zonën e Lindjes së Mesme, të naftës dhe të gazit. Por, e gjithë kjo nuk i jep amnisti myslimanëve si në pjesën e njëzet apo tridhjetë për qind, ku ata vendosin për veten e tyre, nuk vendosin për njohjen e projekteve të paqes, në mbështetje të paqes si dhe paqes me të tjerët. Kurse implikimet janë të shumta. Nga popullata e përgjithshme e refugjatëve në botë sot, myslimanët përbëjnë rreth shtatëdhjetë për qind. Gjendja e luftës dhe konflikteve në të kaluarën deri në pushtimin amerikan të Irakut dhe Afganistanit, dhe më pas ndodhia e terrorit të së ashtuquajturës “Pranverës arabe”, sikur edhe nuk dihet thjesht se sa ka në të vërtetë luftëra atje, vdekje, mjerim, dëshpërim. Të gjitha këto

Myslimanët duhet të respektojnë shenjtëritë e tyre, por nuk duhet që ata të përdorin dhunën për shkak të shenjtërive të veta.

fatkeqësi rrënojnë në këtë botë, implikimet e këqija nuk munden edhe të llogariten. Është e vështirë, nga të gjitha që shohim në Lindjen e Mesme, të shpresojmë për ndonjë fat, por paqja duhet të vendoset menjëherë.

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME QË FJALIMI RRETH ISLAMIT TË KONTEKSTUALIZOHET?

Në shumë vende evropiane, veçanërisht në Perëndim, gjatë pesë ose gjashtë dekadave të fundit është në skenë laicizmi inkluziv, një ‘beninjë materialiste’. Njerëzit janë në një lloj të laicizmit të tillë, në shekullarizim të tillë, bëhen qytetarë, u bënë të lirë, besimet dhe fetë janë të lira, si dhe llojet e ndryshme të mosbesimit dhe ateizmit. Elita islame dhe fetare myslimane, akademike, kulturore dhe politike në vendet tradicionale islame duhet të kenë ndërmend këtë, sidomos pas rënies së të ashtuquajturës “Pranverës arabe”. Unë mendoj dhe besoj, se Zoti nuk na ka krijuar në këtë botë për të luftuar, që të kalbemi dhe të vritemi. Por përkundër. Si më është e dashur thënia e Muhamedit a.s., i cili tha: “Zoti është i bukur dhe e do të bukurën!”

MBROJTJEN E SHENJTËRIVE DUHET KËRKUAR NË GJYKATË

Myslimanët duhet të respektojnë shenjtërit e tyre, por nuk duhet që ata të përdorin dhunën për shkak të shenjtërive të veta. Myslimanët në Bashkimin Evropian duhet të mbrojnë shenjtërit e tyre, kur shohin se ata u janë shkelur, t’i vënë në procedurë gjyqësore dhe të respektojnë vendimet e gjykatave. Kjo është mënyra e saktë. Kjo do të thotë respektim i vendin, procedurave, të drejtave dhe ligjeve. Pra, kështu duhet të veprojnë dhe ato gra myslimane që besojnë se burka dhe nikabi i tyre janë vizioni i tyre i rrobave apo veshjes sipas Islamit. Sa për hixhabin, mendoj se ai nuk është vetëm zakon islam, ose një pjesë e veshjes islame, por hixhabi është diçka që na vjen nga thellësitë e historisë semite të shenjtë. Kur gratë myslimane e veshin hixhabin, ato i ngjasojnë hixhabi të Virgjëreshës Mari/Merjemes. Kurani përhapë se “Zoti e ka zgjedhur mbi gratë e të gjitha botëve.” (Ali Imran, 42).

Përktheu nga gjuha boshnjake: Dr. Azmir Jusufi

1 <http://cdv.ba/tekstovi/enes-karic-multikulturalnost-pokazuje-da-nema-izabranog-naroda/>, shkarkuar më: 11.09.2022.

Përse qytetërimi islam?

Haki Sahitaj

Historianët, në përgjithësi kanë numëruar rreth njëzet e gjashtë qytetërimi. Prej tyre, rreth gjashtëmbëdhjetë tashmë numërohen të zhdukura. Sipas pikëpamjes *Haludiane*, qytetërimet kalojnë nëpër një cikël, atë të lindjes, pjekurisë dhe shkatërrimit.¹ Kur jemi përballë këtyre fakteve, lind një pyetje e thjeshtë: çështje ky qytetërim islam për të cilin flasim kaq shumë? A nuk shënoi edhe ai lindjen, kulmin dhe tashmë fazën e vet të plakjes? Ndërkohë shumë myslimanë nuk e shohin Islamin thjesht si fe, por ashtu siç edhe ka shkruar Muhamed Ikbali, Islami nuk guxon të mbyllet para botës dhe zhvillimit të saj, pra është edhe një qytetërim.²

Është me rëndësi të thuhet se qytetërimi është një koncept tejet kompleks dhe shpeshherë debatet për një qytetërim islam, por edhe për qytetërimin në përgjithësi, bëhen problematike që në fillim. Edhe pse fenomeni i qytetërimit është universal, karakteristikë e të gjithë gjinisë njerëzore, siç ka shkruar Ibën Halduni³, natyra dhe efektet e qytetërimeve kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ndryshme. Madhështia e qytetërimeve nuk mund të shikohet thjesht në të arriturat e saj, por para se gjithash është tejet me rëndësi të analizohet fryma, botëkuptimi nga i cili një qytetërim merr formë. Edhe pse një qytetërim ka humbur efektin e ndikimeve të strukturave, institucioneve, metodave për një organizim shoqëror, përsëri shtrohet një pyetje nëse këto qytetërimi, tashmë në rënie, kanë humbur vitalitetin e tyre perceptues për veten dhe botën. Ka shumë nga ata të cilët qytetërimin islam e mendojnë me parametra të zhvillimit, me të arritura shkencore, kulturore, arkitekturore e politike, por që shumë nga këto tashmë kanë mbetur në hije nga dominimi i qytetërimit


“Në fakt, problemi i Islamit paraqitet për shkak të konfliktit, dhe njëkohësisht, për shkak të tërheqshmërisë së ndërsjellë të dy fuqive: të fesë dhe civilizimit.” -

Muhamed Ikbali

perëndimor. Po këta, shpeshherë në pamundësi për të kthyer diç nga pas, u referohen rrënjëve të qytetërimit islam si paraprije e qytetërimit perëndimor. Ne mendojmë se nuk jemi të detyruar të biem në një mendësi të tillë si të vetmen mënyrë për të mbrojtur qytetërimin islam. Është shumë i natyrshëm shkëmbimi dhe asimilimi i qytetërimeve. Edhe qytetërimi islam ka shkëmbyer nga përvoja e hershme e persianëve, kinezeve, indianëve etj.. Por ne mendojmë se një qytetërim nuk mund të reduktohet thjesht në aspektin material, teknologjik apo shkencor. Qytetërimi islam me këto kritere edhe mund të thuhet se tashmë është prapa. Por nëse kemi parasysh se të arriturat e myslimanëve kanë qenë si rezultat i një frymëzimi dhe i një etike, e cila ka përcaktuar normat e

jetesës dhe kuptimit të jetës, atëherë mund të themi se Islami vazhdon të jetë ndoshta i vetmi qytetërim i cili nuk e ka humbur esencën e vet. Në këtë perspektivë ne mendojmë se çështja e qytetërimit mbetet një temë me rëndësi.

Nëse analizojmë përdorimin e fjalës qytetërim në arabishtë “medenijet” dhe turqisht po ashtu “medeniyet” kjo fjalë është derivat i fjalës qytet “medine”. Nakib el Attas, ka dhënë një shpjegim interesant, ku fjala qytetërim, qytet dhe fe “din” kanë një lidhje organike. Kjo shpjegon se si qytetërimi islam është i ndërtuar dhe i lidhur ngushtë me parimet e fesë islame dhe vizionin që Islami shpalos rreth ekzistencës njerëzore.⁴ Ndërsa në gjuhën osmane, kjo fjalë ka depërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe kjo fjalë “medeniyet” është përkthyer si dashuri për drejtësi (*adaletsevirlilik*); të jetosh si njeri me bollëk (*insanca iyi ve ferah yaşayış*); Qytetari (*Şehirlik*); Gjendja e shoqërive që kanë evoluar në jetë, marrëdhënie shoqërore, teknike, shkencë dhe art (*Yaşayışta*,



ıçtimai münasebetlerde, ilim, fenn ve san'atta tekamul etmiş cemiyetlerin hali); Të jetosh në përputhje me urdhrat e Islamit (*İslamiyetin emirlerine göre, usulü dairesinde yaşayış*).⁵

Fjala qytetërim bëhet e komplikuar nëse nuk e trajtojmë në shumë përmasa. Si koncept bëhet problematik sidomos kur lidhet me ndonjë civilizim konkret, dhe ky koncept definohet sipas të arriturave të atij qytetërimi. Ne e hasim këtë problem me theks të veçantë me përdorimin e tij modern, ku do të flasim më vonë. Tani për tani do sjellim një përkufizim, i cili në parim na e lejon, por edhe e bën të domosdoshëm diskutimin për qytetërimin. Nga etimologjia e fjalës, ne mund të konstatojmë edhe qëndrimin e Kalënit, i cili thotë se: “Themeli i qytetërimin si nocion abstrakt dhe i përgjithshëm është qytetaria. Kur individit dhe shoqëria janë të qytetëruar, edhe rendi i ndërtuar prej tyre sjellë në jetë atë strukturë madhore që e quajmë qytetërim. Me fjalë të tjera, qytetërimi merr kuptim dhe bëhet i mundur vetëm kur individët dhe shoqëritë shfaqin qëndrime të qytetëruara, morale dhe njerëzore me gjërat që bëjnë, në marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe me universin.”⁶

Nëse qytetërimi do të kuptohej jashtë kriterëve morale apo qytetare, dhe atë do ta shihnim për nga të arriturat materiale, atëherë do të shohim se qytetërimet vazhdimisht mund të kenë edhe anën e tyre të errët: skllavërinë. Ky fenomen, krahas epidemive, ndotjes urbane etj., sipas historianëve ka qenë një karakteristikë e qytetërimeve të para.⁷ Por kjo

realisht është po kaq e vërtetë edhe për qytetërimin bashkëkohor. Skllavëria, luftërat, nuk janë anë të errëta që thjesht ndonjëherë dalin jashtë kontrollit, ato mund të jenë vetë prodhim i vizionit mbi botën që kanë lindur forma të tilla. P.sh. Zygmund Bauman, e ka konsideruar Holokaustin jo thjesht si “një pezullim i përkohshëm i kontrollit qytetëruar nga e cila zakonisht konsiderohet sjellje njerëzore”, por një “paradigmë” e qytetërimin modern” dhe modernitetit. Në librin e tij, *Modernity and the Holocaust*, ai ka bërë thirrje për të parë me kujdes atë që realisht po shihet si proces qytetëruar.⁸

Edhe intelektuali turk, İsmet Özel, madje e kundërshtoi tërësisht nocionin e qytetërimin dhe thotë se është një gabim ta shohim Islamit me këtë nocion. Kjo do ta reduktonte Islamit në idenë e kohës dhe historisë. Kur është fjala për myslimanët, ai më tepër i referohet kërkesës për një sistem islam me parime nga Kurani dhe Suneti. Ky reagim dhe mohim i këtij koncepti nga ai vjen si arsye se për të civilizimi nënkupton matje e pasurive materiale dhe një sistemim shoqëror që, në rastin e myslimanëve, i ka larguar nga parimet e Islamit. Ai shkruan: “Duke thënë “po” për një sistem jetësor islam, duke i thënë “jo” civilizimit, edhe nëse e ka atributin “islam” (nëse civilizimi ka zënë vend në një shtet islam i thonë civilizim islam, që është një sintagmë e gabuar), ua hapim rrugën shumë ideve që do të l’i qartësojnë temat që sot na e turbullojnë kokën. Sot është e nevojshme që të krijohet një lidhje ndërmjet shoqërisë së industrializuar dhe parimeve islame.”⁹

Özel ka një të konceptuar të qytetërimin ku kulmi i tij përfundon me norma dhe sjellje pallati, prandaj edhe thotë “kudo që ka civilizim atje ka jetë pallati, ka norma pallati që vlejë për shtresat që janë poshtë pallatit.”¹⁰ Çështja e qytetërimin për Özeli ka tri aspekte që duhen të kihen parasysh: tradita, logjika (lidhjet shkak-pasojë), perceptimi, që në rastin e myslimanëve janë normat e Islamit. Vetëm me kombinimin e këtyre tri elementeve, myslimanët kanë nxjerrë në pah civilizimin abasid me traditën arabe, atë andaluzian me traditën berbere, dhe atë osman me traditën e turqve. Prandaj, në analizën përfundimtare, ai nuk është për se kundër civilizimit, por mendon se duhet të kemi njohuri të sakta rreth karakteristikave që merr njeriu në shoqëritë e civilizuar si dhe rreth “cilësive” të rrugës së tij, pra civilizimit.

Nëse shohim konfliktet e popujve, e në veçanti efektet negative që ka pasur qytetërimi modern në natyrë, kuptohet se problemi nuk qëndron thjesht te proceset qytetëruar, por parimisht te kuadri filozofik që e ka projektuar këtë qytetërim. Prandaj qytetërimi nuk mund të transferohet ose ndryshohet thjesht duke ndryshuar strukturat sociale, edhe pse ndryshime të tilla nuk janë pa pasojë. Por, faktori themelor që e nxjerr në pah qytetërimin është vetëpërceptimi, apo botëkuptimi. Prandaj qytetërimet duhen hetuar edhe në sferën e tyre filozofike dhe perceptuese mbi qenien dhe

Nëse qytetërimi do të kuptohej jashtë kritereve morale apo qytetare, dhe atë do ta shihnim për nga të arriturat materiale, atëherë do të shohim se qytetërimet vazhdimisht mund të kenë edhe anën e tyre të errët: skllavërinë.

botën. Ahmet Davutogllu, në veprën të titulluar “*Vetëpërceptimi i qytetërimëve*” e ka shprehur shumë mirë këtë. Ai thotë: “Faktori final që mundëson formimin e vetëpërceptimit nuk është fusha institucionale dhe formale (zyrtare) por botëkuptimi (gjerm. *weltanschauung*, ang. *worldview*), i cili çështjen e ekzistencës së njeriut e vendos në një kornizë kuptimplote. Për këtë arsye, edhe pse transferet institucionale dhe zyrtare nga qytetërimet e tjera mund të shkaktojnë ndryshime të jashtme, pa formimin e një vetëpërceptimi të ri dhe pa fitimin fuqi dhe mundësi influence të këtij vetëpërceptimi në qytetërimin e marrë për shembull, shkatërrimi i shpirtit të qytetërimin i cili synohet të ndryshohet është i pamundshëm.”¹¹

Me çështjen e qytetërimin janë marrë historianët,

antropologët e sociologët. Nga materialet dhe studi-met e tyre mund të gjenden tri karakteristika të përba-shkëta të qytetërimin:

1. Shteti i organizuar me kufijtë të caktuara;
2. Lindja e klasave shoqërore;
3. Përdorimi i shkrimit, lindja e arteve të bukura dhe veprave ideore.

Këto karakteristika janë të gjithave atyre kulturave që ne i quajmë edhe qytetërimet. Por, një çështje që parashtrohet para nesh është: pse janë kaq të ndryshme organizimi i shoqërive, pse kemi struktura të ndryshme nëpër klasa, arte të ndryshme, ide të ndryshme etj. Këto pyetje, siç thotë edhe profesor Ozakpënar, nuk na e bëjnë të qartë përgjigjen e pyetjes rreth lindjes së qytetërimëve. Me një gjuhë më teologjike, për dallim nga Davutogllu, Ozakpënar, përfundon se “është një themel besimi dhe morali që qëndron në themelin e strukturës shoqërore”.¹² Pra, qytetërimet janë të ndryshme sepse në themel të tyre kanë besime të ndryshme. Besimi i cili përfaqëson një projektion intelektual, edhe

veprat e shoqërive kryhen sipas logjikës racionale të atij besimi. Kur shoqëritë e zgjedhin dhe kanë të qartë besimin të cilin e kanë pranuar, atëherë tek ata lind nevoja për një organizim konform parimeve të besimit dhe logjikës së moralit të po atij besimi. Nëse në një shoqëri gjejmë një sistem besimi, kjo do të thotë se në atë shoqëri ka (duhet të ketë) një “qytetërim”. Sjellja dhe krijimtaritë njerëzore në përputhje me vlerat e kësaj strukture besimi prodhojnë “kulturë”. Kështu, “veprat e kulturës”, përfundon Ozakpënar, “nga njëra anë plotësojnë nevojat jetësore, kurse nga ana tjetër reflektojnë sistemin e besimit dhe moralit të qytetërimin ku kanë lindur.”¹³

Edhe tronditja apo shembja e qytetërimëve, siç e cituam edhe te Davutogllu, vjen si pasojë kur shembet ose nuk ekziston një kornizë e vetëdijshme ose racionale për vetën dhe botën. Ose siç thotë Ozakpënar, kur shoqëria bëhet skeptike ndaj qytetërimin të vet, atëherë ai qytetërim humb efektin e vet. Atëherë shoqëritë mbeten pa kritere të qarta rreth pranimeve dhe refuzimeve të elementeve kulturore. Sa më i sqaruar dhe racional të jetë një sistem besimi, po aq ky sistem besimi premtion të lind shpirtin e një qytetërimi specifik.

Duke parë se Islami e ka ruajtur esencën e vet të besimit, nga myslimanët pritet një ri mendim dhe vizion për pozitën dhe botën tonë përreth, për të gjetur një kuptim dhe rend në kushtet aktuale. Në një detyrë të tillë për të menduar tërë sistemin e vlerave të Islamit, Ikbali, do të shkruante se, myslimanët bashkëkohorë nuk duhet të shpëputen nga e kaluara e tyre.¹⁴ Duke synuar kështu që nga e kaluara të mësojmë realizimin e vlerave të Islamit, ndërsa me parimet e pandryshuara të besimit shpresojmë dhe synojmë për një qytetërim të ri.

1 Ibën Haldun, *Mukaddime /Një hyrje në historinë botërore*, v. I (Shkup: Logos-A, 2016), 57-59.

2 Muhamed Ikbali, *Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam*, (Shkup: Logos-A, 2006), 23-24.

3 Universal në kuptimin që asnjë shoqëri nuk mund të mbijetojë pa një organizim social (*umran*). Shih Ibën Haldun, *po aty*, 145-48

4 Sejjid Muhamed Nakib el-Attas, *Hyrje në metafizikën e Islamit*, (Shkup: Logos-A, 2011), 67-68.

5 Abdullah Yeğün&Abdulkadir Badilli& Hekimoğlu İsmail& Çalım İlham, *Osmanlıca-Türkçe Ansiklopedik Büyük Lugat* (İstanbul: Türdav, 2000), 592.

6 Ibrahim Kalın, *barbarë, modernë, të qytetëruar/shënime mbi qytetërimin* (Shkup: Logos-A, 2020), 42.

7 Marvin Perry, *Western Civilization/A brief History*, bot. 7 (Boston: Wadsworth, 2011), 8.

8 Bauman Zygmunt, *Modernity and the Holocaust* (Polity Press, 1989), 29.

9 Ismet Özel, *Tri çështjet/ teknika-civilizimi-tëhuajësimi*, (Shkup: Logos-A, 2009),105.

10 Po aty, 110-111.

11 Ahmet Davutogllu, *Vetpërceptimi i qytetërimëve*, (Shkup: Logos-A, 2002), 27-28.

12 Jëllmaz Ozakpënar, *Kultura dhe qytetërimi/Një teori mbi qytetërimin*, (Shkup: Logos-A, 2003), 58.

13 Po aty, 60.

14 Muhamed Ikbali, *Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam*, 129.

Kumtesë me rastin e shenimit të 30-të vjetorit të themelimit të FSI-së

“FSI, institucioni më i vjetër i arsimit të lartë islam në trojet shqiptare”

*I nderuari Myfti i Kosovës, Naim ef. Tërnavë,
E nderuara ministre për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion, znj. Arbërie Nagavci,
Të nderuar udhëheqës e drejtues të BIK-ut,
I nderuari drejtor i Institutit Albanologjik,
I nderuari dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup,
Të nderuar drejtues e udhëheqës të këshillave të BI-së,
Të nderuar veteranë të arsimit, pedagogë e studentë të FSI-së,
Të nderuar motra e vëllezër,
Të nderuar të pranishëm!*

Kam nderin që në emër të Fakultetit të Studimeve Islame, dekanatit, pedagogëve e studentëve të tij, t’ju falënderoj e t’ju përshëndes me mirëseardhje në shënimin e 30-vjetorit të themelimit të Fakultetit të Studimeve në Prishtinë.

Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës është institucioni më i vjetër i arsimit të lartë në të gjitha trojet shqiptare, ku mësimi organizohet në gjuhën shqipe. Po ashtu, FSI është institucioni i parë i arsimit të lartë që themelohet jashtë ombrellës së Universitetit të Prishtinës.

Koha dhe rrethanat në të cilat është themeluar FSI kanë qenë jashtëzakonisht të vështira për popullin dhe vendin tonë, e rrjedhimisht edhe për Bashkësinë Islame të Kosovës. Në atë kohë, sikurse dihet, pas rënies së perdes së hekurt të komunizmit, në vend se të shijonim frytet e demokracisë, fatkeqësisht u përballëm me një riokupim klasik nga ana e Serbisë, e cila kishte nxjerrë nxënësit, studentët e pedagogët shqiptarë nga institucionet shkollore e universitare.

Mirëpo, me gjithë dhunën dhe represion e pushtetit serb mbi shqiptarët, e posaçërisht mbi arsimin shqip, populli ynë, institucionet tona nuk u dorëzuan para pushtuesit, andaj dhe organizuan sistemin e pavarur të arsimit e edukimit shqip, duke vënë në dispozicion të kësaj kauze potencialin moral, intelektual e material.

Ky organizim përveç që ishte një sakrificë e madhe, më tepër ishte një vetëdije, një përcaktim i qartë e i vendosur i popullit, udhëheqjes e intelektualëve tanë për dinjitet, liri e mëvetësi. Si pjesë e kësaj kauze e në këto rrethana, edhe Bashkësia Islame e Kosovës, që asokohe udhëhiqej nga myftiu dr. Rexhep Boja, mori nismën për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame, në të cilin institucion mësimi do të organizohej në gjuhën shqipe.

Kësisoj, pasi ndërmorën veprimet për përgatitjen e infrastrukturës ligjore nga institucionet vendimmarrëse të Bashkësisë Islame të Kosovës, tri dekada më parë, në ish-ndërtesën e konviktit të Medresesë “Alaudin”, e cila asokohe u adaptua për të ofruar kushte solide për punë, ditën e enjte, më 10 dhjetor 1992, nisi punën Fakulteti i Studimeve Islame, duke u bërë institucioni i parë islam për arsimin e lartë në gjuhën shqipe në trojet shqiptare.

Në këtë ditë, jo rastësisht dhe jo pa një domethënie, ligjëratën e parë me studentët e gjeneratës së parë e mbajti myderrizi e veterani i arsimit shqip, përkthyesi e komentuesi i Kuranit, themeluesi i periodikut e i literaturës islame në gjuhën shqipe, haxhi Sherif ef. Ahmeti, i cili megjithëqë në moshë të shtyrë, ftesës prej udhëheqësve të FSI-së iu përgjigj pa asnjë hamendje, dhe për dy vite akademike ligjëroi lëndën e Akaidit - apolejetikës, dhe jo vetëm kaq, për më tepër, ai si veteran i arsimit, si themelues i literaturës islame në gjuhën shqipe, për nevojat e studentëve përgatiti edhe dispensat për lëndën që ligjëronte, duke i lënë kështu FSI-së një trashëgimi të veçantë dhe shumë domethënëse e me vlerë.

Të nderuar të pranishëm!

Nismëtari për themelimin e FSI-së, myftiu i atëhershëm i Kosovës, dr. Rexhep Boja, u emërua edhe dekan i Fakultetit nga Kryesia e BI-së së Kosovës, meqë edhe asokohe ishte i vetmi me përgatitjen e duhur akademike, doktor i shkencave islame.



Doktor Boja që në zanafillë të nismës për themelimin e FSI-së afër vetes afroi kuadrot e pakta që kishte në radhët e BI-së, siç ishte prof. Qemajl Morina, që u emërua prodekan, pastaj në procesin mësimorë përveç haxhi Sherif ef. Ahmetit, u angazhuan profesorët me përvojë disavjeçare akademike, prof. Qazim Qazimi, prof. Resul Rexhepi, prof. Sulejman Osmani, etj., të cilët morën përsipër barrën e ligjërimit për lëndët e shkencave islame, ndërsa për lëndët e profileve të përgjithshme, dekanati kishte angazhuar profesorët më të shquar të Universitetit të Prishtinës, por jo vetëm kaq, udhëheqja e BI-së së Kosovës, që në zanafillë, kishte kontaktuar e ishte këshilluar me njohësit e arsimit e figurat e shquara të UP-së, si akademik Pajazit Nushin, rektorin e atëhershëm të UP-së, prof. dr. Ejup Statovcin, profesor Isa Bajçincën, prof. Ismail Ahmedin etj., të cilët pasi mbështeten nismën, u bënë edhe pjesë e Këshillit për themelimin e FSI-së, duke dhënë një kontribut të çmuar për përgatitjen e planprogrameve dhe strategjisë së funksionalizimit të Fakultetit.

Të nderuar të pranishëm! Ju të çmuar studentë të sotëm, e posaçërisht ju studentë e pedagogë të brezit të parë!

Më lejoni që të vë në pah edhe një fakt, vetë ideja për themelin e FSI-së ishte sukses në vete, ndërsa bërja realitet e kësaj ideje në dhjetorin e vitit 1992, ishte një ndër arritjet më të mëdha të Bashkësisë Islame të Kosovës, kjo për faktin se përveç që realizuan një ide e një projekt të kamotshëm, themeluan FSI-në, ku do të studiohej për **din e iman** në vendin tonë dhe ku do t'u mundësohet studentëve tanë që të ndjekin studimet në vendin e tyre, në gjuhën e tyre dhe duke e bërë kështu Prishtinën qendër, ku do të studiohen shkencat islame.

Me gjithë sfidat e vështirësitë e kohës e që nuk ishin të pakta, FSI, këtu e tri dekada më parë hapi horizonte, krijoi kushte e premisa për bijtë e bijat tona që të marrin njohuritë e duhura për mësimet islame.

Këtu duhet thënë se, studentët e FSI-së, jo vetëm që treguan suksese në studimet e tyre, por ata, që në brezin e parë arritën të vënë bazat e një sërë nismash e aktiviteteve, në këtë rrafsh duhet veçuar nxjerrjen e revistës së studentëve “Zgjimi Islam” më 1996, pastaj bashkëveprimin e bashkëpunimin me Unionin e Pavarur të Studentëve të UP-së në protestat e tetorit të vitit 1998 e kështu me radhë.

Të nderuar të pranishëm!

Fakulteti i Studimeve Islame, falë angazhimit, përkushtimit e kontributit të palodhur të drejtuesve e pedagogëve e mbi të gjitha të studentëve, katër vite pas themelimit, nxori edhe të diplomuarin e parë, gjë që tregon qartë për suksesin e Fakultetit dhe nevojën për të.

Sot, Fakulteti i Studimeve Islame është institucion i konsoliduar, të diplomuarit në FSI tashmë janë bartës e udhëheqës në institucionet e BIK-ut, duke filluar nga misioni i nderuar i imamit, udhëheqës e drejtues të këshillave të BI-së, bartës e drejtues të forumeve e institucioneve të tjera të BI-së dhe jo vetëm kaq, kuadrot e dala nga FSI, i gjejmë edhe në institucionet shkencore, kulturore e publike në Kosovë dhe vise të tjera shqiptare. Madje të diplomuarit në FSI sot janë pjesë e këtij institucioni qoftë si pedagogë, drejtues e administratorë.

Të nderuar të pranishëm!

Ky përvjetori i 30-të, Fakultetin tonë e gjen me 567 të diplomuar në nivelin themelor, ndërsa një arritje tjetër e FSI-së, s'ka dyshim, se është organizimi i programit në nivelin master në Shkencat Islame, ku gjithashtu janë shënuar arritje të lakmueshme dhe është bërë një punë e vyeshëm në këtë rrafsh, duke diplomuar 32 studentë.

Natyrish gjatë këto suksese, janë rezultat i angazhimit dhe punës së pamohueshme të paraardhësve tanë në krye të FSI-së, të cilët në bazë të kompetencave, kushteve e rrethanave, arritën që të përmbushin kërkesat e nevojshme për akreditimin e programeve të FSI-së, si në nivelin themelor ashtu edhe në atë master. Në këtë drejtim, FSI ka pasur gjithnjë edhe ndihmën, përkrahjen dhe mirëkuptimin e Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve kompetente të saj, për se ne u jemi mirënjohës publikisht. Po ashtu, një e arritur tjetër që duhet vënë në pah është edhe nxjerrja e revistës së Fakultetit “Buletinit”, ku pedagogët e FSI-së botojnë kontributet e tyre nga fushat e shkencave e disiplinave fetare me kritere shkencore e akademike.

Në zanafillën e tij, 30 vjet më parë, studentët e FSI-së janë përballur me mungesë të teksteve të nevojshme, sidomos për lëndët e fushave islame dhe kjo është e kuptueshme, por tani



mund të themi se falë punës së pedagogëve, kjo pengesë është tejkaluar dhe pothuajse për të gjitha lëndët profesionale janë përgatitur tekstet e nevojshme dhe kjo padyshim shënon një sukses tjetër të Fakultetit tonë.

Fakulteti i Studimeve Islame sot është partner me disa fakultete islame dhe të shkencave humane të vendeve të ndryshme, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje e memorandume bashkëpunimi, si dhe është pjesë e programit ERASMUS Plus, përmes së cilës synon të bashkëpunojë me një sërë institucionesh akademike nga vendet e ndryshme nga rajoni e Evropa.

Po ashtu, ky përvjetor, FSI-në e gjen me infrastrukturë bashkëkohore, me godinën e re që ofron kushte komode për studim, me të gjitha ambientet e nevojshëm, që nga sallat për mësim, kabinetet, biblioteka e pasur, e deri tek amfiteatri.

Vëllezër e motra!

Sot, kur po shënojmë 30-vjetorin e themelimit të FSI-së, i paraqita në formë të përmbledhur vetëm disa nga arritjet që ka shënuar Fakulteti ynë, arritje këto sa na bëjnë krenarë aq edhe na obligojnë, ngase arritjet e deritashme janë rezultat i vizionit të nismëtarëve të FSI-së, janë rezultat i punës, angazhimit e kontributit të pedagogëve, të cilët nuk kursyen asgjë nga vetja që të jemi sot këtu ku jemi. Po ashtu, në këtë mision, këto arritje, Fakulteti ynë nuk do të mund t'i arrinte pa mbështetjen, përkrahjen dhe ndihmën e pakursyer të Kryesisë së BI-së, e cila është themeluese dhe financuese e FSI-së. Kryesia e BI-së si gjatë udhëheqjes së ish-myftiut dr. Rexhep Boja, po ashtu edhe gjatë udhëheqjes së myftiut aktual Naim ef. Tërnavës, i cili po ashtu ishte pedagog shumëvjeçar në Fakultet, kanë mbështetur pa rezervë rritën, zhvillimin dhe avancimin e FSI-së.

Kjo ka bërë, që në këtë përvjetor, FSI, të ketë një staf akademik të kompletuar e kompetentë, mbi bazën e të cilit mund të mbështetemi e të projektojmë pasurimin e fakultetit me programe të reja që janë të nevojshme për vendin tonë, si në nivelin themelor, po ashtu edhe në atë master. Për këtë, kemi një plan të cilin në bashkëpunim me fakultetet partnere nga vendet e ndryshme së shpejti do ta vëmë në zbatim. Po

ashtu jemi në kërkim të modaliteteve dhe mundësive për realizimin e studimeve të doktoratës dhe kjo mbetet një nga objektivat kryesore të FSI-së.

Krejt në fund, të nderuar të pranishëm, me lejoni që të them se Fakulteti i Studimeve Islame, është vazhdimësi e institucioneve të hershme të arsimit islam ndër ne, që nga mejtepet e medresetë, të cilat kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në arsimimin, edukimin dhe studimin e fesë islame ndër ne, sikundër që FSI është konkretizim i vizionit dhe përpjekjeve të ulemave shqiptare përgjatë brezave, ndaj dhe ne, ndihemi të lumtur dhe me fat që jemi pjesë e këtij vizioni në shërbim të arsimitit e edukimit të brezit të ri.

Fakulteti i Studimeve Islame sot ka krijuar identitetin e tij prej një institucioni kredibil të arsimit të lartë, ku studiohet besimi ynë, ku ruhet doktrina, ku kultivohen mësimet e studimet që përgatisin prijës shpirtërorë për popullin tonë, ku përgatitën edukuesit e fëmijëve tanë, udhëheqësit e institucioneve tona, si dhe udhëzuesit tonë për besim, paqe, harmoni e respekt të ndërsjellë.

Të nderuar pjesëmarrës!

Duke ju falënderuar edhe një herë për praninë dhe durimin tuaj, më lejoni që të shpreh përkushtimin tonë të palëkundur që përvjetorët e ardhshëm ta gjejnë FSI-në me rezultate e arritje që i pret themeluesi, besimtarët dhe populli ynë.

Në fund, më lejoni edhe një herë që të shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata që kanë kontribuar në themelimin, rritën dhe zhvillim e Fakultetit të Studimeve Islame përgjatë këtyre tri dekadave.

Zoti i shpërbleftë që të gjithë!

Ju falënderoj për durimin!

Prishtinë, më 27 dhjetor 2022

Dr. Islam Hasani

Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame

MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E SELISË SË KËSHILLIT TË BI-SË DHE DY VAKËFEVE NË KOMUNËN E GJILANIT

Më 31 dhjetor 2022 dhe më 12 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, pa nga afër ndërtimin e dy vakëfeve në Gjilan, selinë e Këshillit në qendër të qytetit, si dhe xhaminë në fshatin Pasjak. Myftiu Tërnavë u njoh për së afërmi me ecurinë e punimeve në ndërtimin e këtyre objekteve, duke shprehur kështu kënaqësinë e tij me zhvillimin e deritanishëm të punimeve. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës ka qenë, është dhe do të mbetet e përkushtuar për krijimin e kushteve sa më të mira infrastrukturore për besimtarët myslimanë të vendit.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA UNIONI I QENDRAVE ISLAME SHQIPTARE NGA GJERMANIA

Më 9 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Unionit të Qendrave Islame Shqiptare, njëherësh imamin e xhamisë në Duseldorf-Gjermani, Mensur ef. Halili, sekretarin i U.Q.I.SH., Salahudin ef. Ibra, Kamber Arjuli, arkëtar, Bedri Sylaj, imam në xhaminë Ebu Hanifë në Troisdorf. Myftiu Tërnavë falënderoi mysafirët për vizitën dhe nëpërmes tyre tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre

dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje, e në veçanti në Gjermani. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje në realizimin e projekteve të përbashkëta.

Nga ana e tij, z. Mensur ef. Halili, u shpreh tejet falënderues për mikpritjen dhe për angazhimin e Myftiut Tërnavë

dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës për ruajtjen e komunikimit e bashkëpunimit me shqiptarët e diasporës. Të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi dhe komunikimi duhet të vazhdohet edhe më tej në të mirë të popullit tonë. Për kontributin që kanë dhënë në emër të restaurimit të Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, Myftiu Tërnavë në shenjë mirënjohje u dorëzoi një “Mirënjohje - Falënderim” Unionit të Qendrave Islame Shqiptare nga Gjermania.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFEN E UNMIK-UT, ZNJ. CAROLINE ZIADEH

Më 13 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesen speciale të sekretarit të përgjithshëm, njëherësh shefen e UNMIK-ut, znj. Caroline Ziadeh. Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi mirëseardhje znj. Ziadeh në institucionin e BIK-ut, e më pas e njohu me zhvillimet dhe funksionimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion. Myftiu Tërnavë vlerësoi lart bashkëpunimin shumë të mirë që kanë pasur deri tani me UNMIK-un, si dhe shprehu gatishmërinë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkaq, znj. Ziadeh, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për



punën që ai dhe institucioni i BIK-ut po bëjnë për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Ajo vlerësoi lart rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kultivimin e

dialogut ndërfetar e ndëretnik, si dhe për promovimin e vlerave të tolerancës dhe të bashkëjetesës në Kosovë. (R.S.)

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS AMBASADORIN E TURQISË, Z. CAGRI SAKAR

Më 13 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim lamtumirës ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Cagri Sakar. Myftiu Tërnavë shprehu falënderime për bashkëpunimin e sinqertë që kanë pasur deri më tani me Ambasadën Turke, duke vlerësuar se bashkëpunimi ndërmjet tyre do të vazhdojë edhe në të

ardhmen. Myftiu Tërnavë falënderoi ambasadorin Sakar për ndihmën dhe mbështetjen që ka dhënë gjatë kësaj kohe si ambasador i Turqisë në Kosovë, duke i dëshiruar suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e reja që e presin.

Ambasadori Sakar, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe bashkëpunimin shumë të mirë që kanë pasur deri më tani. Ai po ashtu vlerësoi

lart kontributin dhe rolin e Bashkësisë Islame që ka pasur në këtë kohë të vështirë pandemie, duke i dalë në ndihmë besimtarëve dhe qytetarëve në nevojë përmes Shoqatës Humanitare "Bereqeti". Gjatë takimit, të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi duhet të thellohet edhe më shumë ndërmjet dy vendeve, në veçanti në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. (R.S.)



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË VITISË

Më 12 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Vitisë, në të cilin u prit nga kryetari i këtij Këshilli, Husamedin ef. Hoxha. Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin dhe nëpunësit fetarë për kontributin dhe përkushtimin e tyre dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në Viti. Ai premtoi përkrahjen e vazhdueshme të Kryesisë dhënë për këshillat e BI-së në tërë Kosovën. Kryetari Hoxha e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Këshillin e Vitisë. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për arritjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky Këshill, si dhe për tema të tjera me rëndësi për Këshillin e Vitisë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR NË ZVICËR



Më 16 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga Zvicra, në përbërje nga Mehas Alija, kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, Fehim Abazi, nënkryetar, Besim Nuzi, nënkryetar, Ismail Ademi, sekretar, Sherif Tupani anëtar, si dhe Jasmin Demiç, kryetar i Komunitetit Mysliman të Boshnjakëve në Zvicër. Myftiu Tërnavë iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i falënderoi ata për vizitën dhe nëpërmes tyre tërë mërgatën

tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje, e në veçanti në Zvicër. Myftiu Tërnavë shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje në realizimin e projekteve të përbashkëta. Nga ana e tij, kryetari Mehas ef. Alija, u shpreh tejet falënderues për mikpritjen dhe për

angazhimin e Myftiut Tërnavë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës për ruajtjen e komunikimit e bashkëpunimit me shqiptarët e diasporës. Në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në emër të restaurimit të Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, Myftiu Tërnavë ua dorëzoi një “Mirënjohje - Falënderim” për Komunitetin Mysliman Shqiptar në Zvicër. Më pas, delegacioni pa nga afër ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, si dhe vizituan Medresenë “Alauddin” në Prishtinë. (R.S.)

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYEMINISTRIN E KOSOVËS, Z. ALBIN KURTI



Më 23 janar 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur sot në takim kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti. Myftiu Tërnavë në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, falënderoi kryeministrin Kurti për vizitën, me të cilin më pas diskutuan për gjendjen aktuale në të cilën gjendet vendi ynë, si dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur

deri më tani. Ai më pas theksoi se Bashkësia Islame e Kosovës edhe më tej do të jetë e përkushtuar që në Kosovë të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërfaqetare për të gjitha komunitetet që jetojnë këtu. Nga ana e tij, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, falënderoi Myftiun Tërnavë dhe gjithë Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e tyre dhënë për të mirën e përgjithshme të qytetarëve tanë, e në

veçanti për frymën e tolerancës dhe harmonisë fetare që mbretëron në Kosovë. Ai tha se, falë angazhimit të përgjithshëm, Kosova është një vend, ku komunitetet jetojnë në paqe, harmoni e bashkëjetesë. Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për Projektligjin për Liritë Fetare, për të cilin kryeministri Kurti falënderoi Myftiun Tërnavë për angazhimin dhe bashkëpunimin rreth këtij Projektligji. (R.S.)

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SAMITIN E LIDERËVE FETARË MYSLIMANË NË BOTË

Më 25 janar 2023, kryetari i BIK-ut, Myftiu Tërnavë, mori pjesë në Samitin online të liderëve fetarë myslimanë në botë, i organizuar nga Dijaneti i Turqisë, e që për temë kishte sulmet që kishin në shënjestër Kuranin, të cilat ndodhen në Suedi dhe në Holandë. Në këtë Samit u theksua se, derisa bota islame me padurim po e pret muajin e bekuar Ramazan, në të cilin është zbritur Kurani, kemi parë nivelin e frikshëm nga individë ekstremist armiqësor ndaj Islamit, të cilët kanë bërë djegien e Kuranit dhe me këtë kryer një akt provokimi, por edhe urrejtje që për synim ka jo tolerancën, mbjelljen e urrejtjes, dhe jo harmonisë ndërfaqetare. Në këtë Samit u vlerësua se këto veprime janë të ulëta dhe fyen vlerat tona të shenjta dhe përmbajnë krim të urrejtjes, janë një shpallje e hapur se



islamofobia, diskriminimi dhe ksenofobia nuk njohin më kufij.

Duhet theksuar se politikani danezo-suedez i ekstremit të djathtë, Rasmus Paludan, dogji një kopje të Kuranit gjatë

një proteste më 21 janar para Ambasadës Turke në Stokholm, dhe ky akt nxiti valën e reagimit në botën islame. Po ashtu u gjykua edhe grisja e kopjes së Kuranit të madhëruar në Holandë para syve të forcave të rendit.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I MITROVICËS Z. BEDRI HAMZA



Më 26 janar 2023 Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe kryeimami Vedat ef. Sahiti, vizituan Mitrovicën, me ç'rast u pritën në takim nga kryetari i Komunës, z. Bedri Hamza. Myftiu Tërnavë u njoh nga i pari i Mitrovicës për gjendjen e krijuar pas vërshimeve të shiut, për dëmet e shkaktuara te banorët, xhamitë dhe

objektet përcjellëse. Kryetari Hamza falënderoi Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e dhënë në kultivimin e vlerave të larta të solidaritetit dhe paqes, e në veçanti për angazhimin që ka treguar Shoqata “Bereqetit” për të ndihmuar të prekurit nga vërshimet. Myftiu Tërnavë tha se BIK-u do të vazhdojë angazhimin në kultivimin e

solidaritetit, teksa një thirrje për solidaritet do të bëhet nesër në të gjitha xhamitë e Kosovës për të prekurit nga vërshimet. Myftiu Tërnavë dhe kryeimami Sahiti, së bashku me kryetarin e Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Enis ef. Rama, vizituan xhaminë “Bajram Pasha Isa Beg”, e cila pësoi dëme të konsideruara nga vërshimet.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS



Më 18 janar 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Në këtë mbledhje të Kryesisë u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës. Veç të tjerash u diskutua edhe për përgatitjen për të mirëpritur

muajin Ramazan, i cili do të fillojë që nga 23 marsi.

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, shpалosi para anëtarëve të Kryesisë disa prej aktiviteteve për muajin Ramazan, duke përfshirë aktivitete për të gjitha grupmoshat, si

dhe përgatitjet speciale mediatike. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për organizimin e Haxhit për këtë vit kalendarik, si dhe u shqyrtuan lëndë të tjera në bazë të kompetencave të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

KRYEIMAMI SAHITI QENDROI PËR VIZITË ZYRTARE NË XHIDE TË ARABISË SAUDITE

Me ftesë të Ministrisë së Haxhit dhe Umres, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe zëvendëskryeimami Fatmir ef. Iljazi, qëndruan për vizitë zyrtare në Xhide të Arabisë Saudite, ku morën pjesë në Konferencën dhe Ekspozitën e Shërbimeve të Haxhit dhe Umres “Expo Hajj”, pjesëmarrës të së cilës ishin delegacionet shtetërore nga më shumë se 60 vende të botës. Kryeimami Sahiti gjatë pjesëmarrjes së tij në Konferencë, pati rastin të takohet me akterë të rëndësishëm të institucioneve

përgjegjëse për organizimin e haxhit, me ç’rast i diskutoi çështjet që kanë të bëjnë me lehtësimin e organizimit të haxhit për këtë vit, si dhe ofrimin e kushteve sa më komode për haxhitë e Kosovës. Po ashtu, gjatë kësaj Ekspozite, kryeimami Sahiti, pati rastin të takohet edhe me zëvendësministrin e Ministrisë së Haxhit dhe Umres, z. Abdulettah Meshat. Ky është edicioni i dytë i Konferencës dhe Ekspozitës së Shërbimeve të Haxhit dhe Umres, që po

mbahet nën patronazhin e princit të Mekës, Halid el Fejsal.

Më 11 janar 2023, kryeimami Sahiti, takoi ministrin e Haxhit e Umres, dr. Tevfik Rebiah, të cilin e falënderoi për ftesën që edhe Kosova të jetë pjesë e kësaj ngjarje të madhe.

Kryeimami Sahiti nënshkroi edhe marrëveshjet me institucionet dhe autoritetet saudiane që kanë të bëjnë me lehtësimin e organizimit të haxhit për këtë vit, si dhe ofrimin e kushteve sa më komode për haxhitë e Kosovës.



KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM Z. ABDULHADI KRASNIQ

Më 17 janar 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim kryetarin e komunës së Mamushës, z. Abdulhadi Krasniq, të cilit fillimisht i shprehu mirëseardhje dhe e falënderoi për ndihmën dhe bashkëpunimin që ka ofruar komuna e Mamushës në realizimin e projektit të revitalizimit të

oborrit të xhamisë, restaurimit të sahat kullës dhe ndërtimit të qendrës islame në Mamushë. Kryetari i komunës, z. Krasniq, falënderoi kryeimamin për mikpritjen, si dhe e përgëzoi Bashkësinë Islame për kontributin e saj në ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame në vendin tonë. Gjatë këtij takimi u diskutua, dhe ranë dakord në parim, që

edhe komuna e Mamushës të mbulojë shpenzimet e varrimit për të vdekurit, sikur që këtë e bëjnë edhe komuna të tjera. Kryetari Krasniq në këtë takim shoqërohej nga zv.kryetari i komunës, Hacı Mazrek, imami i Mamushës, Rushdi Shala dhe muteveliu, haxhi Adil Mazrek, një bamirës dhe donator i njohur i Medresesë “Alauddin”.



KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM DR. VISARE MUJKO – NIMANI

Më 24 janar 2023, kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim dr. Visare Mujko – Nimani, drejtoreshë e Zyrës së UNFPA-së për Kosovë. Kryeimami Sahiti e falënderoi mysafiren për vizitën dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy institucioneve përgjatë viteve në projekte të rëndësishme për shoqërinë tonë, sidomos për organizimin e tryezave, që për temë boshte kishin luftimin e dhunës familjare, dhunës mbi baza gjinore, trashëgiminë etj.

Në anën tjetër, dr. Visare Mujko - Nimani, falënderoi kryeimamin për mikpritjen dhe vlerësoi lart bashkëpunimin ndërinstytucional ndërmjet Bashkësisë Islame dhe UNFPA-së, duke çmuar rolin e BIK-ut në vetëdijesimin dhe parandalimin e dhunës në përgjithësi, e në veçanti të asaj mbi baza gjinore, dhe theksoi gatishmërinë e UNFPA-së



për të vazhduar edhe në të ardhmen me projekte të përbashkëta në këtë drejtim.

DREJTORI SIMINCA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E XHAMISË “UNITETI” NË LUZERN, Z. MUHAMET BOJNIKUN

Me 19 janar 2023 Drejtori Siminca, priti në takim nënkryetarin e xhamisë “Uniteti” në Luzern të Zvicrës, z. Muhamet Bojniku, i cili shoqërohej nga anëtari i xhamisë, z. Nasim Sopi.

Drejtori Siminca falënderoi z. Bojnikun dhe mërgatën tonë që gjendet në diasporë për kontributin dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje, si dhe shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të BIK-ut që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Ndërkaq, z. Bojniku e falënderoi drejtorin Siminca për pritjen dhe për gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të



Kosovës që të kenë një bashkëpunim të mirëfilltë me qendrat shqiptare në diasporë.

XHAMIA “HËNA E RE” SHËNOI 30 VJETORIN E THEMELIMIT



Më 28 janar 2023, në prani të një numri të madh të publikut vendor dhe mysafirëve, dhe me një program të larmishëm , Xhamia “ Hëna e re “ në Kruezlingen të Zvicrës , ka shënuar

30-vjetorin e veprimtarisë së saj, ku pjesë e manifestimit ishte edhe drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Mr. Ekrem ef. Siminca. Imami i xhamisë “ Hëna e re “ në Kruezlingen,

z. Rejhan ef. Neziri, dhe kryetari i xhamisë z. Besir Halili, iu uruan mirëseardhje të gjithë të pranishmëve, Drejtori Simnica, mbajti edhe një fjalë rasti. “Kam nderin dhe kënaqësinë që sot, në emër të BIK-ut, në emër të organeve dhe institucioneve të saj, në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë, t’ju drejtohem me një urim e falënderim të veçantë në gëzimin tuaj në këtë manifestim të rëndësishëm me rastin e shënimit të 30 vjetorit të xhamisë “Hëna e re” në Kruezlingen, dhe 20 vjetorin e punës dhe aktivitetit të imamit të pa

VIZITA NË XHAMINË “MESXHIDI-NUR”

Më 29 janar 2023, drejtori për Diasporë i BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, vizitoi xhaminë “Mesxhidi-Nur” në Fraunfeld të Zvicrës, ku u prit nga imami i emëruar kohën e fundit, Fesal ef. Fetahu, kryetari i Qendrës, Ilam Mustafi dhe xhematë të shumtë. Drejtori Simnica, mbajti një ligjëratë pas namazit të drekës, nga ku uroi dhe përgëzoi kryesinë, imamin dhe xhematin e kësaj xhamie për aktivitetet në këtë objekt të bukur. Ai falënderoj për bashkëpunimin, ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm që po bëni për vendlindjen dhe për institucionet tona fetare-arsimore, Medresenë “Alauddin” dhe Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.”

Po atë ditë, për namaz të akshamit u vizitua xhamia “Höri”, në Cyrih, ku u prit nga imami Bilall Tahiri, kryetari i xhamisë, Burim Shaqiri dhe disa anëtarë të xhamisë, të cilët kishin

U PROMOVUA “TAKVIMI” NË GJUHËN BOSHNJAKE - VJETARI PËR TË GJITHA BREZAT

Më 28 dhjetor 2022, në amfiteatrin e Medresesë “Alauddin” – paralelja në Prizren, u mbajt promovimi i botimit të sivjetmë të “Takvimit” në gjuhën boshnjake në Kosovë. Moderator, njëkohësisht redaktor i “Takvimit” në gjuhën boshnjake, ishte mr. Elmira Karadzi, ndërsa pjesëmarrës ishin: prof. Ahmet Sadriu, sekretar i përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe kryeredaktor i “Takvimit”, mr. Ramadan Shkodra, drejtor për Shtyp dhe Veprimtari Botuese në BIK; dr. Sadik Idrizi; dr. Raim Bajrami dhe dr. Azmir Jusufi, anëtar i redaksisë së “Takvimit” në gjuhën boshnjake.

Kryeredaktori i “Takvimit”, prof. Ahmet Sadriu, në fjalën e tij para të pranishmëve theksoi: “Kam pasur fatin dhe ndihem shumë i privilegjuar që si kryeredaktor i “Takvimit” kemi punuar në institucionalizimin e “Takvimit” në gjuhën boshnjake dhe që kemi arritur të kemi bashkëpunëtorë, të cilët i përsërisin kësaj radhe. Këta bashkëpunëtorë tanë krijojnë profesionalisht, duke marrë parasysh se punimet e tyre në gjuhën boshnjake janë dukshëm të një niveli akademik.”

Ramadan Shkodra, ndër tjerash potencoi se: “Roli i “Takvimit” në histori, por edhe tani, është i jashtëzakonshëm, kemi mësuar për ahlakun, për din e iman në kohën shumë të vështirë të komunizmit. Me këtë “Takvim” e kemi kaluar edhe okupimin e Kosovës, dhe sot, shyqyr Zotit jemi të lirë. Botimi i “Takvimit” në gjuhën boshnjake në këtë format më së miri tregon për kapacitetin e imamëve tuaj të respektuar,

lodhshëm Rejhan ef. Nezirit. Falënderoj përfaqësuesit komunal për prezencën e tyre, duke falënderuar përmes tyre, të gjitha organet e shtetit zviceran që shqiptarëve dhe komuniteteve tjera të cilët jetojnë këtu, ju ofrojnë mundësi dhe kushte për të praktikuar fenë islame,” – tha ndër të tjera Simnica, I cili në shenjë respekti e bashkëpunimi, ndau një dhuratë emblemën e BIK-ut. Kori i nxënësve të Xhamisë “Hëna e Re” dh ane program kulturo-artistik.



kontribuar për xhaminë (objektin) e ri të tyre, të marrë me qira dhe që tashmë veçse kishin kaluar në të. Kurse me 30 janar 2023, drejtori Sinica vizitoi për namaz të drekës xhaminë e Regensdorffit.



të cilët ju i keni shkolluar, e të cilët sot janë të aftë të krijojnë një vepër të këtille.”

Pa asnjë dilemë se revista “Takvimi”, gjatë gjithë periudhës së botimit të saj, luajti dhe ende luan një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes së myslimanëve në Kosovë. Ai iu ofron një mozaik tematikash të gjithë dashamirëve të saj, pra lexuesve të të gjitha moshave në këtë nënqiell.

Ky numër i “Takvimit” është i ndarë në disa njësi tematike, si: kuptimi i Kuranit dhe mirësjellja islame; Boshnjakët, Islami dhe komuniteti; Islami, psikologjia dhe shëndeti; Edukimi dhe komunikimi dhe Trashëgimia islame.

Nga faqja 235 deri në faqen 263 vijon “Shtojca me pjesën kalendarike”, me kohët e namazeve dhe festat e rëndësishme fetare e kombëtare, që është veçori specifike e këtij vjetari të Bashkësisë Islame të Kosovës. (Dr. Azmir Jusufi)

“BEREQETI” NDIHMOI FAMILJET E PREKURA NGA VËRSHIMET

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” me gjithë koordinatorët e saj anekënd Kosovës ka qenë pranë familjeve të prekura nga vërshimet në Skenderaj dhe në Mitrovicë, duke i ndihmuar kështu me gjëra ushqimore, higjienike dhe me veshmbathje.

Të premten, të shtunën dhe të dielën, më 20, 21 dhe 22 janar, koordinatorët e kësaj shoqate, së bashku me drejtorin Behxhet Ajvazin, vizituan Skenderajn dhe Mitrovicën dhe në bashkëpunim me drejtoritë për Mirëqenie Sociale të këtyre dy komunave, kanë bërë shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet e prekura.

Ndërkaq të martën, më 24 janar, janë ndihmuar edhe disa familje të prekura nga vërshimet në qytetin e Klinës.



U ORGANIZUA AKSIONI PËR MBLEDHJEN E MJETEVE PËR TË PREKURIT NGA VËRSHIMET

Më 27 janar 2023 me kërkesë të Bashkësisë Islame të Kosovës, pas namazit të xhumasë në të gjitha xhamitë e vendit, është iniciuar aksioni për t’i ndihmuar të prekurit nga vërshimet. Ky aksion erdhi pas vërshimeve ku prekën banorë të shumtë rajonit të Skenderajt, Mitrovicës dhe vendeve të tjera. Veç të tjerash dëme pësuan edhe disa xhami në Mitrovicë dhe objektet e tjera përcjellëse të xhamive. Besimtarë të shumtë iu përgjigjen pozitivisht duke iu bashkuar këtij aksioni në dhurimin e të hollave Besimtarët përmes “Bereqetit” kanë qenë pranë këtyre banorëve menjëherë pas vërshimeve duke u dhuruar produkte elementare



VEHBI EF. KRYEZIU (1949-2023)

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem!”

Më 15 janar 2023 ndërroi jetë ish-imami i xhamisë së fshatit Pagarushë të Malishevës, Vehbi ef. Kryeziu.

Biografi e shkurtër

Vehbi ef. Kryeziu lindi më 11 maj 1949, në fshatin Pagarushë. Shkollën fillore katërvjeçare e përfundoi në fshatin e lindjes dhe katër të tjera i përfundoi në Carrallukë. Më pas vazhdoi shkollimin në medresenë e mesme “Alaudin” në Prishtinë.

Nga viti 1975 e deri më 2014 ka shërbyer si imam e mualim në fshatin e tij të lindjes në Pagarushë. Mirëpo me

kërkesën e xhematit, ai vazhdoi detyrën e imamit deri në vitin 2019.

Përkundër periudhës së vështirë që ishte asokohe si në anën kombëtare edhe atë ekonomike, ai kishte forcë dhe vullnet që të angazhohej për ngritjen e fjalës së Zotit dhe ta brumoste popullin me vetëdijen kombëtare. Shquhej për pasionin që kishte për dituritë e mësimet fetare, madje hulumtimet e leximet e tij nuk i ndali deri në ditët e fundit të jetës së tij. Sinqeriteti në fjalë e punë, ishte virtyti që e dallonte nga të tjerët. Varrimi i rahmetliut u bë me më 15 janar 2023 në varrezat e fshatit Pagarushë.

Zoti e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus!





APEL PËR NDIHMË



Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke vlerësuar me përvojë si të lartë gjendjen emergjente të krijuar pas vërshimeve të shiut në disa zona të Kosovës, si dhe dëmet e shkaktuara prej tij, apelon te të gjithë besimtarët që të shtrijnë dorën e ndihmës. Po ashtu, mobilizon të gjithë mekanizmat e saj që të jenë në funksion të lehtësimit të gjendjes së të prekurve nga vërshimet.

Të gjithë të interesuarit për të mbështetur dhe për të kontribuar në fondin për ndihmë, mund ta bëjnë në bankën NLB, me të dhënat e poshtë cekura:

NLB BANKA

Emërtimi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

IBAN: XK05 1700200100103672

SWIFT CODE: NLPRXKPR

Përshkrimi: VËRSHIMET E JANARIT 2023

